

LINDJA NËPËRMJET VDEKJES



“... Ai e nxjerr të vdekurin prej të gjallit...”

Njerëzit e dinë natyrshëm, që në këtë jetë nuk janë të përhershëm, dashje pa dashje ata janë në pritje të vdekjes së tyre dhe po i njëjti proces zhvillohet edhe në kahun e kundërt, vdekja diku i ka zënë pritën të gjallit dhe pret pikërisht atë momentin që Zoti e ka shkruar qysh në barkun e nënës, se kur do t'i vijë exheli (vdekja).

“Kur të vijë momenti, as e vonojnë, as e përshpejtojnë”.

Të habit fakti se si njerëzit i gëzon fakti, që çdo vit i afrohen edhe më shumë vdekjes dhe të habit fakti gjithashtu se sa të hutuar janë nga ky realitet. Ndërkohë që nuk e imagjinon dot ç'mund të ndodhë me njerëzit po t'jua kujtosh vdekjen, ata tmerrohen, sepse mesazhi i jetës u mungon.

Duke mos folur pastaj për ekstremet në konceptimin e vdekjes mes atyre që e shohin si mbarim dhe mbyllje “hesapesh”, e më pas çdo gjë mbaron, merr fund e si pasojë s'i intereson se si vrapon pas “lumturisë”, apo se si fiton, e rëndësishme për të është sa të jem “këtu” dhe ekstremit tjetër që e “përshpejton” vdekjen, duke u vetëvararë siç predikojnë disa sekte, të cilat kanë depërtuar në trojet shqiptare pa iu hyrë as gjembi më i vogël në këmbë. Ata justifikohen, se duke e bërë këtë krim Jezui gjoja i pret krahëhapur në parajsë. Normalisht ky nuk është interpretimi i feve zyrtare autoktone e theksoj, po i sekteve, të cilët janë legjitimuar këtu, ndërkohë që në disa vende evropiane dhe perëndimore nuk janë legjitime.

Besimtari i vërtetë e sheh vdekjen, si një proces të domosdoshëm të evoluimit njerëzor dhe i rrugëtimit për në botën e amshueshme. Ai nuk jeton me stresin se ç'kuptim ka kjo jete kur të gjithë po vdesin? As jeton me stresin, se mos po vjen tani apo pastaj? As jeton me stresin, që si i bëhet për pasurinë e kush do të kujdeset për fëmijët? Ai beson se kurdo që të ndodhë është vullnet i Zotit, të cilit nuk i dilet përpara dhe për të cilin nuk lejohet të ankohesh e jo më të protestosh, siç ndodh rëndom me të paditurit, duke bërë veprime që bien ndesh me parimet e fesë dhe që shprehin pakënaqësi ndaj vullnetit të Zotit. Jo vetëm kjo, por besimtari mendon se punët s'mbarojnë me kaq.

Jeta në këtë botë pa vdekjen s'do të kishte kuptim dhe Ahireti (përjetësia) pa vdekjen s'do të kishte rrugëtim, kështu që vdekja është domosdoshmëri e zhvillimit të jetës në të dy botët. Besimtari s'e dëshiron atë, as nuk ndërmerr shkaqet për ta përshpejtuar, nëse çështjet e kësaj bote i mbyllën apo i ngushtohen, ekstremi i lutjes së tij është të thotë: ***“O Allah, nëse është më mirë për mua të jetoj ma mundëso, e nëse është më mirë për mua të mos jetoj ma mundëso”.*** Pra, ai fundja fundit ia len Zotit të vet vendimin përfundimtar të lutjes dhe gjendjes së tij të ngushtuar.

Njeriu duhet të kuptojë se kjo botë është kalimtare, urë për diku tjetër, kështu që nëpërmjet vdekjes ti duhet të kuptosh, se asgjë s'të lumturon dot, sado që të arrish nga të mirat e kësaj bote, sepse një ditë pa vullnetin dhe pa miratimin tënd do të përjashtohesh nga loja. Shumë dëshira, projekte, iniciativa, ambicie do t'i marrësh me vete. Aty në atë moment fillon jeta e vërtetë e njeriut, aty ku të tjerët s'depërtojnë dot, aty ku mbetet i vetëm me librin e jetës, të cilin e ka shkruar gjatë gjithë kësaj jete të mundimshme, të lodhshme, të stresuar, me depresion, aspak të qetë, të mbushur me halle e derte. ***“A mos vallë kujtuat, se ju kemi krijuar kot, pa asnjë qëllim e se tek Ne një ditë s'do të ktheheni?”*** (Kurani Famëlartë).

Shpresoj se duke menduar mirë dhe seriozisht për këtë proces të domosdoshëm të jetës dhe të evoluimit tonë ta bëjmë jetën e kësaj bote më të lumtur dhe pastaj të jemi të lumtur në të dy jetët. Amin.

Në emër të redaksisë: Ahmed KALAJA

AKTUALE

TURQIA SHIKON NGA LINDJA DHE JUGU **3-5**

KËNDI IM

“AVATAR”, NJË FILM QË IDEALIZON IDHUJTARINË **6-11**

HIXHRETI I PROFETIT DHE PËRKUJTIMI I TIJ **12-13**

TRESHI I PËRKRYER **14-15**

NJË PROJEKT... VETËM PËR SERIOZËT! **16-19**

AKIDE

JETA E VARRIT - BERZEH (I) **20-23**

FIKH

PËRCJELLJA PËR NË AHIRET **24-28**

AVANCIMI PERSONAL

THELBI I ZGJIDHJES **29-31**

LIBRI

“RREGULLAT E XHENAZES DHE BIDATET NË TE” **32-34**

FAMILJA

LUM PËR TË DASHURUARIT (...VETËM PËR BURRA) **34-37**

SJELLJA ME ADOLESHENTIN **38-40**

TEFSIR

UDHËTIMI DREJT BOTËS TJETËR **41-43**

HADITH

SHKATËRRUESI I KËNAQËSIVE **44-48**

BOTA ISLAME

REPUBLIKA E JEMENIT **49-51**

FETVA DHE KONSULTIME

SI BESOHEM GAJBI? **52-54**

HISTORI

REBI IBËN HUTHEJMI – NJË BURRË QË PESHON SA MALET (II) **55-60**

REDAKSIA

Omer BERISHA – kryeredaktor
Anëtarë të redaksisë:

Ahmed KALAJA, Bekir HALIMI, Agim BEKIRI, Driton LEKAJ, Ali SHABANI, Ismail BARDHOSHI, Talha KURTISHI, Bledar HAXHIU, Sedat SHABANI, Agron TERZIQI, Lulzim SUSURI, Genc PLUMBI, Zeki ÇERKEZI, Enver AZIZI, Bashkim BAJRAMI, Bilal TEQJA.

Bashkëpunëtorë: Ekrem AVDIU dhe ENIS RAMA

Roald HYSA – redaktor gjuhësor

Halil BERISHA – redaktor teknik

Dorlir KRAJA (ENSARTDESIGN Studio) - ballina

Sedat RAMADANI - shpërndarje dhe marketing

Boton: AlbIslam

Adresa: rr: 110 nr: 5 | Çarshia e vjetër | Shkup 1000
email: albislam@gmail.com

sms: +389 75 436 718 | fax&tel: +389 2 3230 827

Revista është e regjistruar pranë Agjencisë për

Informata të Maqedonisë nr. 02-124/2

ISSN: 1409-6250

Tirazhi: 2000

ABONIMI NJË VJEÇAR

Për Maqedoni: 600 den, Jashtë vendit: 20 euro
(në çmim janë të përfshira edhe harxhimet postare)

e-mail: albislam.abonues@gmail.com

ALBISLAM DOOEL

Xhironlogaria: 30000002770453

Komercijalna Banka A. D. – Skopje

Numri tatimor: 4030008038784

Abonimet me euro mund t'i bëni online nëpërmjet shërbimit PAYPAL. Të dhënat mund t'i gjeni në www.albislam.com

TURQIA SHIKON NGA LINDJA DHE JUGU



Në shtatë vitet e fundit vlera e eksportit turk drejt Lindjes së Mesme dhe Afrikës Veriore është rritur thujtë shtatë herë dhe ka qenë më shumë se 31 miliardë dollarë në vitin 2008.

STAMBOLL – Kanë kaluar një mijë vjet, që kur turqit arritën në Lindjen e Mesme, duke u shpërngulur nga Azia Qendrore në Anadoll. Gjysmë mijëvjeçari ata sunduan në pjesën më të madhe të rajonit. Por kur Perandoria Osmane u shemb dhe në vitin 1923 lindi Republika Turke, ata nuk u izoluan nga zotërimet e tyre të mëparshme, por në vend të kësaj u kthyen nga Evropa, duke u bërë aleat me Amerikën në luftën e saj të ftohtë me Bashkimin Sovjetik. Turqit tani përsëri janë kthyer në Lindjen e Mesme, nën mbulesën e parrezikshme të tregtarëve dhe diplomatëve. Ky hap është i natyrshëm, duke marrë parasysh afërsinë, forcën e ekonomisë turke, ringjalljen e ndjenjës islame në Turqi pas shekullarizmit të imponuar me dekada dhe zhgënjimit nga

bisedimet e ngadalësuara për hyrjen në Bashkimin Evropian. Në të vërtetë ofensiva e Turqisë për Lindjen e Mesme për nga fushëveprimi dhe ritmi ngjason më shumë me një pushtim, por paqësor. Në shtatë vitet e fundit vlera e eksportit turk drejt Lindjes së Mesme dhe Afrikës Veriore është rritur thujtë shtatë herë dhe ka qenë më shumë se 31 miliardë dollarë në vitin 2008. Nga automjetet e deri te shërbimet për ushqim, nga fiku i thatë e deri te serialet televizive, prodhimet turke, të panjohura deri para një dekade, tani janë më se të pranishme në tregjet nga Algjeri e deri në Teheran. Kanal jetik për dërgimin e burimeve energjetike nga Lindja në Perëndim, Turqia fiton një rëndësi të madhe me rritjen e madhe të numrit të

gazsjellësve, që janë lëshuar në funksion. Më i rëndësishëm është “Nabuko”, një plan i propozuar me vlerë prej 7,9 miliardë euro për përcjelljen e gazit nëpërmjet Turqisë nga Azerbajxhani dhe ndoshta nga Turkmenistani, Irani, Iraku dhe Egjipti. Kompania turke e ndërtimit, TAV, sapo ka përfunduar ndërtimin e terminalit të aeroportit në kryeqytetin egjiptian Kajro, dhe po ndërton të tjera në Libi, Katar, Tunizi dhe Emiratet e Bashkuara Arabe. Turqit kanë siguruar qindra kontrata infrastrukturore në Kurdistanin irakian dhe kanë investuar në qendra tregtare, hotele madje edhe shkolla.

Këto arritje kanë ardhur pjesërisht si rezultat i humurtimeve të fuqishme pas privilegjeve tregtare, si kontratat e Turqisë për shkëmbime të lira tregtare me Egjiptin, Izraelin, Marokun dhe Tunizinë. Turqia përpiqet të arrijë marrëveshje të ngjashme me gjashtë shtete anëtare të Këshillit për Bashkëpunim të Gjirit, në të cilin është e përfshirë edhe Arabia Saudite. Një grup i ministrave turq kohët e fundit ishin për vizitë në Bagdad dhe Damask për të nënshkruar një paketë prej 48 marrëveshjesh për bashkëpunim me Irakun dhe 40 me Sirinë.

Kryeministri turk **Rexhep Taip Erdogan** u prit ngrohtësisht në kryeqytetin iranian, Teheran, si pasqyrim i politikës reale, i cili mban lidhje të hapura pavarësisht nga izolimi ndërkombëtar i Iranit. Turqia nuk kërkon viza për iranianët, kurse Erdogan, i cili e theksoi të drejtën e Iranit për të zotëruar energjinë bërthamore për qëllime civile, me ironi e uroi presidentin iranian, Mahmud Ahmedinexhad, pas fitores së tij të diskutueshme të qershorit. Turqia jo shumë kohë më parë bëri një hap të rëndësishëm historik në marrëdhëniet me fqinjën tjetër lindor, Armeninë. Nëse parlamentet e të dy shteteve e pranojnë këtë veprim,

“**Erdogani, i cili e theksoi të drejtën e Iranit për të zotëruar energjinë bërthamore për qëllime civile, me ironi e uroi presidentin iranian, Mahmud Ahmedinexhad, pas fitores së tij të diskutueshme të qershorit...**”

marrëdhëniet diplomatike mund të rivendosen sërish pas ngrirjes së tyre 16 vjeçare.

Ky pragmatizëm i qëndrueshëm diplomatik është ndjekur me fanatizëm nga ministri i punëve të jashtme **Ahmet Davutogllu**, profesor i marrëdhënieve ndërkombëtare, i cili ka qenë këshilltar gjatë tërë kohës i Erdoganit, edhe para emërimit të tij në maj. Davutogllu, i cili në një libër të tijin e përshkruan Lindjen e Mesme, si “**mjedis strategjik i Turqisë**” kërkon një politikë “**të problemeve zero me fqinjët**”. Duke paraqitur islamizmin e matur dhe modern të Partisë për Drejtësi dhe Zhvillim, e njohur me inicialet AK, e cila po e qeveris Turqinë nga viti 2002, politika e re kërkon të përdoret forca diskrete e tregtisë, bashkë me lidhjet historike, që të projektojë stabilitet jashtë kufijve të Turqisë. Kjo shënon një ndryshim të qartë në pikëpamjen kundrejt botës. Në të kaluarën Turqia ka pasur një tendencë ta shihte veten si një ledh mbrojtës i NATO-s në Lindje, ndërsa fqinjët e saj të Lindjes së Mesme konsideroheshin si kërcënime që duhej të ndaleshin.

Pavarësisht nga forca e bindëse e

Davutogllut, ky riorientim nuk mund të ndodhte pa ndryshimet dramatike në Turqi. Reformat e ndërmarra pjesërisht për t'u përmbushur kërkesat për anëtarësim në BE, e zhvendosën forcën nga gjeneralët, të preokupuar me kërcënimet ushtarake drejt institucioneve civile dhe ndaj elitës më të vetëdijshme muslimane e rrënjosur në Anadoll, në vend të Stambollit, qyteti kryesor komercial dhe intelektual, që është i kthyer nga perëndimi. Partia e AK-së, gjithashtu e revizionoi politikën zyrtare shumëvjeçare me përpjekjen për të përmbushur kërkesat e minoritetit të madh kurd në Turqi (rreth 14 milion nga gjithsej 72 milionë).

Megjithatë arsyeja për suksesin e qasjes më të kujdesshme dhe më të ngrohtë qëndron në kontekst të asaj që ndodh me vakuumin e një fuqie në rajon. Gjigantët arabë si Egjipti dhe Iraku nuk zotërojnë më fuqi të mjaftueshme. Ndikimi amerikan gjithashtu u zvogëlua, duke marrë parasysh problemet në Irak. Në të vërtetë, depërtimi më i madh i Turqisë në opinionin publik arab ka ndodhur në vitin 2003, kur parlamenti i saj hodhi poshtë kërkesën amerikane për hapje të territorit turk, si front i dytë për invazionin në Irak. Turqia lejoi të përdoren bazat e saj ajrore, që të kënaqen nevojat e luftës, por iu shmang zemërimin të grumbulluar midis aleatëve arabë të Amerikës.

“Gjigantët arabë si Egjipti dhe Iraku nuk zotërojnë më fuqi të mjaftueshme. Ndikimi amerikan gjithashtu u zvogëlua, duke marrë parasysh problemet në Irak.”

Turqia gjithashtu ka qenë e mirëpritur edhe më mbrapa, për arsye se numër i madh i arabëve e konsiderojnë atë si kundërpeshë e matur e Iranit dhe dritare drejt Perëndimit. Shiitët irakianë, për shembull, janë ende të kujdesshëm rreth përzierjes së Iranit në Irak, edhe pse partitë më të mëdha shiite të Irakut kanë marrëdhënie të afërta me Iranin. Kurdët e Irakut edhe përkaj tensioneve të kamotshme me Turqinë, gjithashtu i ngrohën marrëdhëniet pas rritjes së shkëmbimeve tregtare, por me afrimin e largimit të mbrojtësve amerikanë të kurdëve u rritën mundësitë për izolim. Qeveria laike e Sirisë, aleat i fshehtë (mister) i Iranit, në fakt ndan pak afinitete kulturore me sundimtarët e vet agresivë islamikë, në krahasim me përfaqësuesit e biznesit zyrtar të Partisë AK. Marrëdhëniet e përmirësuara me Turqinë, të cilat tani përfshijnë udhëtimin pa viza, i dhanë ndihmën shumë të nevojshme Sirisë, të izoluar në diplomaci dhe ekonomishtë të ngecur. Në fakt, Siria ishte aq e padurueshme ta përfitojë Turqinë, me çka në vitin 2005 hoqi dorë nga pretendimi territorial shumëvjeçar për **Hatajin**, krahinë e cila në vitin 1939 iu nda Turqisë nga ana e Francës, në atë kohë sundimtare koloniale në Siri.

Megjithatë zyrtarët turq janë të kujdesshëm në shpjegimin se interesi i rinovuar drejt lindjes muslimane nuk do të thotë ftohje e marrëdhënieve me Perëndimin. Aleatët e saj perëndimorë, kryesisht e ndajnë atë qëndrim dhe nuk e kundërshtojnë kthimin e Turqisë nga Lindja. ■

(marrë nga: The Economist)
Përktheu: Sedat RAMADANI

“AVATAR”, NJË FILM QË IDEALIZON IDHUJTARINË

Filmi në fjalë, trajton ngjarje imagjinare që zhvillohen në vitin 2154 dhe fokusohet në një konflikt epik në Pandora, një satelit natyror imagjinar, në madhësinë e tokës, satelit i planetit imagjinar të quajtur Ciklop, dhe ku ky i fundit ndodhet në orbitën e yllit më të afërt me diellin tonë, në Alfa Centaur. Që në fillim të bie në sy përdorimi i emërtimeve me origjinë greke pagane

SHKRUAN: JUSTINIAN TOPULLI

Islami është feja e njësitimit të Zotit, është kulti monoteist më i pastër që ekziston mbi këtë lëmsh dheu dhe si i tillë, misioni i kurdohershëm i tij është të mbajë të gjallë dhe aktive frymën e këtij nocioni xheloz në jetën e njerëzve, nga çdo prekje e idhujtarisë.

Allahu i Lartësuar, me Urtësinë e Tij

sublime, ka përcaktuar për këtë ekzistencë, atë që çdo krijesë e Tij e përjeton natyrshëm, si ligji i shkakut-e pasojës. Asgjë në këtë botë nuk del jashtë këtij ligji, edhe pse shpesh njerëzit nuk janë në gjendje të kuptojnë apo zbulojnë të gjitha hallkat e këtij zinxhiri të pandërprerë, që vepron në mënyrë organike. Edhe vetë parashkrimi hyjnor i ngjarjeve dhe përfundimi i gjithçkaje që ndodh dhe do të ndodhë, është



“Pikërisht ky proces mishërimi, në thelb pagan, nga regjisorit i filmit emërtet avatar, që “nënkupton teknologjinë njerëzore, e cila në të ardhmen, —sipas tij— do jetë e aftë të injektojë inteligjencën njerëzore në një trup të largët të komanduar në distancë, një trup biologjik ky”!...”

përcaktuar të jetësohet po nëpërmjet këtij ligji. Kjo është një bindje e kulluar islame; asgjë nuk del jashtë caktimit të Zotit dhe asgjë nuk ndodh pa pasur një shkak.

Ne besojmë, ashtu si çdo njeri i thellë, se jeta e njeriut është një kompleks bashkëveprimi ndërmjet individit dhe ambientit që e rrethon dhe pikërisht edhe identiteti i qenies njerëzore mbruhet nga ato qindra e mijëra ndijime dhe ngacmime, të jashtme dhe të brendshme, që ai i përjeton çdo ditë. Këtë të vërtetë vetëm të menduarit e shterpët dhe një cektësi sipërfaqësore e deviacionit doktrinar kryeneç mund ta mohojë.

Nisur nga ky këndvështrim islam i qashtë për botën, neve si muslimanë nuk mund të mos na bëjë përshtypje propaganda e ethshme me elemente pagane, që qarqe të caktuara kulturore përçojnë me ose pa vetëdije në drejtim të njerëzve. Pikërisht duke kapur këtë anë shqetësuese për ne, jemi të detyruar që prodhimeve kulturore që përhapen me shpejtësi sot në botë, t'u

shohim edhe anën e tyre negative, e për më tepër, kur kjo anë është kaq blasfemuese ndaj besimeve qiellore, sa i ndot qoftë edhe në sfond anët e tjera pozitive të mesazheve, që këto prurje sjellin për njerëzimin sot.

Nuk dua të bëjmë nihilistin, por nuk mund të heshtim, as në mënyrë naive ndaj një fenomeni propagandistik, gjithsesi të tërthortë, që bëhet nëpërmjet filmave artistikë për të rritur dhe atyre vizatimorë për fëmijë, ku elementë të idhujtarisë, në formën e animizmit apo panteizmit, shfaqen dukshëm pozitivisht në këto filma, por njëkohësisht edhe si të vërteta, të cilat të kontaktuara nga njerëz me kulturë që trashëgojnë një fe hyjnore nuk hasin asnjë lloj rezistence, përkundrazi respektohen, simpatizohen apo edhe përqafohen prej këtyre njerëzve modernë, zotërues të teknologjisë, por që na zbulojnë neve, se janë të zbrazët nga ana shpirtërore.

Këtu do të marrim në shqyrtim një film me subjekt tejet imagjinar, fantastiko-shkencor, të titulluar “AVATAR”, film i cili këto ditë është duke bërë xhiron e botës dhe ku natyrisht, nuk mund të mos bjeri në sy ana e fortë komerciale, e qindra milionë dollarëve të shpenzuar për realizimin e tij dhe e po aq të fituarve në mbarë globin nga shitja e tij.

Filmi në fjalë, trajton ngjarje imagjinare që zhvillohen në vitin 2154 dhe fokusohet në një konflikt epik në Pandora, një satelit natyror imagjinar, në madhësinë e tokës, sateliti i planetit imagjinar të quajtur Ciklop, dhe ku ky i fundit ndodhet në orbitën e yllit më të afërt me diellin tonë, në Alfa Centaur. Që në fillim të bie në sy përdorimi i emërtimeve me origjinë greke pagane (çka tregon në fakt edhe lidhjen e fortë që ka qytetërimi perëndimor me këtë kulturë), ku sipas mitologjisë greke, Ciklopi është biri i perëndisë Gea (toka) me Uranin (qielli), ndërsa Pandora është një krijesë e Zeusit, e

cila u dërgua për t'i sjellë njerëzimit fatkeqësi dhe sëmundje. Nuk mundet të mos dallosh lehtë simbolikën që kanë këto emra në film.

Në planetin Pandora jetojnë kolonët njerëz dhe banorët vendas, të quajtur **na'vi**, të cilët janë qenie të ngjashme me njeriun. Këta humanoidë imagjinarë, kanë trupa të mëdhenj dhe janë të gjatë 2.7 metra, kanë bisht dhe lëkurë ngjyrë blu! Na'vit janë krijesa që jetojnë në harmoni me natyrën, ata adhurojnë “perëndinë nënë”, ose ndryshe natyrën e planetit të tyre, të cilën ata e quajnë **Eywa**, e cila “është forca udhëheqëse dhe hyjnore e Pandoras dhe e Na'vi-t. Na'vit besojnë se Ejua vepron për të mbajtur ekosistemin e Pandoras në një ekuilibër perfekt.”

Njerëzit e ardhur nga toka janë një kompani kërkimesh, të cilët kanë zbuluar një mineral të veçantë me veti të jashtëzakonshme në këtë planet, të cilin duan ta nxjerrin për ta shitur më pas në tokë me çmime marramendëse. Vetë kompania ironikisht quhet Pandora, emër të cilin ata ia kanë vënë edhe planetit ku kanë zbuluar. Kompania Pandora ka pajtuar edhe një ushtri mercenarësh, për të përmbushur qëllimet e saj, nëse asaj do t'i duhet të përdorë forcën ndaj banorëve vendas. Bashkë me ta gjenden edhe një grup studiuesish, të cilët studiojnë florën dhe faunën e këtij vendi. Këta të fundit për të komunikuar me na'vit, të cilët nuk afrohen me të ardhurit nga toka, kanë krijuar trupa të ngjashëm me ta, të përzier gjenetikisht me njerëzit, të cilët nëpërmjet një procesi telekomandimi, bazuar në inxhinierinë gjenetike, vendosin mendjen e tyre në këto trupa dhe sillen si të ishin të lindur në to!

Pikërisht ky proces mishërimi, në thelb pagan, nga regjisorit i filmit emërtohet *avatar*, që “nënkupton teknologjinë njerëzore, e cila në të ardhmen, –sipas tij-

“... Skenaristi dhe regjisorit i filmit me sa duket me anë të kësaj panorame kërkon të idealizojë natyrën, përderisa krijesat inteligjente që jetojnë në të e shohin atë si të shenjtë dhe idhullin e tyre...”

do jetë e aftë të injektojë inteligjencën njerëzore në një trup të largët të komanduar në distancë, një trup biologjik ky!” Pikërisht edhe titulli i filmit e merr emrin nga ky fenomen. Vetë fjala *avatar*, vjen nga sanskritishtja dhe sipas konceptit hinduist, do të thotë mishërimi i një perëndie në trupin e një njeriu.

Na'vit, që paraqiten si humanoidë, që jetojnë në gjendje primitive, nuk janë aspak objekt kërkimesh për drejtuesit e kompanisë Pandora, madje ata duan t'i largojnë na'vit nga vendbanimi i tyre, një pemë gjigante kjo, ku ata jetojnë në zgavrat natyrale të saj në formën e një bashkësie fisnore, sepse poshtë saj gjendet një rezervë e madhe e mineralit të çuditshëm. Për këtë ata ngarkojnë me mision një nga njerëzit që shoqëron grupin e studiuesve si roje, i cili me anë të “avatarizmit” komandon një trup na'vi. Njeriu në fjalë depërton në radhët e fisit dhe fiton besimin e tyre, mësohet të jetojë si ata dhe madje bie në dashuri me vajzën e kreut të fisit, e cila i qëndronte pranë për t'i mësuar jetën dhe kulturën e tyre. Ajo i mëson atij të jetojë si një na'vi, i mëson atij se si të përshtatet fizikisht dhe shpirtërisht me këtë kulturë animiste pagane dhe si ta ndjejë dhe ta adhurojë atë.

“Na'vi-t kanë vende të shenjta, ku ata thonë se e ndiejnë më thellësisht lidhjen me

natyrën. Gjatë filmit bëhet tërësisht e qartë se perëndia e na'vit, Ejua është diçka reale, po aq sa dhe çdo qenie tjetër në këtë planet. Pemët, bimët dhe kafshët kanë lidhje reale me njëri-tjetrin, duke formuar lidhje të përbashkëta në një botë gjigante mendore, një mendje, e cila e manifeston vetveten si një pikë kyçe nga ku duhet vrojtuar panorama e kësaj bote, në atë mënyrë që nuk të lë asnjë mëdyshje, nëse “ajo” ekziston apo jo.” Vajza na'vi i mëson heroit njeri të filmit se ata, edhe kur janë të detyruar të gjuajnë kafshë për t'u ushqyer, i bëjnë një lutje falënderimi nënës natyrë, e cila u mundëson të ushqehen prej saj. E thënë më ndryshe, ajo i mëson atij se si të respektojë natyrën e planetit, ose ndryshe perëndinë e tyre dhe të jetojë në harmoni me të.

Për na'vit, Ejua është krijuesja dhe perëndia që përkujdeset për ta. Ndonjëherë, ajo teorizohet materialisht nga shkencëtarët e tokës, ku çdo gjë e gjallë në Pandora lidhet me të nëpërmjet një sistemi neuro-transmetues, gjë që shpjegon pse edhe na'vit mund t'u hipin kafshëve të tyre të egra, të kalërojnë apo fluturojnë me to menjëherë, pa pasur nevojë për një periudhë të gjatë e të nevojshme për zbutjen e tyre, siç ka ndodhur me kafshët shtëpiake, dikur të egra, në tokë.”

Në gjithë sa thamë, duken qartë elementet e një besimi panteist natyror, ku çdo krijesë është pjesë e së tërës dhe një shpirt i vetëm i përshkon të gjithë, pikëpamje këto që përputhen me filozofinë **Gaia**, ku kjo e fundit, siç e përmendëm edhe më lart, sipas mitologjisë greke përfaqëson perëndinë tokë, nga e cila rrodhën edhe perënditë greke dhe të gjithë krijesat e tjera. Këto pikëpamje janë huazuar sot edhe nga neo-paganizmi, apo siç njihet ndryshe edhe si Epoka e Re (New Age).

Pandora ka një pamje mahnitëse, një

gjelbërim të harlisur, me një bimësi mjaft të bukur dhe tërheqëse, me bimë fluoeshente që ndriçojnë natën, aq magjepsëse, sa as në tokë nuk e gjen, shkurt ajo na paraqitet si një parajsë natyrore. Skenaristi dhe regjisori i filmit me sa duket me anë të kësaj panorame kërkon të idealizojë natyrën, përderisa krijesat inteligjente që jetojnë në të e shohin atë si të shenjtë dhe idhullin e tyre.

Por asgjë nga këto nuk u ngjall kërshërinë drejtuesve ushtarakë dhe civilë të misionit Pandora, të cilët falë teknologjisë së përparuar që zotërojnë e shohin veten superiorë dhe duan ta kthejnë vendin në një kantier shfrytëzimi, qoftë kjo edhe duke i detyruar na'vit me forcë ta braktisin banesën pemë të tyre. Duke qenë se misionari avatar dështon në misionin e tij, madje ai tradhton, duke u dashuruar mbas jetës dhe kulturës së na'vit, kompania vendos të përdorë forcën e armëve, kështu që ajo shkatërron me armë pemën gjigante, duke djegur dhe vrarë për pasojë edhe shumë prej banorëve na'vi. Këtu lind edhe konflikti në mes tyre dhe të ardhurve nga planeti tokë dhe bashkë me ta do të bëhen edhe grupi i studimit, të cilët vihen në mbrojtje të na'vit dhe së bashku organizohen për të përzënë me luftë nga vendi i tyre tokësorët.

Një moment i rëndësishëm në film, për atë që po trajtojmë, që tregon elementet pagane të tij, është edhe çasti kur heroit i filmit, avatari na'vi-njeri, i drejtohet pemës së shenjtë, duke lutur perëndinë “nënë e të gjithëve”, që ta ndihmojë në këtë luftë, pasi ai e di mirë se armët primitive të na'vit nuk mund të përballen me teknologjinë shkatërruese të ardhur nga toka. Dhe pikërisht atëherë kur lufta midis vendasve dhe të ardhurve po përfundonte tragjikisht në dëm të na'vi-t, të gjitha kafshët e Pandoras, të thirrura nga nëna natyrë,

sulmojnë tokësorët imperialistë, duke shkatërruar ushtrinë dhe armët e tyre. Kështu pra, ata shpëtojnë ekzistencën e tyre, në sajë të një renegati human, por “edhe për shkak të besimit të tyre tek perëndia Ejua, “nëna e të gjithëve”. Në fund, na’vit bashkë me heroin e tyre njeri dhe një grup të vogël tokësorësh të tjerë, të cilët vendosin të jetojnë në Pandora, e detyrojnë me forcë kompaninë dhe gjithë njerëzit e saj të largohen nga planeti i tyre.

Filmi mbyllet me zhvendosjen përfundimtare të mendjes së heroit njeri në trupin e na’vit, që ai e përdorte si avatar dhe braktisjen e atij tokësor, tashmë jo përkohësisht, siç bënte më parë me anë të teknologjisë inxhinierike, por në sajë të një rituali fetar midis fisit të na’vit dhe idhullit të tyre natyrë.

Filmi po ashtu, fokusohet qartë në temat e imperializmit, bio-diversitetit dhe mbrojtjes së natyrës nga shkatërrimi njerëzor, si pasojë e makutërisë njerëzore dhe e teknologjisë shkatërrimtare. Por ndër të tjera ky film, siç shprehet skenaristi dhe regjisor i tij, ndan pikëpamje të ngjashme që trajtohen edhe në filma të tjerë siç janë: “Duke luajtur në fushat e Zotit”, “Pylli smerald” dhe “Vallëzim me ujqërit”, ku edhe në këto filma animizmi dhe idhujtaria e popujve primitivë shfaqet dukshëm.

Ia vlen të përmendim këtu, se edhe vetë regjisor i filmit shprehet se e idealizon jetën e këtyre njerëzve imagjinare, duke thënë: “na’vi-t përfaqësojnë diçka që është vetja jonë e lartë, apo aspirata e vetes sonë, çfarë ne do të kishim dëshirë të mendonim se jemi”?!

Natyra ku na’vit jetojnë dhe kultura e tyre primitive paraqitet si e përkryer dhe magjepsëse, falë edhe teknologjisë së lartë 3-D kinematografike. Filmi mund të tërheqë lehtësisht në trillin e tij shpirtrat e zbrazët njerëzorë dhe në veçanti brezin e ri dhe

njerëz të tjerë emocionalisht të dobët, jo thjesht për ta pranuar paganizmin të jetojë si një “vlerë” njerëzore, por pse jo edhe për ta shijuar e ndoshta përqaftuar këtë lloj kulture idhujtarie. Pikërisht edhe efekti më negativ i këtyre filmave dhe i kësaj kulture postmoderne, është fryma e bashkëjetesës paqësore dhe respektuese ndaj idhujtarisë dhe shirkut që këto filma mbartin, duke u përçarur njerëzve që besojnë në një Zot të vetëm dhe transcendent, një herezi të patolerueshme. Sipas një kritiku të “The New York Times”, “Avatar-i” është një apologji e gjatë për panteizmin –një besim ky që e barazon Zotin me natyrën dhe e fton njerëzimin në një bashkësi lidhëse fetare me botën natyrale.” Ai vazhdon më tej dhe shprehet për panteizmin në prurjet e sotme kulturore amerikane, se ai “është një sajese metafizike që shfaqet edhe nëpërmjet filmave vizatimorë të Disney-t, të tillë siç janë “Mbreti Luan” dhe “Pokahontas”.

Ndërsa ne do të shtonim këtu, se edhe filma të tjerë vizatimorë e artistikë, me të cilët ushqehen sidomos fëmijët sot janë të mbushur me trillime magjish e magjistarësh, perëndish pagane me origjinë antike dhe të sajuara, të tilla si serialet e “Harri Poterit”, “Zoti i unazave” dhe një mori e shumë vizatimorësh, të mbushura me forca e qenie të mbinatyrshme, të cilët personifikohen në faraonë të ringjallur, dragonj e përbindësha të tjerë, në trajtë perëndish dhe gjysmë perëndish, të cilët ndikojnë fuqishëm në formimin identitar të brezit të ri dhe që për fat të keq mbushin përditë ekranet tona televizive. Sipas kritikut në fjalë: “Ka të dhëna që tregojnë se ka shumë amerikanë, madje edhe të vetëquajtur të krishterë, të cilët mbartin në mendje besime rreth “energjisë shpirtërore” të pemëve dhe maleve, gjë e cila është shprehur mjaft mirë edhe tek indigjenët na’vi.”

“...Filmi mund të tërheqë lehtësisht në trillin e tij shpirtrat e zbrazët njerëzore dhe në veçanti brezin e ri dhe njerëz të tjerë emocionalisht të dobët, jo thjesht për ta pranuar paganizmin të jetojë si një “vlerë” njerëzore, por pse jo edhe për ta shijuar e ndoshta përqafuar këtë lloj kulture idhujtarie...”

Tek lexojmë të tilla konstatime që na vijnë nga një botë përhapëse e modernizmit, menjëherë na shkon mendja tek trashëgimia iliro-pagane, që ruhet në forma të ndryshme e gjallë edhe mes shqiptarëve, si mbeturina të adhurimit të natyrës, siç është rasti i kurbaneve që i bëhen malit Gjallicë në zonën e Lumës, “Baba Tomorit” në zonën e Skraparit etj.

Kritiku amerikan vazhdon dhe shprehet se si ky lloj paganizmi ka gjetur strehë edhe tek njerëz, të cilët si qëllim kanë kritikën ndaj zhvillimit të pakontrolluar teknologjik që shkatërron ambientin biologjik, duke thënë: “Sot ka të tjera forca, të cilat përhapin apelin e panteizmit amerikan. Ne trishtohemi për atë që kemi lënë pas dhe hyjnizojmë botën natyrale, si një mënyrë reagimi për të shprehur mosmiratimin tonë ndaj një shoqërie super-teknologjike. Kërcënimi i ngrohjes globale, ndërkohë ofron kultin e shenjtërimit të natyrës, për çdo religjion që kërkon të ketë një fushatë


sensibilizuese të suksesshme, për t’i thënë një “Jo” të prerë atyre që duan të na shkaktojnë një apokalips skajshmërisht të nxehtë.”

Më pas, kritiku vë në pah se si panteizmi mëton të zbrapsë monoteizmin e trashëguar nga fetë qiellore duke thënë: “Në të njëjtën kohë panteizmi hap një rrugë për përjetime shpirtërore, për njerëz që nuk ndihen rehat me mendësinë e fjalëpërfjalshme të feve monoteiste – me mrekullitë, Zotin dhe librat e tyre të shenjtë... Ashtu siç edhe filozofi polak Leszek Kolakowski vë në pah, se t’ia atribuosh hyjnitetin botës natyrale do të thotë “ta sjellësh Zotin më afër eksperiencës njerëzore” dhe ndërkohë “Atij i heq karakteristikat e mirënjohura personale.” Ai e mbyll duke thënë: “Për çdokënd që brengoset për transcendencën, por tërhiqet përpara idesë që kërkon besimi në një Zot të Plotfuqishëm, i Cili ndërhyr në punët e njerëzve, panteizmi është një kombinim ideal.”

Nga ky shpjegim është e lehtë të kuptojmë edhe aleancën e natyrshme që ka lindur mes shekullarizimit dhe përhapjes së kësaj kulture idhujtarie panteiste, ku në fakt që të dyja nuk janë gjë tjetër vetëm se një tentativë për të mos miratuar praninë e Zotit të vërtetë në jetën e krijesave dhe për të kurorëzuar këtë të fundit si Perëndi të vetme të botës. ■

Burimet:

- <http://en.wikipedia.org/wiki/Avatar.htm>
- <http://www.nytimes.com/file/avatar%20Heaven%20and%20Nature.htm>
- <http://www.goodnewsfilmreviews.com/2009/12/movie-trailer-avatar.html>
- [Babylon Britannica Concise Encyclopedia.](#)
- etj...



HIXHRETI I PROFETIT DHE PËRKUJTIMI I TUJ

(A ka ardhur koha të bëjmë hixhret dhe si duhet ta përkujtojmë këtë ditë kaq të lavdishme për Islamin? Omeri e futi hixhretin në jetën e çdo muslimani dhe një gjë të tillë duhet ta bëjmë edhe ne, kur dihet mirë që dashuria për Profetin Muhamed alejhi selam është një nga themelet ku bazohet feja e çdo individi.)

SHKRUAN: ROALD A. HYSA

1431 vjet më parë mbërriti në Medinën e Ndrirshme burri më i lartë i të gjithë kohëve, ai që nuk pranoi asnjë titull njerëzor përpos atij që ia dha vetë Allahu i Lartësuar, **“abduhu ue resuluhu –rob dhe i Dërguar i Allahut”**. Në këto ditë ne të gjithë duhet të bëjmë hixhretin e Profetit Muhamed, duke bërë fillimisht një përmbledhje të asaj që shkoi dhe të vendosim se çfarë duhet të bëjmë në të ardhmen. Një nga pyetjet më shqetësuese që vazhdimisht duhet t’ia drejtojmë vetes tonë si muslimanë është: A kemi bërë atë që duhet dhe a po bëjmë atë që duhet? Konotacionet e

kësaj ngjarje të jashtëzakonshme duhet të jenë sa më të dukshme në jetën tonë. Thjeshtësia e kësaj ngjarje është me të vërtetë solemne në historinë islame, saqë një nga sahabët më të mëdhenj dhe një shtyllë e Islamit, Omeri, Allahu qoftë i kënaqur me të, e caktoi si ditën kur do të fillonte kalendari hënor hixhri. Ndryshimi që erdhi pas kësaj date të rëndësishme është si i natës me ditën. Një nga ngjarjet më të mëdha të hixhretit të Profetit tonë dhe që do shikuar me një vëmendje të posaçme është ajo e vëllazërimit midis Ensarëve dhe Muhaxhirëve. Me të vërtetë që ne sot nuk mund të vendosim analogjinë e duhur, porse vend për t’u

“Fatkeqësisht festa të tilla si Viti i Ri dhe risitë që i përkasin kësaj feste janë futur nga regjimi i kaluar komunist, si kundërpërgjigje ndaj festave tona të nderuara, bajrameve vjetore dhe xhumasë. Kështu që ne kemi më shumë arsye për t'i kundërshtuar këto festa të kota e pagane...”

vëllazëruar kemi. Një nga shumë rregullat e arta themelore të vendosura nga Islami është ndjekja e Traditës Profetike me fanatizëm, jashtë kësaj rruge çdo gjë e humb sensin e vet, sado që ne të mundohemi t'i japim një kozmetikë islame. Festa të tilla si viti i ri janë krejtësisht festa komerciale, të cilave ua shohin më tepër hairin dyqanxhinjtë dhe prodhuesit, se sa vetë festuesit. Ndërsa ne si muslimanë u shohim vetëm sherrin, sepse pa hyrë thellë në argumentet fetare, të cilat janë shpjeguar prej kohësh nga dijetarët dhe hoxhallarët muslimanë, neve vetëm humbasim dhe i largohemi traditave tona të bukura islame.

Ne duhet të bëjmë hixhret nga moralet e ulëta dhe të liga të shoqërisë sonë moderne, duhet t'i largohemi të keqes masive që përhapet nga të gjitha mediet shekullariste, duhet të largohemi nga harami me trup, me shpirt, me zemër e me gjithë familjet tona, e për këtë duhet të vëllazërohemi me njëritjetrin sipas binomit ensar-muhaxhir. Si Ensarët, ne duhet të përkrahim këdo që kërkon të afrohet me këtë fe kaq të lartë dhe si muhaxhir, neve duhet të sillemi me këtë botë, në të cilën jemi mysafirë të sprovuar nga ana e Allahut të Lartësuar, se kush do të

jetë nga vepërmirët. Fatkeqësisht festa të tilla si Viti i Ri dhe risitë që i përkasin kësaj feste janë futur nga regjimi i kaluar komunist, si kundërpërgjigje ndaj festave tona të nderuara, bajrameve vjetore dhe xhumasë. Kështu që ne kemi më shumë arsye për t'i kundërshtuar këto festa të kota e pagane, se sa t'i marrim si model. Gjithashtu jo pa qëllim kjo festë pompohet së bashku me festa të tjera, si ajo e Krishtlindjeve dhe shpesh i dëgjojmë rrugëve njerëzit të thonë “Gëzuar festat”, si pa gjë të keq. E gjithë kjo reklamë shumëngjyrëshe që po përjetojmë këto ditë në pamje të parë nuk tregon ndonjë synim, por jo më kot pompohen harmonia dhe toleranca ndërfitare ndër shqiptarët kudo ku janë. Ato janë pjesë e një projekti asimilues fetar të të gjithë atyre që janë **të pandërgjegjshëm ndaj përkatësisë së tyre fetare**. Kështu mund të jepnim argumente të pa fund nga jeta shekullare e shoqërisë tonë të ashtuquajtur moderne, të tilla që do të na e argumentonin edhe më tepër kundërshtimin e imitimit. Me të vërtetë që imitimi në shoqërinë moderne e ka humbur vlerën e sevapit. Nuk mund të fitojmë kënaqësinë e Allahut, duke imituar këta xhahilë, të cilëve Allahu u ka vënë ndër duar mjete tepër të vlefshme, por që nuk ua dinë vlerën e vërtetë. Si mund ta përkujtojmë hixhretin e Profetit tonë të dashur Muhamedit, *alejhi salatu ue selam*? Mund të gjinden shumë mënyra pa dalë nga kornizat tona islame. Përpjekja për të gjetur mënyrat e duhura është vetë një hixhret nga imitimet e verbra dhe të kota. Të mbahen mexhlise për hixhretin e Profetit tonë dhe moralet e tij të larta gjatë të gjithë muajve të vitit do të ishte një nga mënyrat më të mira për ta përkujtuar atë, *alejhi salatu ue selam*, dhe do të na rritej edhe më shumë dashuria, të cilën ne duhet ta bëjmë pjesë të fesë tonë në jetesën e përditshme. ■

TRESHI I PËRKRYER

Popujt çohen në këmbë nëpërmjet parimeve ku besojnë, freskohen me vlera madhështore, të cilat i respektojnë. Dënimet dhe ligjet i mbrojnë vlerat e një populli dhe interesat e tij, por janë të paaftë të iniciojnë zhvillimin dhe përparimin

ABDULKERIM BEKAR

Begatia e gjithëmbarshme dhe ngjitja drejtë përkryerjes kanë qenë bregat parimore dhe aspiratat thelbësore të njerëzve përgjatë historisë. Problemet paraqiten kur hulumtohen parimet, bazat dhe mjetet e nevojshme për fillimin e ndryshimit dhe për mbarëvajtjen e tij. Sipas bindjes time begatia e qytetërimeve dhe zhvillimi i tyre mbështetet në tri gjëra, që ndërliken dhe plotësojnë njëra-tjetrën. Ato janë njohuritë, edukimi dhe rregullat (ligjet) e sistematizuara. E shoh të rëndësishëm shpjegimin e këtyre tri elementëve, me qëllim që të rritet shkalla e kuptimit të tyre:

1. **Njohuritë:** Ne zotërojmë njohuri të shumta dhe kemi nevojë për shumë të tjera, por begatia ka nevojë më shumë për njohuri dhe informacione, që kanë të bëjnë me aktualitetin. Njerëzit kanë nevojë t'i njohin pikat e tyre të dobëta dhe të forta, ata kanë nevojë t'i dinë mundësitë e tyre, shanset dhe sfidat e jetës së tyre individuale.

Ata kanë nevojë emergjente ta mësojnë metodën ideale për edukimin e fëmijëve të tyre, mënyrat e mirësjelljes dhe të komunikimit me të tjerët... Janë në nevojë për këto njohuri për ta jetuar drejt jetën e tyre. Njohuritë e nevojshme duhet t'i plotësojnë me kushtet e besueshmërisë dhe të aktualitetit (të jenë në një hap me kohën). Këto kushte janë primare dhe me rëndësi të madhe, sepse shumë nga "njohuritë" që na ofrohen janë të rrejshme dhe kanë më tepër

qëllime komerciale. Aktualiteti i njohurive është po ashtu kusht thelbësor në veçanti në kohën e ndryshimeve dhe zhvillimeve të shpejta. Njohuritë me afat të skaduar nuk i sjellin dobi askujt, as individit, as shoqërisë. Në shumë shoqëri njerëzit veprojnë akoma me njohuri të vjetra, madje edhe të pavlefshme.

Duke u pasuruar me njohuri të tilla ne synojmë menaxhimin efektiv të çështjeve tona personale, qartësimin e realitetit dhe zgjedhjen e metodës më të suksesshme për të bashkëvepruar me botën, e cila ndryshon shpejt. Nëse nuk kemi një vizion të qartë do të mbetemi akoma peng i metodave dhe dokeve të trashëguara, që mbështeten në informata jo të rëndësishme dhe përvoja jo të pjekura. Mu ky realitet është ai që e bën jetën e shumicës së muslimanëve konfuzë dhe të çrregullt.

2. **Edukata:** Edukata është ajo përpjekje e bekuar, që e kryejmë në shtëpi dhe shkolla, për t'i shndërruar ato njohuri me natyrë teorike në kulturë. Me termin kulturë kam si qëllim besimin, etikën, normat, traditat dhe

“Njohuritë me afat të skaduar nuk i sjellin dobi askujt, as individit, as shoqërisë. Në shumë shoqëri njerëzit veprojnë akoma me njohuri të vjetra, madje edhe të pavlefshme...”

“Prapambetja nuk është gjë tjetër pos një realitetit në të cilin besimet dhe vlerat e njerëzve, mbesin në domenin e fjalëve dhe nuk jetësohen në sjelljet e tyre...”

zakonet mbizotëruese në një mjedis të caktuar. Edukatorët me anë të angazhimeve të tyre të vazhdueshme, formojnë individë në koherencë me momentin dhe vizionin qytetërues dhe në pajtim me njohuritë autentike për të cilët folëm më parë. Ky profesion është fisnik deri në pikën më kulmore, por ekziston një rrezik. Kur përplasen synimet e edukimit dhe realitetit të edukatorit gjatë edukimit, ndodh një çarje e personalitetit dhe me kalimin e kohës dhe zgjerimin e kësaj çarjeje jemi më afër hidhërimit hyjnor: *“O besimtarë, përse thoni atë që nuk e bëni?”* (Saf, 3).


Është fakt se shoqëria nuk do të përparojë në mënyrë të mirëfilltë, nëse edukimi në shtëpi do të ndeshet me atë që fëmijëve u ofrohet nëpër shkollë, në parime dhe në mjete. I këshillojmë prindërit që të promovojnë vazhdimisht vlera si: drejtësia, sinqeriteti, besnikëria, integriteti personal, mëshira, serioziteti, bashkëpunimi, saktësia dhe mbajtja e premtimeve... Prapambetja nuk është gjë tjetër pos një realitetit në të cilin besimet dhe vlerat e njerëzve, mbesin në domenin e fjalëve dhe nuk jetësohen në sjelljet e tyre.

3. Rregullat (ligjet) e sistematizuara: Gjithë popujt kanë kushtetuta dhe ligje, që u mjaftojnë, madje edhe u teprojnë. Dallimi mes një populli përparimtar dhe një populli të prapambetur mishërohet në faktin se këto

ligje dhe kushtetuta, a vlejnë për të gjithë njerëzit, apo vetëm për të dobëtit që detyrohen ta “pagojnë” drejtësinë ndaj tyre. Ne popujt përparimtarë kemi shumë stimulumet dhe garanci, që sigurojnë vlefshmërinë e ligjit për të gjithë.

Kur njohuritë, besimet dhe vizionet jetësohen në kulturën e njerëzve, si pasojë e edukimit të mirëfilltë, nevoja për ligje të sistematizuara del në shesh. Në zbatimin e detyrimeve dhe respektimin e ndalesave nuk mjafton vetëm vetëdija, morali dhe besimet individuale. Me zbatimin e ligjeve për të gjithë, në mënyrë transparente dhe me vendosmëri, do të mundësohet lindja e një kulture shoqërore, cilësore dhe gjithëpërfshirëse, e cila do të jetë e pranueshme për të gjithë për shkak të drejtësisë dhe logjikës së saj. Me rrënjosjen e një kulture në një mjedis shoqëror lehtësohet sjellja e ligjeve dhe e normave, që përkojnë me atë kulturë dhe kështu lind lidhja fisnike mes kulturës dhe ligjit. Atëherë kur sistemi i edukimit dështon në shprehjen e besimeve dhe vlerave të një populli në kulturën e tyre, shteti do të mundohet ta sigurojë rendin dhe ecurinë e gjërave në atë shoqëri me përdorimin e forcës së tepruar, me ligjësimin e rregullave dhe normave të reja, dhe pasojat nuk do të jenë shpresëdhënëse. Popujt çohen në këmbë nëpërmjet parimeve ku besojnë, freskohen me vlera madhështore, të cilat i respektojnë. Dënimet dhe ligjet i mbrojnë vlerat e një populli dhe interesat e tij, por janë të paaftë të iniciojnë zhvillimin dhe përparimin. Ekziston një thënie: dënimet nuk i zhvillojnë shoqëritë, por i mbrojnë ato. Ky është edhe sekret i shumica e teksteve të Kuranit dhe hadithet përqendrohen në ndërtimin e muslimanit nga brenda. Allahu është synimi i këtij shkrimi. ■

Përktheu: Talha KURTISHI



NJË PROJEKT... VETËM PËR SERIOZËT!

Mirëpo ka një projekt fitimprurës, që shumica e njerëzve e kanë anashkaluar, përveç atyre që i ka mëshiruar Allahu, dhe atë projekt e kanë lënë pas shpine, ose prej mosdijes së vlerës së tij të lartë, ose nga përtacia

ALI BATIH EL OMERI

Lexues i nderuar, më jep dy minuta nga koha jote, për të lexuar këtë shkrim, e nëse nuk ke kohë, atëherë mbylle revistën deri atëherë kur të të jepet shansi.

Njerëzit sot enden nëpër tokë djathtas e majtas, hipin nëpër male dhe lëshohen

nëpër lugina. Gjendja e tyre në jetën e përditshme është mes shkuarjes dhe ardhjes. Prej tyre ka që janë të pavarur e të tjerët që dëshirojnë të pasurohen. Të gjithë janë bërë të shkathët në tubimin e pasurisë, në kërkimin e punës dhe kjo është e vërtetë, s'ka dilema rreth kësaj. Kjo gjithashtu është e kërkuar edhe në aspektin fetar.

“Ndalem ndonjëherë në ndonjë çështje, apo në ndonjë gjë, apo rast, kërkoj prej Allahut të më falë (bëj istigfar) njëmijë herë e më shumë, apo më pak derisa më hapet gjoksi dhe e zgjidh problemin që kisha...”

Njerëzit, për t'i realizuar projektet e tyre, ka prej tyre që marrin borxh, e prej tyre që e lidhin natën me ditën në punë, prej tyre ka që marrin pjesë në gara, se ndoshta do të arrijnë ndonjë fat... për fat të keq! Te disa teprohet dashuria ndaj pasurisë, dhe e tubojnë duke lypur dhe duke thurur fjalë me të cilat e kthejnë dhembshurinë e njerëzve nga ata.

Ti nuk mundesh t'i qortosh. Çdo njëri prej tyre hulumton për kënaqësinë dhe dëshiron të sigurojë kafshatën e bukës. Çdo person orvatet të realizojë diçka nga dëshirat dhe shpresat e tij. Mirëpo ka një **projekt** fitimprurës, që shumica e njerëzve e kanë anashkaluar, përveç atyre që i ka mëshiruar Allahu, dhe atë projekt e kanë lënë pas shpine, ose prej mosdijes së vlerës së tij të lartë, ose nga përtacia, edhe pse nuk paraqet ndonjë ngarkesë, as që duhet mundim, as nuk ke nevojë të marrësh borxh, as të rrish pa gjumë, as të caktosh një kohë të veçantë. Megjithatë ai është një projekt me dobi madhështore. Ta shton kapitalin shumëfish dhe me të e arrin dashurinë e Allahut. Ai projekt është **ISTIGFARI**.

Pyete veten, a do pasuri? A dëshiron të kesh bereqetin e kopshtit dhe të lumenjve? A dëshiron të kesh fëmijë, të cilët janë edhe zbukurimi i jetës së kësaj bote? Nëse përgjigja është po, atëherë vështroje së bashku me mua këtë ajet: *“Unë u thashë: “Kërkoni falje Zotit tuaj, se Ai vërtet falë shumë. Ai ju lëshon nga qielli shi me bollëk. Ju shumon pasurinë dhe fëmijët, ju bën të keni kopshte dhe ju jep lumenj.”* Nuh 10 – 12

Kush nga ne nuk dëshiron të jetojë në mes kopshteve dhe lumenjve, e të kënaqet me këtë jetë që e ka përgatitur Allahu për ne. Kush prej nesh nuk dëshiron të ketë forcë në çdo gjë. E kujt prej neve nuk ia ka ënda për rehati shpirtërore dhe qetësi, kush nuk dëshiron t'i lahen gjynahet dhe t'i pastrohen njollat?

A nuk ka tek ne ndonjëri që dëshiron të largohen brengat – ah, sa shumë janë – në këtë kohë. Vështroje me mua këtë hadith: *“Kush bën vazhdimisht istigfar, Allahu do t'ia mundësojë për çdo brengë rahat, prej çdo ngushtice rrugëdalje dhe Allahu do ta furnizojë prej nga nuk e ka llogaritur.”* [Sunen Ibën Maxhe 3819]

D.m.th. ti duhet të bësh shpesh *istigfar*. Aliu *radijallahu anhu* ka thënë: *“Allahu nuk e frymëzon me istigfar robin e Vet që do ta dënojë”*. Allahu i Madhëruar ka thënë: *“Po, Allahu nuk do t'i dënojë ata, derisa ti (Muhamed) je në mesin e tyre dhe Allahu nuk do t'i dënojë, derisa ata kërkojnë falje (bëjnë istigfar).”* Enfal 33; pra, ka treguar se nuk e ndëshkon atë që bën istigfar, sepse istigfari e shlyen mëkatin që është shkak i ndëshkimit. Istigfari është nga shkaqet më të rëndësishme për të falur mëkatin. Kush prej neve nuk dëshiron që t'i zbrësë

mëshira e Allahut? Allahu i Madhëruar ka thënë: **“...pse të mos i kërkonit falje Allahut, që të mëshiroheni?”** Nemël 46. A ke dëshirë ta ruash shëndetin e zemrës dhe çiltërsinë e saj nga gjurmët e mëkateve? Medito rreth argumenteve të këtij hadithi: **“Robi kur bën ndonjë mëkat, i bëhet në zemër një pikë e zezë, e nëse largohet (nga mëkati), e bën istigfar dhe pendohet, i kullohet zemra.”** [Tirmidhiu 3461]

Nga eksperiencia e robërve të mirë në istigfar

Ibën Tejmije ka thënë: Ndalem ndonjëherë në ndonjë çështje, apo në ndonjë gjë, apo rast, kërkoj prej Allahut të më falë (bëj istigfar) njëmijë herë e më shumë, apo më pak derisa më hapet gjoksi dhe e zgjidh problemin që kisha. Ka thënë: Atëbotë ndodhesha në treg, apo në xhami, apo udhëtim, apo në shkollë, por kjo nuk më ndalonte nga *dhikri* dhe *istigfari* derisa të arrija atë që kërkoja. Ajo që dihet është, se çdo njeri gabimtar dhe çdo njeri që del gabimi nga ai dhe harron e bën atë që Allahu e ka bërë haram, apo e len atë që e ka bërë Allahu detyrim, nga butësia e Allahut ndaj nesh është së Allahu ka hapur për ne portën e istigfarit. Allahu i Madhëruar ka thënë: **“Edhe ata të cilët kur bëjnë ndonjë (mëkat) të shëmtuar, ose i bëjnë zullum vetvetes, e përmendin Allahun dhe kërkojnë falje për mëkatet e tyre...”** Ali Imran 135; po edhe prej mëkateve të mëdha. Dijetarët kanë thënë: Mëkati i vogël nuk është i vogël, nëse bëhet me këmbëngulje dhe mëkati i madh nuk është i madh, nëse bën istigfar për të.

Për fat të keq dikush nga njerëzit duke u treguar mendjemadh thotë: Unë nuk kam nevojë për istigfar, sepse unë nuk kam bërë mëkate. Ne i themi atij që

“...Mëkati i vogël nuk është i vogël, nëse bëhet me këmbëngulje dhe mëkati i madh nuk është i madh, nëse bën istigfar për të...”

mendon kështu: Allahu na ka urdhëruar me të dhe ka thënë: **“...e kërkonit falje prej Allahut, se Allahu është mëkatfalës, mëshirues.”** Muzemil 20. Zotëria i të gjithë njerëzve, të cilit i janë falur të gjitha mëkatet, të kaluarat dhe të ardhmet, bënte shumë istigfar. Nga Ebu Hurejra na përcillet, se ka thënë: E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut *salallahu alejhi ue selem* duke thënë: **“Vallahi, unë vërtetë bëj istigfar dhe teube gjatë ditës më shumë se shtatëdhjetë herë.”** [Buhariu 6307]

Nga ajo që mund t'i inkurajojmë njerëzit për istigfar është nxitja për *sejidul istigfarin* (zotëria i kërkim-faljes). Nga Shedad ibën Eusi na përcillet, se Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem* ka thënë: *Sejidul-istigfari është të thuash: “O Allah, ti je Zoti im, nuk ka të adhuruar tjetër përveç Teje; Ti më ke krijuar dhe unë jam robi Yt, do të qëndroj besnik ndaj marrëveshjes dhe premtimit Tënd, me sa të kem mundësi; Kërkoj mbrojtjen Tënde nga e keqja që kam vepruar. Unë jam mirënjohës ndaj dhuntive të Tua, i pranoj mëkatet e mia, prandaj më fal, sepse mëkatet nuk mund t'i fali askush tjetër përveç Teje”*. Ka thënë: **“Kush e thotë gjatë ditës me bindje në të, e nëse vdes gjatë ditës para së të ngrysë, ai do të jetë nga banorët e xhenetit, e nëse e thotë**

gjatë natës i bindur në të, e vdes para se të gdhijë, ai do të jetë nga banorët e Xhenetit.” [Buhariu 6036] Ibën Haxheri ka thënë: Në këtë (hadith) ka një lajm për umetin e tij, se njeriu nuk mundet t’i kryejë i vetëm të gjitha detyrimet që ka ndaj Allahut, e as t’i realizojë plotësisht ibadetet e të falënderojë Allahun për të mirat ndaj tij, prandaj Allahu ka qenë i Butë ndaj robërve të Vet dhe i ka ngarkuar me istigfar, duke plotësuar kështu të gjitha.

A e keni kuptuar, o ju dashamirë, se istigfari është shkak i rëndësishëm për gjëra të mira në jetën tonë dhe se këto gjëra, po të realizoheshin të gjitha apo disa, njërit nga ne, do të jetonte si mbret. Ne veçanërisht besojmë, se këto gjëra nuk janë të pamundshme dhe të vështira për Allahun. Në dorën e Allahut janë depot e çdo gjëje dhe mëshira e Tij e ka tejkaluar ndëshkimin e Tij. Mëshira e Tij ka përfshirë çdo gjë.

Ibën Kajimi ka thënë: Allahu i Madhëruar me urtësinë e Tij ia ka mbizotëruar një armik (njeriut), i cili i di rrugët e devijimit dhe sherrit në të cilat e cyt, duke qenë shumë i shkathët dhe lakmues, as nuk lodhet që të bëhet për pushim e as për gjumë. Njëra është – dhe që e ka si qëllimin kryesor - që ai (djalli) të ndërhyjë në mes tij dhe mes diturisë e imanit për ta çuar në kufër. Nëse ai ngadhënjën në këtë gjë, atëherë ka mbaruar me te dhe pushon nga ai, nëse i shpëton kjo, e ai (njeriu) udhëzohet në Islam, ai (djalli) lakmon në atë që vjen në radhë pas kufrit, e ajo është bidati. Kjo tek ai është më e dashur se mëkati. Për mëkatin ka pendim dhe falet, ndërsa për bidatin nuk ka pendim, sepse ai që e bën

bidatin mendon se është në udhëzim të drejtë dhe nuk pendohet dot. Tregohet se Iblisi ka thënë: U shkatërruan bijtë e Ademit me mëkate, ndërsa mua më kanë shkatërruar (ata) me istigfar dhe me “*la ilahe il-lallah*”, e meqë e kam vënë re këtë tek ata, i kam shpërndarë mes tyre epshet e kështu ata bëjnë mëkate, por nuk pendohen, sepse mendojnë se janë duke vepruar mirë. Nëse ngadhënjën në këtë, e bën nga anëtarët e vet dhe nga prijësit. Nëse edhe kjo i dështon, përpiqet ta angazhojë me vepra të kota e t’i lejë veprat e dobishme. Nëse dështon, kalon në përpjekjen për ta larguar nga adhurimi, apo ibadeti që e ka bërë vazhdimisht: e pengojnë, e fyejnë, i shpifin që ta brengosin dhe ia angazhon zemrën nga dituria dhe vullneti për punë.

Në fund, përsërite dhe shpeshtojë istigfarin dhe thuaj kurdoherë fjalën “*estagfirullah*” (kërkoj falje prej Allahut), në këmbë, ulur, në udhëtim, apo në vend, gjatë pushimit, kur je edhe me punë serioze, në shtëpi, apo në punë, i shtrirë, apo gjatë ndërrimit të krahut në shtrat, gjatë ecjes, apo gjatë vrapimit, kur pi dhe kur ha, kur je hipur në mjetet e transportit, apo kur ecën në këmbë, në të gjitha punët, çdo herë kur të kujtohesh dhe bëje moton tënde, dhe mos harro të kërkosësh falje edhe për besimtarët e besimtare, e po ashtu për shkruesin e këtyre rreshtave (edhe për përkthyesin), dhe për secilin që shkruan, apo lexon, apo e mundëson të dali në dritë kjo revistë shumë e vlefshme. ■

Përktheu: Ali SHABANI



(I)

Nuk është zgjuarsi dhe mençuri, nëse ke mësuar dhe kuptuar se do të vdesësh, sepse një gjë të tillë nuk e mohan askush, madje as ateistët dhe materialistët, sepse ky është një fenomen, që njerëzit e shohin dhe e përjetojnë çdo ditë. Porse vetë zgjuarsia dhe mençuria është të dish se çdo të ndodhë me ty o njeri pas vdekjes?

SHKRUAN: BLEDAR HAXHIU

Falënderimi i takon Allahut, Fuqiptotit e Madhështorit Suprem, *i cili ka krijuar jetën dhe vdekjen, për t'ju provuar se kush prej jush do të veprojë më mirë*. Paqja, nderimi dhe bekimi qofshin për Profetin Muhamed, të cilin *Allahu e dërgoi në mesin e njerëzimit, si pishtar ndriçues dhe thirrës për në rrugën e Allahut, për t'i nxjerrë njerëzit nga errësira në dritë*, nga mohimi në besim. Paqja dhe bekimi qofshin edhe mbi familjen e tij të nderuar e mbi shokët e tij besnikë, si dhe të gjithë

ata që ecin gjurmëve të tyre deri në ditën e Ringjalljes.

Në këtë shkrim do të flasim për Berzehun, botën pas vdekjes, e cila bën pjesë në besimin e muslimanit, e ku madje ai nuk mund ta marrë këtë status (të besimtarit), nëse nuk beson në të. Megjithatë na duhet të theksojmë, se ky besim është i lidhur ngushtë me besimin tek Allahu i Lartësuar –Krijuesi i gjithësisë-, sa më real dhe i fortë të jetë besimi tek Allahu te dikush, aq më i pranishëm dhe i fortë do të jetë edhe besimi në botën e përtejme, i cili fillon me vdekjen. Por në të njëjtën kohë duhet të pohojmë, se nuk

¹ Berzehu tek arabët në aspektin leksikor ka kuptimin: pengesë midis dy gjërave, Allahu e përmend në Kuran këtë fjalë me të njëjtin kuptim ku thotë: “...duke ngritur pengesë (Berzeh) e kufi të prerë ndërmjet tyre”. Sure Furkan, 59. Ndërsa në aspektin fetar ajo përdoret me kuptimin: gjendja e cila pason vdekjen deri në ditën e Ringjalljes, Allahu në lidhje me këtë thotë: “Prapa (vdekjes së) tyre do të ketë një (kohë) ndarëse (Berzeh), deri në ditën kur do të ringjallen”. Sure Muminun, 100.

“Nëse beson në Zot dhe ende je në dyshim rreth botës së berzehut, apo botës tjetër në përgjithësi, thuaji vetes: Bindu, sepse ky është lajm i Zotit tënd, që është mbi lartësi, që me Madhështinë e Tij krijoi universin madje dhe vetë ty, o njeri....”

është zgjuarsi dhe mençuri, nëse ke mësuar dhe kuptuar se do të vdesësh, sepse një gjë të tillë nuk e mohon askush, madje as ateistët dhe materialistët, sepse ky është një fenomen, që njerëzit e shohin dhe e përfjethojnë çdo ditë. Porse vetë zgjuarsia dhe mençuria është të dish se çdo të ndodhë me ty o njeri pas vdekjes? Çfarë fsheh kjo botë (berzehu), që ne nuk e shohim? Ku do të shkojmë? Çfarë do të na ndodhi e si duhet të përgatitemi? Pra, i mençur është vërtet ai që thellohet në këto enigma² për atë që ende nuk e ka ndërtuar këtë besim, dhe që kërkon ta zbulojë atë nëpërmjet lajmeve të sigurta,³ në mënyrë që të përgatitet për të.

Kur diskuton me njerëzit rreth këtij fenomeni shikon reagime të ndryshme dhe dëgjon kontestime të llojllojshme, ku ndër më të spikaturat është: **kush ka shkuar në atë botë dhe të kthehet e të na tregojë se**

ç’po ndodh atje në të vërtetë?

Njeriu si qenie është shumë i dhënë pas perceptimit të gjërave, të cilat i ndjen dhe i kupton me anë të shqisave, ndaj dhe shpeshherë ai e kufizon besimin e tij vetëm në atë që arrin të zbulojë nëpërmjet tyre. Por na duhet të pohojmë, se njeriu si krijesë jo çdo gjë e percepton me shqisa⁴, sepse vetvetiu ai do të privohej nga shumë gjëra, të cilat e rrethojnë në botën që ai po jeton, e ç’mund të thuash për botën tjetër. Të gjithë e dimë se shqisat zhvillohen dhe avancojnë në përputhje me zhvillimin e njeriut,⁵ por përsëri shqisat nuk arrijnë t’i kuptojnë ato për të cilat mes njeriut dhe diçkaje ka një perde ndarëse, sikurse është edhe berzehu.

Pastaj le t’i kthehemi pyetjes tonë: vallë kush ka shkuar në atë botë dhe të kthehet e të na e tregojë se ç’po ndodh atje në të vërtetë? A nuk e kupton se kjo pyetje mbart në vetvete edhe cektësinë e atij që e drejton atë pyetje! Sepse një njeri i tillë, nëse do ta vinte sado pak në përdorim logjikën e thjeshtë do ta zbulonte vetë këtë përgjigje.

A nuk e shohim, se si ne kalojmë nëpër etapa të ndryshme –disa le t’i quajmë edhe botë- gjatë gjithë jetës sonë, atëherë kur jeta jonë në etapat e saj ndryshon kaq shumë, si kërkojmë që të krahasojmë berzehun me të? Jeta –apo etapa-, në të cilën jemi na e ka dhënë përgjigjen e pyetjes së shumë njerëzve, të cilët mendojnë njësoj si ai që pyet kështu.

Si mund ta harrojë dikush, se ka qëndruar në barkun e nënës së tij për nëntë muaj rresht, në ujë, në një

² Ndërsa janë reale si drita e diellit për ata që kanë besim të thellë tek Allahu dhe që besojnë fuqishëm se Allahu ka mundësi për çdo gjë dhe se rikrijimi është më i lehtë se krijimi fillestar pa pasur një shembull të mëparshëm.

³ Fjalës së Allahut dhe rrëfimeve të Profetit Muhamed sal-lallahu alejhi ue selem.

⁴ Shqisat e njeriut janë pesë: nuhatja, shijimi, shikimi, dëgjimi dhe prekja.

⁵ Shqisat nuk janë njësoj si te një fëmijë i porsalindur, ashtu dhe te një njeri i rritur.

temperaturë të caktuar me një sistem jetese krejt të ndryshëm nga ai i joni, pra, botë më vete. Një botë, e cila kufizohet në barkun e nënës dhe ku nuk e di se ç'po bëhet jashtë kësaj errësire në të cilën është foshnja. Më pas njeriu del në një botë tjetër dhe të re për të. Në të rritet, zhvillohet dhe punon e pajiset me inteligjencë dhe logjikë. Pas kësaj vetvetiu lind një pyetje e thjeshtë: meqenëse njeriu është i dhënë dhe e dashuron jetën, përse vallë nuk është kthyer dikush përsëri atje ku ka qenë, në atë botën e tij që tashmë e ka lënë prej kohësh, barkun e nënës. Nëse një gjë e tillë është e pamundur, atëherë është e pamundur edhe ajo që kërkojnë shumë njerëz, që të na ngjallen të vdekurit e të na tregojnë se ç'po shohin e përjetojnë!

Është e pamundur, sepse Allahu e ka vendosur kështu dhe Ai në veprimet e Tij ka vendosur urtësi të pashtershme, ku një ndër to është dhe provimi i besimit. Nëse beson në Zot dhe ende je në dyshim rreth botës së berzehut, apo botës tjetër në përgjithësi, thuaji vetes: Bindu, sepse ky është lajm i Zotit tënd, që është mbi lartësi, që me Madhëstini e Tij krijoi universin madje dhe vetë ty, o njeri.

Nëse për të besuar të panjohurat e foshnjës në botën që perceptojmë dhe shohim neve na shërben *aparati i ekos*, patjetër për të besuar atë se çfarë ndodh në botën e berzehut shërben mesazhi hyjnor, i cili përmbledhet në fjalën e Allahut dhe rrëfimet e Profetit, i cili nuk flet nga mendja e vet. A mund ta përcjellim krahasimin e asaj që thamë pak më lart nga një këndvështrim tjetër? Nëse je pranë një njeriu që fle, të cilin e njeh dhe është i besueshëm për ty, aq sa nuk dyshon në fjalët e tij, a do të besojë se ai gjatë kësaj

“Atëherë, përse kur (dikujt) i vjen (shpirti) në grykë para syve tuaj, - ndërkohë që Ne jemi më afër atij se ju, por ju nuk e vini re...”

kohe është duke u ndeshur me dikë, apo njerëz të cilët kishin ardhur e kishin marrë, e kishin çuar këtu apo aty dhe se kishin vepruar me të, këtë e atë. Pra, njeriu në gjumë mund të ndiejë dhe të përjetojë ato që për ne mund të jenë të pabesueshme, njeriu në gjumë mund të vuajë e të lumturohet, e megjithatë ne përsëri nuk shohim dhe nuk kuptojmë asnjërin prej këtyre gjërave, edhe pse mund të qëndrojmë tërë kohës mbi kokën e tij kur fle. Aftësitë tona atëherë janë të kufizuara, sado që shkenca të evoluojë, përsëri ajo nuk mund të arrijë të depërtojë matanë kësaj perdeje për të zbuluar berzehun, prandaj që ta njohë atë njeriu ka nevojë për lajme dhe rrëfime të sigurta, por vallë, a ka fjalë më të drejta dhe premtime më të sigurta se ato të Allahut?

Megjithatë sido që ta trajtojmë këtë të vërtetë, përsëri ajo mbetet një cilësi e besimtarëve, të atyre që besojnë në të fshehtë, ndaj dhe Allahu e ka renditur këtë ndër cilësitë e para të besimtarit, ku thotë: *“Elif, Lâm, Mîm. Ky është Libri në të cilin nuk ka dyshim. Ai është udhërrëfyes për të devotshmit, të cilët besojnë në të fshehtë...”*⁶

Berzehu është një realitet me të cilin do të përballet çdokush në momentet e vdekjes, madje ende pa dalë nga kjo botë, sepse njeriut kur është në dalje nga kjo

⁶ Bekare, 1-3.

botë për në botën tjetër, atij i zbulohet perdja dhe sheh e përjeton atë që ndoshta shumë e mohojnë. Allahu i Madhëruar thotë: **“Agonia e vdekjes do të sjellë të vërtetën (e jetës tjetër)...”**⁷

Realiteti i botës tjetër vjen menjëherë me shfaqjen e melaqeve, të cilët do të vijnë për të marrë shpirtin e njeriut. Njeriu në ato momente sheh melaqet e mëshirës ose të dënimit, shpirti i tij ose përgatitet për të dalë, ose shpërndahet nëpër trup nga tmerri dhe ankthi, që e kap nga kjo gjendje e tmerrshme dhe e pazakontë.⁸ Allahu thotë në Kuran: **“Me të vërtetë, atyre që thonë: “Zoti ynë është Allahu”, e pastaj vazhdojnë të vendosur në rrugën e drejtë, do t’u zbresin engjëjt (para vdekjes) e do t’u thonë: “Mos u frikësoni dhe mos u pikëlloni! Dhe gëzojuni Xhenetit që ju është premtuar. Ne jemi mbrojtësit tuaj në jetën e kësaj bote dhe në botën tjetër. Atje do të keni çfarë t’ju dëshirojë zemra dhe çfarë të kërkoni, dhuratë e pasur prej një Zoti Falës dhe Mëshirëplotë.”**

Në një ajet tjetër i Gjithëpushtetshmi thotë: **“Ah, sikur t’i shihje keqbërësit gjatë agonisë së vdekjes, kur engjëjt zgjasin duart (duke thënë): “Dorëzoni shpirtat tuaj! Sot ju do të ndëshkoheni me dënim poshtërues për shkak të pavërtetave që keni thënë për Allahun dhe që keni shpërfillur shpalljet e Tij”.**¹⁰

Një nga komentuesit e Kuranit Ibën Kethiri –pastë rahmet-, ka thënë: “Në këtë ajet Allahu i drejtohet Muhamedit: “Sikur t’i shihje o Muhamed sesi melaqet ua

marrin shpirtin jobesimtarëve, padyshim që do të shihje një pamje të frikshme dhe të tmerrshme”.¹¹ Njerëzit përçark atij që është duke përjetuar vdekjen, nuk shohin dhe nuk i kuptojnë ato që përjeton ai që po vdes, kjo edhe pse është një lloj prove për të parë vërtetësinë e besimit të njerëzve në Allahun dhe Lajmet e Tij është edhe një lloj mëshire për ata, sepse nuk do të mund të jetonin, nëse do të përballeshin me pamje të tilla të pazakonta. **“Atëherë, përse kur (dikujt) i vjen (shpirti) në grykë para syve tuaj, - ndërkohë që Ne jemi më afër atij se ju, por ju nuk e vini re...”**¹²

Në këto çaste kur njeriut i shfaqen fshehtësitë dhe i hiqet perdja, në çastin që ia marrin shpirtin dhe sigurohet se do të dalë para Allahut, nuk ka rrugëdalje, e di se ka gabuar dhe bëhet pishman, që s’ka besuar ndaj dhe do të thotë fjalët, të cilat na i përmend Allahu i Madhëruar: **“Kur i vjen vdekja ndonjërit prej tyre (jobesimtarëve), ai thotë: “O Zoti im, më kthe, që të bëj vepra të mira në botën që kam lënë!” Kurrsesi! Me të vërtetë, kjo është një fjalë të cilën ai (kot) e thotë! Prapa (vdekjes së) tyre do të ketë një (kohë) ndarëse deri në ditën kur do të ringjallen”.**¹³ ■

(vazhdon)

⁷ Kaf, 19.

⁸ Në fakt ky është shpirti i jobesimtarit, i cili pasi e ka mohuar këtë të vërtetë të padiskutuëshme e di se përballja e tij me Zotin do të jetë e vështirë.

⁹ Fusilet, 30-32.

¹⁰ Enam, 93.

¹¹ Tefsiri i Ibën Kethirit, 4/76.

¹² Vakia, 83-85.

¹³ Muminun, 99-100.

PËRCJELLJA PËR NË AHIRET

Përgatitja dhe përcjellja e të vdekurit nuk është detyrim i hoxhës, siç është përhapur te masa e rëndomtë, madje edhe te shumë hoxhallarë, të cilët për çudi shpeshherë ndjehen të privilegjuar me këtë. S'do mend që përgatitja dhe përcjellja e xhenazes ka rregulla të caktuara dhe është normale që njerëzit të mos i njohin ato dhe të kenë nevojë për sqarimet e hoxhallarëve, por kjo punë të konsiderohet si një ndër punët kryesore të hoxhës, me të vërtetë është nënçmim i tepruar.

SHKRUAN: OMER BERISHA

Së këndejmi, dëshiroj që në këtë tekst të sjell rregullat kryesore që kanë të bëjnë me përgatitjen dhe përcjelljen e njerëzve tanë të dashur për në ahiret, duke mos u stërzgatur në imtësi pasi këtë nuk na e mundëson natyra e revistës, kurse nuk është qëllimi im t'i ndaloj hoxhallarët të marrin pjesë nëpër varrime, sepse siç do ta përmend më poshtë, pjesëmarrja në varrime ka shpërblime të mëdha.

Duhet ta dimë se muslimani e ka borxh ta vizitojë vëllanë e sëmurë musliman dhe të fusë gëzimin në zemrën e tij, duke shprehur përgëzime dhe fjalë të ëmbla. Nëse është në



gjendje të rëndë, duhet t'i përkujtojnë pendimin, larjen e borxheve etj. Të gjitha këto duhen bërë me butësi dhe jo të shkaktojë që ai të ndjejë se i është afruar vdekja. Po ashtu edhe të kërkojë hallallin nga zullumet e bëra ndaj dikujt, të kërkojë falje për mëkatet dhe vazhdimisht të ketë mendim të mirë për Allahun. E kur t'i afrohet vdekja, ai që është afër tij e ka sunet t'ia thotë tallkinin – d.m.th. t'ia përkujtojë shehadetin, por me butësi dhe urtësi.

Pasi të vdesë, ia mbyllim sytë, ia drejtojmë dhe shtrijmë trupin – sidomos te nyjat dhe shpejtojmë ta përgatisim për varrim. I Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: *“Shpejtoni me xhenazen, nëse është e mirë, ju*

“Talha ibën Abdullah ibën Aufi përcjellë: “U fala mbrapa Ibën Abasit, kur ai po falte namazin e një xhenazeje dhe lexoi fatihanë. Pastaj tha: Që ta mësojnë se kështu është Suneti” ...”

do ta shpejtoni drejt të mirës, e nëse është e keqe, atëherë jeni duke u liruar nga një e keqe”. (Buhariu dhe Muslimi) Shpejtimi përjashtohet në rast se vdekja ndodh befasisht, pra, nga frika që të mos jetë vetëm alivanosje apo komë. Apo nëse ka ndonjë shkak për vonim – lejohet vonimi, sikurse tubimi i sa më shumë njerëzve për namaz, ardhja e të afërmve të tij – por normalisht nëse nuk tepruhet vonimi derisa të fillojë prishja e trupit.

Përgatitjen e fillojmë duke i lajmëruar familjen, komshinjtë, dashamirët dhe miqtë e të vdekurit, me qëllim që të marrin pjesë në faljen e namazit të xhenazes sa më shumë, sepse kjo është për të mirën e të vdekurit. Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: “Ai besimtar që vdes dhe ia falin xhenazen një grup muslimanësh, të cilët arrijnë tre safe, atij i falen gjynahet”. Kurse lajmërimi nëpër gazeta i bashkëngjitur me fjalë vaji dhe mërzie është lajmërimi i ndaluar dhe i ngjan asaj që bënin njerëzit në periudhën e injorancës, kur dëlnin nëpër tregje dhe lajmëronin vdekjen e dikujt duke thurur për të vargje prekëse.

Larja e xhenazes

Larja e xhenazes është farz. Për këtë dhe për formën e larjes mësojmë nga hadithi i shënuar te Buhariu dhe Muslimi: Umu Atije el Ensarije na përcjell: Kur vdiq Zejnebja, bija e

të Dërguarit *sal-lallahu alejhi ue selem*, ai hyri dhe na tha: “Lajeni tri herë, ose pesë herë apo edhe më shumë nëse e shihni të udhës, me ujë dhe sidër. Në herën e fundit të larjes bëjeni edhe me kamfur apo me pak kamfur. Kur të mbaroni (me larjen) më tregoni”. Kur përfunduar i treguam dhe ai na e dha izarin (veshje e poshtme) e tij dhe tha: “Në fillim, mbështilleni me këtë izar”. Në një transmetim tjetër: “ose shtatë herë”, ku tha po ashtu: “filloni nga ana e djathtë dhe nga pjesët e abdesit”. Umu Atije po ashtu tha: Flokët ia lidhëm në tre gërsheta. Është detyrim që gruan ta lajnë vetëm gratë, po ashtu burrin ta lajnë vetëm burrat dhe ky është mendimi i shumicës së dijetarëve. Mirëpo ka përjashtime:

- **bashkëshortët**, lejohet që ta lajë burri gruan e tij dhe anasjelltas. Argument është hadithi i Aishes: “se i Dërguari *sal-lallahu alejhi ue selem*, i kishte thënë asaj: *Po të vdisje para meje, unë do të laja ty*”. Dhe hadithi tjetër nga ajo: “*Po të kisha rastin edhe një herë, nuk do të rrija anash, nuk do të lejoja ta lante të Dërguarin askush përpos grave të tij*”. Pastaj Esmā bint Umejsi na tregon, se Fatimja ka lënë amanet, që Aliu *radijallahu anhu* ta lajë atë. Po ashtu Ebu Bekri, *radijallahu anhu* ka lënë amanet që gruaja e tij Esmā bint Umejs ta lajë atë dhe ajo e lau.

- i lejohet **babait** të lajë bijën e tij, që nuk i ka mbushur akoma shtatë vjet, po ashtu i lejohet nënës të lajë birin e saj, që nuk i ka mbushur akoma shtatë vjet.

Nga hadithi i sipërpërmendur mësojmë se është e pëlqyer, që në larjen e fundit të ketë edhe kamfur apo çfarëdo lloj parfumi tjetër, për shkak të porosisë së të Dërguarit, *sal-lallahu alejhi ue selem*. Këtë e pëlqejnë të gjithë dijetarët. Imam Neveviu thotë: “Sepse kamfuri i jep erë të mirë xhenazes, e bën të qëndrueshëm trupin e tij, e flladit dhe pengon prishjen e shpejtë të trupit”. Është e pëlqyer që larja të bëhet tri herë, nëse nuk mjafton

atëherë pesë, e nëse edhe kjo nuk mjafton atëherë edhe më shumë, por me numër tek. Është e pëlqyer që larja të fillojë nga e djathta, nga pjesët e abdesit. Te gratë, flokët shprishen dhe i bëhen në tre gërshetë, të cilat i vihen pas shpine. Ndërsa është e pëlqyeshme që auret i rëndë i kufomës të mbulohet, si dhe është e pëlqyeshme që gjatë larjes të mos e shikojë askush përveç atij që është e nevojshme të rrijë aty.

Gjithashtu të vdekurin duhet ta qefinosim doemos. Aisha *radijallahu anha*, na përcjell: “*Të Dërguarin, salallahu alejhi ue selem, e qefinosëm me tre pëlhura nga Jemeni, nga Sehuli (fshat në Jemen) të cilat ishin të bardha. Asnjëra nga ato tre (pëlhura) nuk ishte këmishë apo imame*”. (Buhariu dhe Muslimi) Imam Ahmedi ka thënë: “Hadithi më i vërtetë rreth qefinit të Resulullahut *salallahu alejhi ue selem*, është hadithi i Aishes”. Më e mira është që qefini të jetë tre palë, si dhe të mos pritët ndonjëra palë në formën e këmishës apo imames. Ky është mendimi i shumicës, të cilët mbështeten në hadithin e Aishes, edhe pse disa dijetarë thonë se është e pëlqyer të ketë këmishë dhe imame, siç veprojnë edhe në vendet tona. Këtë mendim të fundit e përkrahin Ebu Hanife dhe Maliku.

Më mirë është që ngjyra e qefinit të jetë e bardhë. Muhamedi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: “*Rrobat më të mira janë të bardhat, vishni ato dhe me to qefinosni të vdekurit tuaj*”.

Si renditen pëlhurat? Ato vendosen njëra mbi tjetrën, dhe mbi to shtrihet i vdekuri. Pastaj palosen anët e pëlhurave nga ana e epërme duke filluar nga e djathta, pastaj nga e majta. E njëjta gjë bëhet edhe me dy pëlhurat tjera. Pjesa e tepruar e qefinit duhet të mbetet nga koka, sidomos kur pëlhura është e gjatë.

Ku dhe si falet namazi i xhenazes

Namazi i xhenazes është mirë të falet në vend-falje (musala) të veçantë për xhenazet, apo në vend-faljen e bajramit, nëse njerëzit janë shumë, sepse ky është Suneti i Resulullahut *sal-lallahu alejhi ue selem*. Argument është hadithi që na e rrëfen Ibën Omeri: “Çifutët erdhën te Pejgamberi *salallahu alejhi ue selem*, dhe sollën një burrë dhe grua, të cilët kishin bërë zina, dhe i gurëzuan **afër vendit ku faleshin xhenazet**, afër xhamisë”. Pra, dihej qartë vendi ku faleshin xhenazet. Mirëpo nëse xhenazja falet në xhami, si është meseleja?

- Është mekruh, kanë thënë malikitë dhe hanefitë, duke e mbështetur këtë mendim në një hadith nga Ebu Hurejre: “*Kush ia fal xhenazen dikujt në xhami, ai s’ka bërë gjë*” (Ebu Davudi).

- Lejohet. Argument është ajo që thotë Aisha *radijallahu anha*: “*Resulullahu salallahu alejhi ue selem, ia ka falur xhenazen brenda xhamisë Suhejl ibën Bejdasë*”. (Muslimi). Ky është mendimi i vërtetë, kurse argumenti i mendimit të parë është i dobët.

Nëse i vdekuri është grua, imami duhet të qëndrojë pranë mesit të saj, por nëse i vdekuri është mashkull, atëherë imami duhet të qëndrojë pranë kokës së tij. Argument për këtë është hadithi, të cilin e shënon Tirmidhiu nga Ebu Galibi: “*E fala një namaz xhenaze, ku imam ishte Enes ibën Maliku, i cili u vendos në drejtim të kokës së tij. Më pas sollën një xhenaze grua prej kurejshëve dhe i thanë: O Ebu Hamza, falja edhe kësaj xhenazen dhe ai u ndal në drejtim të mesit të saj. Ala ibën Zijadi i tha: “Kështu e kam parë edhe të Dërguarin salallahu alejhi ue selem, njësoj sikur u vendose para kësaj gruaje dhe njësoj sikur u vendose para atij burri.”* Ashtu është – tha Enesi, dhe kur mbaroi tha: *Mbajeni mend këtë gjë*”.¹

¹ Sahihu Tirmidhi nr. 1034.

Numri i tekbirove të namazit të xhenazes është katër dhe këtë e përkrahin shumica e dijetarëve. Por në Sahihun e Muslimit është vërtetuar se Resulullahu *sal-lallahu alejhi ue selem*, fali një namaz xhenaze me pesë tekbirove. Pra, nëse ndonjëherë shtohen tekbirot, por më së shumti deri në nëntë, siç tregohet në transmetime të vërteta, nuk prishë gjë, madje është e lëvdur pasi ashtu ngjallet sunet më shumë.

Pasi thotë tekbinin e parë dhe i ngre duart, duhet të lexojë: **Eudhu bilahi mine shejtani raxhim, Bismilahi Rahmani Rahim** dhe suren **Fatiha** deri në fund, sepse Talha ibën Abdullah ibën Aufi përcjellë: *“U fala mbrapa Ibën Abasit, kur ai po falte namazin e një xhenazeje dhe lexoi fatihanë. Pastaj tha: Që ta mësojnë se kështu është Suneti”*.² Dikush thotë se sureja Fatiha nuk duhet të lexohet dhe në vend të saj duhet të lexohet **“Subhaneke...”**, por si duket u ka ikur argumenti i sapopërmendur nga Ibën Abasi, *radijallahu anhum*a. Kurse theksimi që bëhet në trojet tona se lutjes **“Subhaneke...”** dashka shtuar pjesën **“ue xhele thenauke”**, është një veçim krejt i paargumentuar.

Pas Fatihës thuhet tekbirot i dytë, dhe atëherë dërgojmë salavate mbi Pejgamberin, *sal-lallahu alejhi ue selem*, duke lexuar: **Allahume sali ala Muhamed ue ala ali Muhamed kema salejte ala Ibrahim ue ala ali Ibrahim ineke hamidun mexhid. Allahume barik ala Muhamed ue ala ali Muhamed kema barekte ala Ibrahim ue ala ali Ibrahim ineke hamidun mexhid.**

Pas tekbitit të tretë lexojmë një prej duave të xhenazes, sikurse: **“Allahume gfir lihajina ue mejitina ue shahidina ue gaibina, ue sagirina ue kebirina, ue dhekerina ue unthana. Allahume men ehjejtehu mina feahjih i al el islam ue men tevefejtehu mina fetevefegu al el iman. Allahume la tehrimna**

exhrehu ue la tudilena badehu – O Allah, fali të gjallët dhe të vdekurit tanë, të pranishmit tanë dhe ata që mungojnë, meshkujt tanë dhe femrat. O Allah, kujt nga ne që i jep jetë, jepi jetë në Islam, ndërsa kujt prej nesh ia merr shpirtin, merrja me iman. O Allah, mos na privo nga shpërblimet e këtij dhe mos lejo që pas atij të devijojmë”. Pas kësaj duaje, themi edhe tekbinin e katërt dhe japim selam. Nëse jep selam vetëm në njërën anë, mjafton.

Bartja e xhenazes

E kemi borxh ta bartim kufomën e muslimanit derisa t’ia falim xhenazen dhe ta varrosim, madje me këto veprime fitojmë shpërblime të mëdha. Ebu Hurejre *radijallahu anhu*, përcjell se i Dërguari *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: *“Kush përcjell një xhenaze derisa t’i falet namazi ai ka shpërblim një kirat, e kush qëndron derisa të varroset ai ka shpërblim dy kirate”*. Ç’janë dy kirate? – e pyetën. *Sa dy kodra të mëdha* – u përgjigj Resulullahu *sal-lallahu alejhi ue selem*.³ Ndërsa sipas Muslimit: *“Prej atyre të dyjave, më e vogla është sa kodra e Uhudit.”*

Përcjelljen e xhenazes e bëjnë burrat, por jo edhe gratë, sepse Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, i ka ndaluar ato të përcjellin xhenazet dhe të vizitojnë varrezat. Gjatë përcjelljes lejohet të ecet para dhe mbrapa xhenazes, nga e djathta dhe nga e majta, përveç nëse është i hipur (në ndonjë mjet udhëtimi), atëherë duhet të vijë mbrapa xhenazes. Më e mira është që xhenazja të përcillet në këmbë, sepse një shok i Pejgamberit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, na rrëfen: *“I Dërguari, paqja dhe bekimet qofshin me të, ishte duke përcjellë një xhenaze, kur i sollën një kafshë që të hipte, ai refuzoi, ndërsa në të kthyer kur ia sollën sërish kafshën, ai hipi. Atëherë e pyetën për këtë dhe ai tha: “Melaiket vinin duke ecur (në*

² Buhariu nr. 1249

³ Buhariu dhe Muslimi

këmbë), *ndërsa unë nuk doja të hipi kur ato ecnin, e kur shkuan atëherë hipa*”.⁴

Kurse bartja e xhenazes me qerre apo vetura të posaçme për kufoma dhe përcjellja e xhematit duke qenë të hipur secili nëpër vetura, Albani, Zoti e mëshiroftë, thotë se kjo formë është krejtësisht e papranuar, madje shton: “I Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: “*Përcillni xhenazet që ta kujtoni ahiretin*”, kurse përcjellja e xhenazes në atë formë e hedh poshtë këtë qëllim madhështor. Dihet fare mirë se bartja e xhenazes mbi supe dhe të parët e përcjellësve këtë xhenaze mbi supet e tyre ndikon në përkujtimin dhe këshillimin e njerëzve më shumë sesa forma e lartpërmendur. Nuk do ta teproja kur them se ajo që i shtyu evropianët ta praktikojnë atë formë është frika e tyre nga vdekja dhe nga gjithçka që aludon për këtë.”⁵

Varrosja e xhenazes

E kemi detyrim t’i varrosim të vdekurit, edhe në qoftë se nuk janë muslimanë, mirëpo muslimani nuk varrosset te varrezat e jomuslimanëve dhe as e kundërta. Nga Suneti është që njeriu të varrosset në varreza dhe jo në xhami apo në oborrin e xhamisë, siç vërehet në disa vende. Ndërsa varrimi i Pejgamberit, *alejhi salatu ue selam*, në shtëpinë e tij u bë për shkak se veçori e pejgamberëve ishte që të varrosen aty ku vdesin. Gjithashtu përjashtim nga ky rregull bëjnë edhe shehidët e betejave, ata varrosen aty ku kanë rënë dëshmorë. Vendosjen e xhenazes poshtë në varr e bëjnë burrat, edhe nëse xhenazja është grua. Më të afërmit duhet ta bëjnë këtë dhe lejohet që burri ta vendosë gruan e tij në varr, por mundet edhe

kushdo tjetër, me kusht që asnjëri nga ata (përfshirë edhe burrin e saj) të mos ketë pasur marrëdhënie intime mbrëmjen e kaluar.⁶ Duke shtrirë xhenazen në varr duhet thënë: “*Bismilah ue ala suneti Resulilah* – Në emër të Allahut dhe sipas Sunetit të Dërguarit të Allahut”.⁷

Gjatë varrimit, gjithashtu është e lejuar, që nëse aty ka ndonjë njeri të ditur, të ngrihet dhe t’i përkujtojë pjesëmarrësit për vdekjen dhe ç’ka pas saj, siç ka bërë Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*.⁸ Pastaj mbyllet varri duke mos shtuar mbi të më tepër dhë sesa është nxjerrë nga vetë ai varr. Vendoset një gur apo diçka tjetër mbi varr, me qëllim që të vërehet se është varr, si dhe mund të varrosë dikë tjetër prej familjes së të vdekurit në afërsi të tij në të ardhmen.⁹ Sipas mendimit më të vërtetë, nuk duhet t’i këndohet tallkimi pas varrimit, sepse hadithi që e ligjëron atë nuk është i saktë. Më e mira është të rrimë pranë varrit dhe të kërkojmë falje dhe përforcim për vëllanë/motrën tonë. Ashtu na mëson Osmani, *radijallahu anhu*, i cili përcjell se kur Muhamedi, paqja dhe bekimet qofshin me të, mbaronte me varrimin e një personit, thoshte: “*Kërkoni falje për vëllanë tuaj dhe lutuni të jetë i qëndrueshëm, sepse ai tani po pyetet*”.¹⁰

Këto që përmendëm këtu janë gjërat kryesore që duhen bërë gjatë përgatitjes dhe përcjelljes së xhenazes. Kurse shumë gjëra të tjera që janë përhapur në popullin tonë janë, ose tradita, ose bidate, të cilat nuk lejohet të veprohen. Allahu na e marrtë shpirtin me iman dhe na mundësoftë xhenetin më të lartë, Xhenetin Firdeus. ■

⁴ Sahihu Ebu Davud nr. 3177

⁵ Ahkamul Xhenaiz fq. 99

⁶ Shih komentin e hadithit nr. 1205 te Sahihul Buhari, kapitulli: Xhenazet.

⁷ Sahihul Xhami nr. 832

⁸ Sahihul Xhami nr. 1676

⁹ Ahkamul Xhenaiz fq. 197

¹⁰ Sahihu Ebu Davud nr. 3221



THELBI I ZGJIDHJES

Pavarësisht situatës dhe moshës së cilido muslimani, leximi dhe mësimi i pasionuar, me vëmendje dhe përkushtim përbën një nismë të rëndësishme në rrugën për ta larguar ngecjen dhe për të ecur në drejtim të avancimit personal.

PËRZGJODHI: AGRON TERZIQI

Përparimi dhe ngecja janë dy procese të komplikuar, të cilat për nga natyra zhvillohen gradualisht. Kur njerëzit arrijnë të kuptojnë, se janë duke vuajtur nga pasojat e ngecjes ata nisin të mendojnë seriozisht se si të dalin nga kjo gjendje. Fillimisht ata e marrin këtë si diçka të lehtë, por më pas u bëhet e qartë se çështja është pak më e ndërlikuar seç duket në shikim të parë. Në të shumtën e rasteve ata kanë mospajtime rreth përcaktimit të përkufizimit të prapambetjes, të realitetit, të shenjave dhe manifestimit të saj në shoqërinë e tyre. Pasi e tejkalojnë këtë fazë, atëherë ata përballen me një problem tjetër, e që ka të bëjë me identifikimin e saktë të hapit të parë dhe zbulimin e thelbit të zgjidhjes për të mënjanuar ngecjen.

Rreth kësaj çështjeje nuk mjaftojnë vetëm idetë dhe meditimi. Kuvendet dhe takimet e tyre shoqërohen me diskutime dhe debate të

shumta rreth daljes nga kjo gjendje, megjithëse rrallëherë ndodh që ato tubime të prodhojnë rezultate konkrete, edhe pse debatet mund të çojnë tek pozitiviteti, sepse arrijnë deri-diku të plotësojnë perceptimet rreth kësaj problematike. Të shumtë janë ata që dëshirojnë të marrin pjesë në këso diskutimesh, duke kontribuar me propozime të thukëta në përcaktimin e hapit të parë ose gjetjes së thelbit të zgjidhjes.

1 - Ajeti i parë që i zbriti të Dërguarit tonë Muhamedit - paqja dhe lavdërimi i Zotit qoftë për të - vë në pah leximin, si provë e qartë se problemi i arabëve në fillim të Islamit ishte injoranca: Padituria për Zotin, për veten, realitetin dhe format e përparimit. Ndërsa shekuj më vonë umeti islam u gjend buzë vorbullës së ngecjes dhe prapambetjes, duke rikthyer injorancën përsëri, plagë kjo më e madhe nga e cila vuan umeti sot. Injoranca është një fjalë e rëndë me përmbajtje komplekse. Ajo është një sfidë e madhe për ne, ashtu që të kuptojmë shkallën e vuajtjeve

që na vijnë prej saj. Këtë katandisje e kuptojmë vetëm atëherë kur mjetet mësimore dhe resurset tona i krahasojmë me ato të vendeve dhe popujve të tjerë.

Për të dalë me të vërtetë nga kriza duhet të thellohemi në hulumtime shkencore dhe të përqendrohemi në dije, duke i vënë pastaj këto në funksion të zbulimit të alternativës së sigurt, e cila do të na mundësojë daljen nga kjo gjendje. Pavarësisht situatës dhe moshës së cilido muslimani, leximi dhe mësimi i pasionuar, me vëmendje dhe përkushtim përbën një nismë të rëndësishme në rrugën për ta larguar ngecjen dhe për të ecur në drejtim të avancimit personal. Sot mund të themi se rinia jonë në raport me dijen është e ndarë në tri kategori:

- **Grupi i parë** - që ka edhe numrin më të madh- mban qëndrim indiferent ndaj diturisë dhe leximit. Ata preokupohen me shumë gjëra, por që nuk kanë ndonjë lidhje me shkencën dhe dijen.

- **Grupi i dytë** - që është më i vogël se i pari - shpreh njëfarë interesimi për të nxënë dije dhe t'ua përcjelli atë të tjerëve.

- **Grupi i tretë** - i cili është më i pakti në numër - prodhon dhe zbulon dituri, dhe përpiqet të gjejë destinacionin e tyre.

Rrjedhimisht, thelbi i zgjidhjes për shumicën e të rinjve është kalimi prej grupit të parë në të dytin. Ndërsa për grupin e dytë, thelbi i zgjidhjes është që të bëjë përpjekje maksimale për t'u avancuar në grupin e tretë, duke u marrë më seriozisht dhe me ngulm me hulumtime dhe kërkime shkencore për të prodhuar më pas njohuri të reja.

Në këtë kohë asnjëri prej nesh nuk duhet të qëndrojë duarkryq dhe të luajë rolin e spektatorit, por duhet të veprojmë, ashtu siç bënë popujt e tjerë, që shkencën e morën si një pikë fillestare për të dalë nga prapambetja dhe e shfrytëzuan atë si një nismë për të ndryshuar dhe dominuar botën. Nga kjo konstatojmë, se preokupimi ndaj leximit,

“...Asnjëri prej nesh nuk duhet të qëndrojë duarkryq dhe të luajë rolin e spektatorit, por duhet të veprojmë, ashtu siç bënë popujt e tjerë, që shkencën e morën si një pikë fillestare për të dalë nga prapambetja ... ”

edukimit, arsimimit, kulturës dhe mbështetja në dituri konsiderohen si themel i përparimit. Këto që u përmenden deri tani janë një pjesë e thelbit të zgjidhjes, porse ka edhe gjëra të tjera të rëndësishme, që duhet të angazhohemi për t'i plotësuar, të tilla si:

1 - Zgjerimi i hapësirës së kritikës

Paraqitja e vërejtjeve dhe gatishmëria për të treguar në masë të madhe transparencë është më se e nevojshme. Duhet gjithmonë të kihet parasysh, se kritika nuk ka si qëllim të zbulojë të metat ose mangësitë. Ajo ka si qëllim studimin e dukurisë, përmirësimin dhe paraqitjen e saj, në mënyrë të drejtë dhe të plotë, duke i shkoqitur aspektet pozitive dhe negative, të sakta dhe të pasakta të saj. Kjo konsiderohet ngritje e vetëdijes dhe nivel i lartë i të kuptuarit të gjendjes së përgjithshme të njerëzve, vendit dhe situatave.

Ne jemi të vetëdijshëm sot më shumë se kurrë më parë, se prania e vlerave, idealeve dhe standardeve në jetën tonë të përditshme na e lehtëson rrugën e kthimit, kur e kuptojmë se kemi qenë në drejtim të gabuar. Nëse nuk lejojmë që kritika të shfaqet haptas, dhe nëse nuk e zgjerojmë më shumë rrethin e monitorimit mbi institucionet dhe shërbimet

publike, atëherë rezultati i pritur do të jetë: përhapja e korrupsionit, padrejtësisë, ryshfetit, gënjeshtërisë, keqpërdorimit etj. Këto na bëjnë të humbasim dy gjëra të vlefshme, që janë një pjesë e kapitalit tonë shoqëror: mirëbesimin dhe besueshmërinë. Ndërsa rreziku i kësaj është se kur pjesëtarët e asaj shoqërie e humbin besimin ndërmjet vetes, atëherë këtë nuk do të mund ta rikthejnë vetëm e vetëm pas disa dekadave apo shekujve!

2 – Konvertimi i vlerave në veprim

Kjo nënkupton gjetjen e mjeteve, sistemeve dhe mekanizmave, që ndihmojnë në pasqyrimin dhe zbatimin në jetën publike të vlerave dhe idealeve të larta në të cilat besojmë. Kjo pikë është shumë e rëndësishme, sepse pavarësisht vlerave të mëdha dhe pozitive që kemi, duhet ditur se ato nuk realizohen vetvetiu. Ato kanë nevojë për kushte dhe instrumente, që t'i nxisin njerëzit t'i pranojnë ato dhe të veprojnë sipas tyre. Për shembull, parimi i drejtësisë. Ky është një standard, që mbi të janë krijuar qiejt e Toka dhe shenjtëria e saj, është parim i njohur për të gjithë njerëzit, por ajo do të mbetet e pazbatuar po të mos sigurojmë një gjyqësor që është i pavarur me integritet dhe besueshmëri të plotë. Të njëjtën analogji mund ta përdorim edhe me vlera të tjera, siç është ofrimi i ndihmës për nevojtarin, vlerë për të cilën pajtohemi që të gjithë pa dallim, mirëpo shumicës prej nesh i kalojnë muaj dhe vite të tëra pa i ndihmuar askujt. Kjo vlerë nuk mund të shndërrohet në veprimin e duhur, përderisa nuk krijohen institucione, që ofrojnë programe të qarta për të pranuar ndihma vullnetare dhe për t'i ndihmuar ata që janë në nevojë.

Nëse meditojmë për popujt në përgjithësi do të vërejmë se diku rreth 80% të vlerave, standardeve dhe parimeve në nivel botëror janë në mënyrë konsensuale të respektuara

dhe të çmuara. Mirëpo, popujt e përparuar kanë siguruar kushtet e duhura dhe motivuese për t'i zbatuar ato, ndërsa popujve të prapambetur u mungojnë të gjitha këto dhe për këtë arsye jetojnë pa i realizuar të njëjtat vlera. Në qoftë se meditojmë dhe vrojtojmë rreth përhapjes së dukurive të shumta negative tek populli ynë do ta kuptojmë këtë fenomen më mirë!

3 – Mbështetja e talenteve:


Allahu i Plotfuqishëm dhuntitë dhe aftësitë intelektuale te popujt i ka dhuruar në mënyrë të barabartë, ndërsa tek individët në mënyrë të ndryshme. Kur një popull ndërton, zbulon dhe sundon, ndërsa një tjetër imiton, shpenzon dhe pason në mënyrë të verbër, në këtë kontrast mund të konstatojmë se popujt e përparuar i përkrahin dhe i favorizojnë talentet e veta, duke iu siguruar atyre çdo gjë që iu duhet për të vazhduar rrugën e tyre. Ndërsa te popujt e prapambetur vetëm fëmijët e pushtetarëve dhe të pasurve gjejnë mundësi të shkëlqyera për t'u arsimuar në universitete prestigjioze, edhe në qoftë se ata nuk kanë ndonjë prirje, aftësi dhe seriozitet për ta zhvilluar talentin e tyre. Sa u përket talenteve që vijnë nga familjet e varfra, ata nuk gjejnë përkrahje për t'u shkolluar dhe shpeshherë detyrohen të preokupohen për të siguruar kafshatën e gojës për veten dhe familjen.

Prandaj duke u nisur nga ky fakt mund të përfundojmë, se ofrimi i bursave për t'i shkolluar të dalluarit dhe të talentuarit, pavarësisht prejardhjes së tyre, si dhe financimi i studimeve dhe hulumtimeve serioze shkencore, përbën një hap të rëndësishëm që ndikon shumë për ta ngritur dhe avancuar një komb që më pas ta ketë më të lehtë ngjitjen drejt përparimit dhe qytetërimit. ■

PREZANTIM I LIBRIT:

“RREGULLAT E XHENAZES DHE BIDATET NË TË”

Autor: Muhadithi i shekullit, Muhamed Nasirudin Albani
Përktheu: Selim Tota
Krahasoi me origjinalin: Irfan Tota
Botoi: JEHONA, Tiranë



SHKRUAN: BEKIR HALIMI

Ky libër është botuar në gjuhën shqipe para shumë viteve. Ne dëshirovam t’ua paraqesim në këtë shkrim për të treguar më tepër vlerën që ka libri në fjalë, edhe në gjuhën origjinale në të cilën është shkruar, edhe në gjuhën shqipe në të cilën është përkthyer. Është për t’u gëzuar që këtë libër e kemi në gjuhën shqipe, mirëpo fatkeqësia qëndron në faktin se këtë autor nuk e kemi më në mesin tonë edhe me vepra origjinale të shkruara në gjuhën shqipe, meqë vetë ai ka qenë shqiptar. Ky dijetar i madh shqiptar nuk është i vetmi dijetar, që detyrohemi për kontributin e tij intelektual ta marrim nëpërmjet përkthimit, mirëpo ky është realiteti ynë, edhe pse pa dyshim se do të ishte shumë inkurajuese dhe përgëzuese po të kishim pasur disa vepra të këtij dijetarit të madh të shkruar në gjuhën shqipe.

Shejh Muhamed Nasirudin Albani në librat e tij e theksonte shpesh origjinën e tij shqiptare dhe se kjo është pjesë e vendimit të

Allahut, të cilit duhet t’i nënshtrohemi me dëshirë. Ai në librin e tij “Vargu i haditheve të dobëta”, vëllimi i parë, në faqe 303 e tregon qartë se është shqiptar.

Autori i këtij libri është hoxha i madh, Muhamed Nasirudin Albani, një njeri që është dalluar me studimet e tij rreth thënieve të Pejgamberit, Muhamed, me të cilin Allahu, subhanehu ue teala, e vulosi vargun e pejgamberisë. Prandaj edhe në studimet dhe veprat e tij akademike është dalluar me ndjekjen precize të thënieve të Muhamedit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, gjë me të cilën synonte rikthimin e umetit islam në burimet e pastra të Fesë Islame, e ato tashmë dihen se janë Kurani Fisnik dhe Hadithet e Pejgamberit, *sal-lallahu alejhi ue selem*. Edhe ky libër sikurse libri “Forma e Namazit”, synojnë ta afrojnë muslimanin e thjeshtë me Sunetin e Pejgamberit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, që ta kenë sa më të lehtë zbatimin e tij në jetën e tyre të përditshme.

Një prej projekteve kryesore në të cilat ka punuar hoxha jonë i nderuar ka qenë “Afrimi i Sunetit për umetin”, dhe këtë gjë e ka bërë

në shumë rrafshe dhe në shumë forma, pa dyshim se edhe kjo vepër është njëra prej tyre.

Libri në fjalë në gjuhën arabe ka qenë oferta e parë, që këtë temë ta ofrojë sipas metodës së dijetarëve të hadithit dhe ka pasur ndikim të madh në kuptimin e detyrave, në lidhje me temën në fjalë, dhe kuptimin e disa gjërave, që janë futur në fe si risi (bidate), për të cilat nuk ka argumente fetare për to. Libri në gjuhën shqipe na vjen në dy botime. Botimi, i cili duhet të jetë përkthim më i plotë i veprës kryesore, është botuar në vitin 2001 nga shtëpia botuese “Jehona”, kurse përkthyes i këtij libri është hoxha i nderuar Selim Tota. Kurse botimi i dytë është përkthimi i versionit të shkurtuar të këtij libri, të cilin vetë hoxha e ka shkurtuar për t’i shërbyer masës së gjerë, që të mos hutohen nga hollësitat e argumenteve shkencore. Përkthyesi i këtij versionit është Ismail ibën Jusufi.

Imami Selim Tota në hyrje të librit përmend edhe shkaku që e ka motivuar për përkthimin e këtij libri duke e përmbledhur këtë në: interesin që tregoi xhemati i xhamisë për këtë libër, kërkimi i tyre për ta përkthyer, inkurajimi nga disa nxënës dije arabë, që kishin ardhur atëbotë në Shqipëri dhe mendimi se kjo vepër mund t’i ndihmojë imamët dhe të gjithë besimtarëve në lidhje me temën për të cilën flet ky libër. Libri i përkthyer nga imami Selim Tota në fillim ka edhe një biografi të shkurtër për dijetarin e madh, Muhamed Nasirudin Albanin, e cila jep një pasqyrë të shkurtër mbi te, edhe pse më vonë libraritë janë pasuruar edhe me një libër të tërë që flet për jetën e këtij dijetari të madh.

Ky dijetar në fillim e përmend shkaku e drejtpërdrejtë për ta përpiluar këtë libër, e ky është se më 11 Rebiul Ahir, të vitit 1373 ose 15 dhjetor të vitit 1953, një mikut të tij i kishte vdekur një e afërme dhe ai kishte kërkuar nga ky dijetar të përpilojë një libër që flet për këtë temë dhe ta shpërndajë gjatë ngushëllimeve

“Shihet qartë në këtë libër, sikurse edhe në librat e tjerë pajisja e tij me një sasi shumë të madhe argumentesh fetare, e cila pa dyshim se e kategorizon atë në një libër të lartë akademik...”

që i vinin njerëzit. Mirëpo hoxha tregon se nuk ka arritur t’ia plotësojë dëshirën, porse kjo kërkesë ishte shndërruar në një gacë vulneti për ta përpiluar librin që kemi ndër duar. Librin e ka përpiluar duke respektuar fazat që ndodhin në jetën e njeriut, që nga sëmundja e deri te detyrimet që kemi ndaj të vdekurve tanë, po ashtu edhe pas vdekjes së tyre.

Me këto dispozita del në shesh epërsia e Fesë Islame, e cila jo vetëm që na i mëson dispozitat e sjelljes ndaj njeriut kur është gjallë, por nuk le pa i treguar këto dispozita edhe ndaj njeriut të vdekur. Nuk di të ketë ndonjë fe, e cila me kaq hollësi sqaron detyrat që kanë të gjallët ndaj të vdekurve, sikurse e bën këtë Feja jonë e nderuar Islame! Shihet qartë në këtë libër, sikurse edhe në librat e tjerë pajisja e tij me një sasi shumë të madhe argumentesh fetare, e cila pa dyshim se e kategorizon atë në një libër të lartë akademik.

Ky libër është plotësuar edhe me një numërim të risive, bidateve që ndodhin në vende të ndryshme të botës islame, në lidhje me qëndrimin e muslimanëve ndaj këtij fenomeni, që ndoshta është rasti i parë ku janë grumbulluar në këtë formë. Shejh Albani, *rahimehullah*, këtë gjë e ka vepruar në shumë libra të tij, me qëllim që duke ua mësuar muslimanëve Sunetin, t’u mësojë edhe gjërat që bien ndesh me Sunetin, për të qëndruar afër të parave dhe larg të dytave, sepse vetëm kështu adhurimet e tyre muslimanët i bëjnë të tilla për t’i pranuar Allahu, *aze ue xhel*, nga ata.

“...nuk guxoj ta kaloj këtë paraqitje të shkurtër mbi këtë libër pa thënë se duhet rishikuar edhe një herë për disa çështje që janë përkthyer...”

Në fund hoxha ynë, *rahimehullah*, e përfundon këtë libër duke thënë: “E falënderoj Allahun, që më dha sukses në përfundimin e këtij libri dhe Atë e lus që të m’i shtojë të mirat e Tija. Atë e lus që të më dhurojë dashurinë për takimin me Të gjatë largimit nga kjo dynja kalimtare në udhëtimin drejt shtëpisë së përhershme dhe të amshueshme, me *“ata që Allahu u ka dhënë begati, siç janë pejgamberët, sidikinët, dëshmorët dhe burrat e mirë, se ata janë shoqëria më e mirë”*.”

Pa dyshim se përkthimi i këtij libri në gjuhën shqipe e ka pasuruar bibliotekën shqiptare dhe e lus Allahun, që të shpërblejë përkthyesit, redaktorët dhe donatorët. Mirëpo nuk guxoj ta kaloj këtë paraqitje të shkurtër mbi këtë libër pa thënë se duhet rishikuar edhe një herë për disa çështje që janë përkthyer, siç janë disa hadithe që gjatë përkthimit ka ndodhur gabim në kuptimin e tyre, mungesa e disa fusnotave, ndoshta edhe mungesa e një klasifikimi akademik dhe mejdanor të bidateve, që gjenden tek ne në këso rastesh dhe futja e tyre si shtojcë në librat e përkthyer, pasi që në këto botime ka edhe disa shtojca. Pa dyshim se rishikimi i literaturës së përkthyer nga gjuha arabe dhe sidomos asaj që përkthehet nga përkthimi i parë nga gjuha origjinale është bërë një detyrë e madhe e hoxhallarëve tanë. Allahun e lusim që tua lehtësojë këtë detyrë dhe obligim. Allahu e shpërbleftë autorin, përkthyesin dhe botuesin dhe i mundësoftë lexuesit, që të thithë këto dije të urta dhe t’i bëjë pjesë e jetës së tyre të përditshme. Amin! ■

LUM PËR TË DASHURUARIT (...VETËM PËR BURRA)

Fatkeqësisht në shumë raste realiteti dëshmon një padrejtësi, kur klasifikohen disa njerëz se qenkan fetarë, ndërsa njohin vetëm anën e jashtme të tyre, pa njohur fare jetën praktike të tyre: a ke jetuar me të, a ke udhëtuar me të, a ke pasur allishverish me të?!

DR. DEJMA TARIK TAHBUB

Nëse hedhim një vështrim të shpejtë në publikimet e televizionit, radios, gazetave, revistave dhe forumeve elektronike, kur kanë të bëjnë me raportet bashkëshortore gjatë dekadës së fundit, na bëjnë të qartë se kemi një problem të vërtetë në jetën bashkëshortore, i cili në gjeneratat e mëhershme nuk u shfaq deri në këtë shkallë. Shkaku për këtë ndoshta është fjala e gjysheve tona: “Ka humbur bereqeti sot”.

Përkundër faktit që jetesa në të kaluarën ishte e vështirë dhe më e rreptë, ata kishin më shumë dashuri, afërsi dhe qëndrueshmëri, gjëra këto që i fitonin me metodat që i njihnin asokohe. Ndërkohë sot kur kemi më shumë dije, filozofojmë më shumë, kemi më shumë fuqi dhe teknologji, kemi më pak rehati dhe lumturi në jetën tonë. Problemet bashkëshortore janë shtuar, jeta është bërë e zorshme dhe më pak normale, ndaj lidhjet tona shoqërore janë më të ftohta dhe të fabrikuar.

Në një tubim u fola shoqeve të motrës

“Keqpërdorimi i të drejtave mund ta shndërrojë burrin në një zullumqar dhe diktator e jo bashkëshort i dashuruar, do të përdredhë qafën e gruas, ashtu si i ka përdredhur tekstet fetare...”

sime me këto fjalë: “Gjeni atë që është fetar dhe i moralshëm, çdo e mirë materiale e jetës mund të ndryshojë, ndërsa bërthama e fesë mbetet. Ai që është fetar të nderon në mirësi dhe nuk të bën padrejtësi në vështirësi”. Mirëpo ato më sollën tregime dhe rrëfenja, që vërtetonin injorancën, keqbërjen dhe padrejtësinë e disa burrave që njihen tek njerëzit si praktikantë të fesë. Fatkeqësisht në shumë raste realiteti dëshmon një padrejtësi, kur klasifikohen disa njerëz se qenkan fetarë, ndërsa njohin vetëm anën e jashtme të tyre, pa njohur fare jetën praktike të tyre: a ke jetuar me të, a ke udhëtuar me të, a ke pasur allishverish me të?! Ja çfarë mashtrimi të bën pamja e jashtme dhe njohja e cinguar!

Këto raste na bëjnë të meditojmë më shumë mbi hadithin e Pejgamberit, *sal-lallahu alejhi ue selem*: “*Kur t’ju vijë ai, feja dhe mirësjellja e të cilit ju pëlqen, martojeni*” dhe të bëjmë pyetjen: Pse i Dërguari bëri ndarje midis fesë dhe mirësjelljes, ndërsa dihet se ai fliste fjalë kuptimplota dhe sikur ato dy fjalë të kishin një kuptim të njëjtë me siguri do t’i shprehte me një fjalë? A thua është një theksim shtesë për rëndësinë e mirësjelljes, që peshon sa rëndësia e fesë në një martesë? Apo është një aludim, se një njeri mund të jetë fetar, por i varfër në mirësjellje, sepse fillimisht s’ka arritur ta kuptojë mirë këtë fe? Apo është një bashkim midis besimit me zemër (feja) dhe sjelljes në këtë botë me mirësjellje? Apo u jep shenjë pikërisht burrave, se feja ju jep më shumë të drejta juve sesa grave në shikim të parë, kurse në realitet ato janë përgjegjësi

të shumëfishuara dhe se keqpërdorimi i të drejtave mund ta shndërrojë burrin në një zullumqar dhe diktator e jo bashkëshort i dashuruar, do të përdredhë qafën e gruas, ashtu si i ka përdredhur tekstet fetare. Kurse sikur feja dhe mirësjellja të bëheshin bashkë, atëherë mirësia dhe respekti do të mateshin në proporcion me atë që burri bën për gruan dhe jo në proporcion me atë që ai pret prej saj, sepse e dimë që *“më i miri ndër jush është më i miri për familjen”*. Kësisoj konceptet e burrërisë do të shndërrohen në një ngarkesë lodhëse dhe në një llogari dhe jo në një nder që shfaqet me lartësi dhe muskuj.

Ditët e sotme, jeta moderne, globalizimi dhe krizat na kanë shkaktuar pasoja të egra, të cilat kanë çelur hapësirë për ankesa, qarje të shpirtit dhe frustrime. Burri ngushtohet me situatën e keqe ekonomike dhe me problemet e punës, apo edhe të Umetit, ashtu që frymëmarrjen e parë të familja dhe te gruaja do ta nxjerrë duke i ngarkuar edhe ata me një pjesë të fajit dhe njëkohësisht do të injorojë detyrimet e dashurisë dhe mbikëqyrjes ndaj tyre. Boll i kam problemet me stresin sesi do të vazhdojë jetesa dhe nuk kam kohë të dëgjoj fjalime të llojit: “Shtëpitë e lumtura”, “Si t’ia shprehësh dashurinë bashkëshortes”, “Si ta përhapësh gëzimin nëpër shtëpi...” etj. Po qe se gruaja përpiket të shprehë dashurinë apo të jetë romantike në jetën bashkëshortore, përgjigjja do të jetë: Ngadalë se nuk jemi më adoleshentë!! Sikur dashuria paska një kohë të caktuar gjatë jetës dhe nuk qenka ndjenjë e vazhdueshme, as nuk paska natyrë ripërtëritëse. Këta nuk e kanë kuptuar ajetin e martesës, i cili shënohet në shumë ftesa dasmash, por ende nuk ka arritur të bëhet rregullore e jetës bashkëshortore. Ai që mendon thellë për fjalët “dashuri” dhe “mëshirë” të përmendura në ajetin e sures Rum: *“Prej argumenteve të Tij është se nga*

“...Po qe se gruaja përpiket të shprehë dashurinë apo të jetë romantike në jetën bashkëshortore, përgjigjja do të jetë: Ngadalë se nuk jemi më adoleshentë!!...”

vetja juaj krijoi bashkëshortet që të gjeni prehje tek ato dhe futi midis jush dashuri dhe mëshirë”, do ta kuptojë dallimin mes prirjes së brendshme për pëlqim, që është simpatia dhe ndjenjës që vjen si rezultat i sjelljes praktike të vazhdueshme, që është e lidhur me mëshirën, e që është dashuria. Këtë e mësojmë nga komenti i Ibën Abasit, *radijallahu anhuma: “Dashuria është burri ta dojë gruan, ndërsa mëshira është ta mëshirojë duke mos i bërë keq asaj. Dashuria dhe mëshira nuk janë ndonjë dhembshuri momentale, por janë një burim i butësisë së përhershme, mirësjelljes së lartë dhe jetesës së ndershme”*. Arsyetimi se “jam tip nervoz”, situatat e vështira, pleqëria, fëmijët etj., janë prej arsyeve që gjenden të gatshme dhe shumë të lehta, mirëpo dijetarët na kanë tërhequr vërejtjen: “Umeti do të ketë mirësi, përderisa nuk arsyeton vetveten”.

Është e lehtë t’i quajmë gratë mendjelehta, që janë të lidhura pas dashurisë së tituar nëpër serialet turke dhe perëndimore, madje për këtë t’i përshkruajmë të trasha në mendje, të marra dhe me logjikë sipërfaqësore pa analizuar shkaqet, që i detyruan gratë tona të lidhen me “Gjymyshin dhe Mehmetin”, ndërsa një ndër shkaqet fshihet mu te humbja e ndjenjës për dashurinë e dhembshurinë në jetën e vërtetë. Këtij zjarri i hedh edhe më

shumë benzinë qëndrimi i disa burrave, se “s’ka si bëhet më mirë”, “asaj që nuk i pëlqen le t’i bjerë murit me kokë” dhe “le të pijë ujë supermarketi”...!

Megjithëse dashuria është një ndër themelet kryesore të fesë dhe kulturës islame ne po dridhemi nga të studiuarit dhe thellimit në të, ndërkohë që ligjet e reja në ministritë e arsimit së shpejti do të fusin lëndën e edukatës seksuale për fëmijët tanë, kurse ata fillimisht nuk dinë si të dashurojnë dhe si të sillen me gratë, duke filluar me nënat dhe motrat e tyre e duke mbaruar me nuset dhe bijat e tyre, në të ardhmen.

Dashuria është një ndër themelet kryesore të kësaj feje, ndaj raportin më të plotë midis robërve dhe Zotit të tyre, Allahu e përshkroi me ndjenjën e dashurisë: **“...i Do dhe e duan...”**. Pse nuk tha: e nderojnë, i binden apo i kanë frikë? Pse e zgjodhi pikërisht dashurinë Allahu, që të përshkruajë lidhjen më të fortë dhe litarin që nuk këputet midis Tij dhe robërve të Tij? Komentuesit thonë: “Pasimi i vërtetë dhe puna për Allahun nuk arrihen pa dashuri, dashuria është çelësi për të fituar dhe arritur shkallët më të larta tek Allahu”.

“Burrat nuk janë emocionalë” është një arsye, që burrat e shprehin me qëllim që t’i

“Këtij zjarri i hedh edhe më shumë benzinë qëndrimi i disa burrave, se “s’ka si bëhet më mirë”, “asaj që nuk i pëlqen le t’i bjerë murit me kokë” dhe “le të pijë ujë supermarketi”...! ”

ikin detyrimeve emocionale kundrejt familjes! Bëjmë pyetjen: Si u arrit të priten emocionet nga jetimi dhe i shkreti që kishte humbur nënën dhe babanë, kurse ata të dy janë shkolla e parë që ia mëson njeriut dashurinë? Ai nuk kishte vëllezër, as krah e as mbështetje? Egërsohej nga errësira e zemrave të hallkut, ndaj i braktiste duke shkuar me dhen, apo duke u vetmuar në shpellë. Pastaj doli para dynjasë për ta mbushur me dashuri dhe emocione si pejgamber, bashkëshort, baba dhe mësues. Ai, paqja dhe bekimet qofshin me të, na ka lajmëruar, se do të vijnë njerëz që do të krenohen se janë zemërgurë dhe të vrazhdë, ndaj duke kryer shtyllën e fundit të kësaj feje, në Haxhillëkun e Lamtumirës i ftoi qartë: **“Silluni mirë me gratë, ato nuk i nderon kush përveçse i ndershmi dhe nuk i përçmon përveçse i poshtri”**.

Ai e puthte zonjën Aishe në ballë, vraponte me të, lozte me të, thumbohej madje edhe shpirti kur i doli ishte duke pastruar dhëmbët me misvakun, që ajo ia kishte zbutur me pështymën e saj...!

O burra, dija fitohet duke e kërkuar, ndërsa dashuria duke e kultivuar. Kush mbjell dashuri do ta korrë atë dhe kush mbjellë ngurtësi dhe vrazhdësi do t’i korrë gjithashtu, ose do të shohë gruan e tij të rendi pas një dashurie të supozuar virtuale në televizion!

Nuk kemi nevojë të importojmë e as të titrojmë romantikën. Ne kemi nevojë të ngjallim trashëgiminë tonë romantike dhe ta praktikojmë atë. Ashtu burrat do të mund të dalin nga shtëpitë e bijave të Hatixhes dhe Aishes për t’u përballur me lodhjet dhe ngacmimet e dynjasë në përditshmëri. Nëse ecet kështu, sa e mirë qenka romantika dhe lum për të dashuruarit. ■

nga arabishtja: Omer B.



SJELLA ME ADOLESHENTIN

Në shtëpi me vëllezërit e tij sillet i egër, si i huaj dhe i shan pa kurrfarë shkaku, inatoset me ata. Grindet me prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes i ngacmuar nga tërbimi, siç po ndodh sot në shumë raste konfliktesh dhe mosmarrëveshjesh mes të rinjve në pubertet dhe prindërve (sidomos me nënat)

TESNIM RIDI

Sa i përket sjelljes dhe raportit me adoleshentët, ky sqarim zgjat shumë dhe duhet të shtjellohet nga aspekti psikologjik, sociologjik dhe fiziologjik.

Në fillim duhet të dihen ndryshimet fizike në trupin e adoleshentit, gjë që është e pashmangshme në moshën e pubertetit. Ky ndryshim përcillet me një rritje të shpejtë dhe ndryshime të tjera në trup. Si rezultat i këtyre ndryshimeve paraqitet plogështia, përtacia dhe anemia. Gabimi më i shpeshtë i prindërve në këto raste është mendimi dhe bindja, se fëmijët kështu me trup të rritur në pubertet, mund të ngarkohen me detyrime më serioze dhe më të mëdha. Ky gabim pastaj shpie deri te nervozizmi, tendosja dhe shqetësimi, dhe si rezultat i këtyre ndjenjave, vjen deri te humbja e vetëbesimit.

Këto ndryshime fizike tek i riu ngjallin dëshirë për t'u vetmuar dhe për t'u larguar

nga familja, ikje nga çfarëdo pune, duke u lëshuar në dembeli, nga e cila pason ndjenja e molisjes. Shpesh në kohën e pubertetit i riu nuk ka vendosmëri, vazhdimisht ka ndjenjën se është në vështirësi dhe telashe, e zgjedh rrugën e refuzimit dhe të kundërshtimit me familjen dhe shokët dhe në përgjithësi me ata që e rrethojnë. Për këtë shkak në shumicën e rasteve adoleshenti është i dëshpëruar dhe i pikëlluar, bile-bile pikëllimi i tij nuk përfundon vetë tek ai personalisht, por i kaplon edhe të tjerët, dhe kështu ai shkatërron edhe lumturinë e të tjerëve, duke i kundërshtuar dhe u grindur, pa u afruar dhe ndihmuar me të tjerët. Në shtëpi me vëllezërit e tij sillet i egër, si i huaj dhe i shan pa kurrfarë shkaku, inatoset me ata. Grindet me prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes i ngacmuar nga tërbimi, siç po ndodh sot në shumë raste konfliktesh dhe mosmarrëveshjesh mes të rinjve në pubertet dhe prindërve (sidomos me nënat), sepse ajo qysh prej fëmijërisë është e lidhur

“Gjatë rritjes së trupit, adoleshenti më shumë përqendrohet në çështjet seksuale, saqë shumica e kohës i kalon me fantazi për këto gjëra...”

më tepër. Dhe nëse ajo është më pak rigoroz e më tepër tolerante, atëherë konfliktet dhe mosmarrëveshjet do të pakësohen dukshëm. Ky i ri do të angazhohet në kundërshtimin e çdo pushteti prindëror. Dhe sa herë që dikton se përpjekjet e tij dështojnë, shtohet mllefi i tij dhe ndodh që të tërhiqet nga situata të tilla, të cilat mund të çojnë deri te ndëshkimi, si pasojë e mosrespektimit të prindërve.

Këtij të riu gjithashtu i mungon vetëbesimi, si pasojë e dyshimit në aftësitë e veta individuale dhe shoqërore. Shpesh kjo ndjenjë fshihet prapa inatit, të cilin e shfaq haptas. Kështu ai refuzon kërkesën për të kryer ndonjë punë të rëndësishme nga frika e dobësisë dhe e mosuksesit. Situata komplikohet akoma më tepër pas kritikave, që i bëhen nga personat përreth, për shkak të veprimeve dhe sjelljeve të tij të çrregullta.

Gjatë rritjes së trupit, adoleshenti më shumë përqendrohet në çështjet **seksuale**, saqë shumica e kohës i kalon me fantazi për këto gjëra. Në këto situata ai bazohet në burime jo të sakta, siç janë: shokët, shërbëtorët, rruga, libra pa vlerë artistike apo filma dashurie, shumë të përhapur këto kohët e fundit dhe shumë të rrezikshme për të rinjtë. Të gjitha këto gjëra ia drejtojnë vëmendjen adoleshentit në problemet gjinore, sidomos mbajtja e gjërave në konfidencë të plotë. Kjo ndjenjë e tyre përcillet me rebelime, dyshime dhe

konflikte. Dhe këtu do të përmendim disa të dhëna për këtë realitet, të paraqitura nga disa doktorë psikiatër dhe sociologë, të cilat duhet t'i dijë kujdestari apo prindi i adoleshentit:

1- Ai duhet të angazhohet që ta edukojë adoleshentin me frymën Islame i bazuar në katër pika themelore: edukimi fizik i trupit, edukimi shpirtëror, edukimi psikik dhe edukimi mental. E gjithë kjo bëhet me qëllim që të ruhet natyrshmëria, me të cilën Allahu i ka krijuar njerëzit. Paralelisht me edukatën fizike bëhet edhe edukata shpirtërore me iman, gjë e cila fillon qysh në fëmijëri. Islami i jep rëndësi të madhe edukatës në të gjitha këto pika themelore, çka argumentohet me fjalën e Ali ibën Ebu Talibit: “Luaj me ata kur janë shtatë vjeç, edukoi kur janë shtatë vjeç dhe bëhu shok me ata kur janë shtatë vjeç.”

2- Me rëndësi të madhe është pjesëmarrja e adoleshentit në debate të qeta, në të cilat gjen shërim për problemet e veta, përmes të cilave ai mësohet që t'i paraqesë problemet e veta dhe të debattojë për to me të rriturit pa ngurrim dhe me shumë besim. Adoleshenti ka nevojë që dikush t'ia kuptojë gjendjen shpirtërore dhe të kujdeset për nevojat e trupit të tij. Për këtë shkak ai ka nevojë për një shok të pjekur, i cili i përgjigjet pyetjeve të tij me mirëkuptim dhe me butësi e transparencë. Ky shok të jetë në gjendje ta dëgjojë deri sa ta përfundojë fjalën pa ndërhyrje, pa ironi dhe pa dyshuar në fjalët e tij.

3- Domosdoshmërisht duhet që adoleshenti të përgatitet mirë me shpjegime dhe sqarime të hollësishme për zhvillimin e trupit nga aspekti gjinor, çfarë detyre kanë organet gjinitale – vazhdimi i llojit njerëzor përmes marrëdhënieve të lejuara martesore-, pastaj t'i sqarohet si vepron në kohën e zhvillimit dhe të ndryshimeve trupore. Shumë më mirë është që kjo

përgatitje teorike të fillojë para se sa të arrijë moshën madhore. Gjithashtu duhet patjetër të bisedohet me adoleshentin për rrezikun e praktikimit të masturbimit dhe t'i tregohet për dispozitat e Sheriatit Islam për këto gjëra.

4- T'i mësohen adoleshentit dispozitat fetare në përgjithësi, e në veçanti dispozitat mbi agjërimin, namazin, abdesin dhe pastrimin (guslin). Gjatë këtij mësimi duhet të lihet hapësirë edhe për çdo lloj pyetje nga kjo sferë, me çka shmanget rreziku i informimit të adoleshentit nga burime të tjera të jashtme.

5- Nuk duhet të qortohet i riu, nëse ai shpreh haptas diçka nga gjërat e lartpërmendura, si dhe të mos akuzohet për ahlak – edukatë – të keq, ose t'i thuhet që, as baba, as nëna s'e kanë pritur këtë vepër nga ai/ajo. E sidomos nuk duhet të qortohet e as të akuzohet, nëse vepra nuk e tejkalon kufirin e haramit. Gjithashtu nuk duhet të thuhet, se ne kur kemi qenë në moshën tënde nuk i kemi bërë këto gjëra. E gjithë kjo çon deri te ndjenja emocionale për mëkatin e bërë dhe shkakton frustrim tek i riu. Adoleshenti në këtë moshë kërkon dhe ka nevojë për dashuri dhe mbështetje, për respekt dhe siguri të personalitetit të tij, sikurse ka nevojë për vendin dhe pozitën e tij në shoqëri, e sidomos ka nevojë për udhëzime dhe këshilla pozitive.

6- T'i jepet hapësirë e bollshme për shkëmbimin e mendimeve fisnike, për aktivitete me motivacione të ndryshme, përmes të cilave harxhon dhe shfryn energjinë e tepërt, si dhe ndërton personalitetin e tij dhe me këtë rast përdorë fjalë të dobishme gjatë shkëmbimit të mendimeve. Këto gjëra tek personaliteti i adoleshentit nxisin siguri e vetëbesim dhe edukatë të shëndoshë. Familjet me anëtarë të afruar dhe të lidhur mes veti, të cilat i mësojnë dhe u japin anëtarëve të vet

mbështetje dhe lidhje të ngushta familjare, marrin vendime për gjëra jetike, ku marrin pjesë të gjithë anëtarët e familjes, dhe ku të gjithë anëtarët janë shumë të interesuar për problemet e njëri-tjetrit. Në këto familje adoleshentët janë shumë më pak të frustruar dhe me më pak presione. Adoleshentët te këto familje me shumë pozitivitet e shikojnë jetën dhe kanë zgjidhje optimale për çështjet jetësore dhe problemet e saj. Për të njëjtat probleme të rinjtë e familjeve, të cilat nuk i kanë këto veti pozitive, janë më shumë të ekspozuara ndaj lëndimeve dhe presioneve psikike.

7- Kujdestari – përgjegjësi - e ka detyrim ta nxitë adoleshentin që të marrë pjesë në takimet e të rinjve dhe të jetë aktiv në propozimin e zgjidhjeve të problemeve të veçanta shoqërore gjatë debateve mes të rinjve. Kështu e përjeton siç duhet fazën e burrërisë dhe të përgjegjësisë.

8- Gjithashtu duhet të nxitet dhe të përkrahët në praktikimin e hobive të ndryshme dhe të merret me lojëra sportive, të angazhohet me punë dhe aktivitete humanitare, përmes të cilave përthith energji të reja dhe i forcohet personaliteti.

9- Është e dobishme që ndonjëherë të injorohet ndonjë gabim i paqëllimtë i bërë nga ana e adoleshentit.

10- Në rast të zbulimit të marrëdhënieve dhe kontakteve me personin e gjinisë së kundërt, duhet që kjo gjendje të përmirësohet me dialog të qetë dhe të shtruar, kurrsesi me vrazhdësi dhe fanatizëm.

Dhe në fund, vëlla i dashur, kjo është një përmbledhje e shkurtër për natyrën e moshës së adoleshencës dhe si mund të veprohet me të riun. Për këtë shkak të këshilloj, që të lexosh sa më tepër për këtë tematikë dhe që ta shtosh diturinë për këtë çështje. ■

Nga arabishtja: Zeki ÇERKEZI


UDHËTIMI DREJT BOTËS TJETËR

MUHAMED MUHTAR SHENKITI

Robër të Allahut! Sado që të zgjasin ditët e kësaj jete, të vijojnë vitet, patjetër që do të vijë një ditë dhe do të ndahemi nga ajo, e do t'u themi lamtumirë atyre që mbesin pas nesh. Në çastin e fundit pas të cilit tjetër s'ka,

“E s'ka dyshim, se ata që thanë: “Allahu është Zoti ynë”, dhe ishin të paluhatshëm, atyre u vijnë engjëjt (në prag të vdekjes dhe u thonë): të mos u frikësoheni, të mos pikëlloheni, keni myzhide xhenetin që u premtoj. (u thonë) Ne kujdesemi për ju, si në jetën e kësaj bote, ashtu edhe në botën tjetër, ku do të keni atë që dëshironi dhe gjithçka kërkon.”
(Fusilet: 30-31)

në momentin përfundimtar, në mendimin e fundit, njeriu ndalet në pragun e kësaj bote, shikon shokët dhe të dashurit, djemtë dhe vajzat, vëllezërit, motrat dhe të tjerët, dhe jeta i duket si një ëndërr, një iluzion. Është momenti kur fletoret e shënimit të veprave mbyllen, besimtari ndalet dhe i kënaqur me Zotin e



Madhëruar i sheh veprat e tij të mira që ka lënë pas. Robi i devotshëm ndalet në këtë moment, kur besojnë edhe mosbesimtarët, binden edhe të degjeneruarit, largohen mëdyshjet, qartësohen shikimet, pra, besimtarit ndalet mes dy halleve:

Halli i parë: shikon evlatin dhe atë që ka lanë në këtë botë, shikon pasardhësit e tij të dobët, a thua vallë kush do të përkujdeset për ta? Kush do ta mëshirojë dobësinë e tyre dhe kush do t'u dalë në ndihmë pas Allahut? Halli do ta kaplojë. Do të shikojë lëshimet që ka bërë kundrejt Allahut, do t'i përkujtojë çastet e momentet kur ka rrëshqitur dhe nuk e di: ia ka falur Allahu mëkatin, ia ka mbuluar turpin apo do ta takojë Atë me ato vepra?

Halli i dytë: para vetes do të shohë një shtëpi që s'është shtëpia e tij, një jetë që s'është si ajo që njihte, një vendbanim që nuk e njeh dhe nuk e di se ç'do të ndodhë në të? Do të ndalet në këtë moment kaq të rëndësishëm e Allahu më i Mëshirshmi dhe më i Buti do ta shikojë: **“Pritje e nderuar prej Atij që fal mëkatet dhe që është mëshirues!”** (Fusilet: 32). Atëherë i zbresin melekët për ta përgëzuar me xhenet, se Allahu është i kënaqur, s'është i hidhëruar me atë dhe kështu zemra do t'i mbushet me dashuri të zjarrtë për ta takuar Atë. Do ta dëshirojë sa më shpejt kalimin nga kjo botë, që të qëndrojë përpara Allahut, i cili do t'i japë sihariq, se pasardhësit e tij do t'i mbrojë **“Ne kujdesemi për ju, si në jetën e kësaj bote, ashtu edhe në botën tjetër, ku do të keni atë që dëshironi dhe gjithçka kërkon.”** (Fusilet: 31) Kështu Allahu do të kujdeset për pasardhësit e robit të devotshëm, siç u kujdes për dy jetimët babai i të cilëve ishte i devotshëm në rrëfimin e Musait me Hidrin: **“Për sa i përket murit, ai ishte i dy djelmohave jetimë të atij qyteti, e nën të ata kishin një thesar (ari) dhe babai i tyre ka qenë njeri i mirë, e Zoti yt dëshiroi që ata dy (jetimët) ta arrijnë pjekurinë e vet dhe ta**

“...Ai që në këtë dynja është në rrugë të drejtë në çastin e vdekjes nuk do të pikëllohet, as që do të ndiej keqardhje...”

nxjerrin ata vetë thesarin e tyre.” (Kehf: 82)

Allahu pra, u kujdes për pasardhësit e robit të mirë dhe kështu i përgëzon të gjithë ata që janë të mirë: **“Mbrojtësi im është Allahu që zbriti librin. Ai kujdeset për të mirët.”** (Araf: 196) Ai që në këtë dynja është në rrugë të drejtë në çastin e vdekjes nuk do të pikëllohet, as që do të ndiej keqardhje: **“Allahu i forcon ata që besuan në fjalën e fortë (të mirë) në jetën e kësaj bote edhe në botën tjetër.”** (Ibrahim: 27)

Ai që është në rrugë të drejtë në këtë dynja Allahu e përmirëson çështjen e tij, fundi i tij do të jetë i mirë, atij i zbresin melekët me sihariqe dhe kështu do të jetë fytyrëqeshur, i gëzuar dhe fytyrëndritur. Këto janë prej shenjave të përfundimit të mirë, pra, ndriçimi dhe gëzimi i fytyrës së tij në çastet e daljes së shpirtit nga trupi, sepse e sheh mëshirën e Allahut, ashtu siç nuk e kishte paramenduar. Muhamedi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, thotë: **“...është robi i mirë, të cilit i zbresin melekët dhe e përgëzojnë me mëshirën e Allahut, robi i cili me mall kishte pritur dhe e kishte dashur takimin me Allahun, prandaj edhe Allahu deshi takimin me të.”** (Buhariu) E si është kur takohesh me atë që e do? Ai që në këtë dynja është në rrugë të drejtë Allahu e përforcon në çastin e vdekjes dhe e përgëzon: **“Kini frikë Allahun, e ta dini se fundi juaj është tek Ai, e besimtarëve jepu myzhde.”** (Bekare: 223)

Kur i erdhi vdekja imam Malikut e humbi vetëdijen katër ditë. Ditën e katërt pasi kthjellohet njerëzit përreth tij e pyesin: Si je, o imam?- E shoh vdekjen po edhe ju do të

shihni mëshirën e Allahun, në një mënyrë që s'e keni paramenduar, - u thotë ai.

Ai që është në rrugë të drejtë, ai që do të ketë përfundim të mirë vazhdimisht e përkujton Allahun derisa t'i vijë agonia e vdekjes dhe fjala e tij e fundit të jetë fjala: La ilahe il-lallah e Muhamedi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, thotë: “Kush e përfundon jetën me fjalën la ilahe il-lallah hyn në xhenet.” (Ahmedi)

Robi vazhdimisht do të ndjekë rrugën e drejtë, derisa Allahu t'ia mbyllë jetën si është më mirë, ta shpëtojë. Kush bind veten në punë të mira vdekja e gjen duke bërë ndonjërin prej atyre punëve të mira, njëri vdes në sexhde, tjetri në ruku, tjetri duke i bërë mirë prindërve, tjetri në rrugë e sipër për të vizituar farefisin. Prej shenjave të përfundimit të mirë është kur njeriu vdes duke bërë një vepër të mirë, duke përmendur Allahun, apo punë tjera të mira, siç janë: namazi, agjërimi etj. Prej shenjave të përfundimit të mirë për ata që janë në rrugë të drejtë është përfundimi më i ndershëm dhe më i dashur tek Allahu, që është shehidllëku. Kush përfundon jetën e tij si shehid atij i takojnë të mirat e Allahut dhe më tepër se kjo. Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, për shehidin thotë: “Ai falet me

“Deri kur do të bllokohesh nga Allahu, deri kur do të mbetesh larg Tij? Përmirësimi yt do të fillojë me nxitimin tënd drejt veprave të mira, garave në to, afrimit me njerëz të devotshëm, në mënyrë që të ringjalleh në shoqërinë e tyre...”

derdhjen e pikës së parë të gjakut të tij”, i falen të gjitha mëkatet, të gjitha lëshimet dhe Allahun e takon i pastër. “Mburohet nga trishtimi i madh i kiametit. Mburohet nga dënimi i varrit. Shpirti i tij do të jetë në brendinë e një shpendi të gjelbër në xhenet, që pi ujë nga lumenjtë e xhenetit dhe që fluturojnë te kandilat e varur në Arsh.” (Muslimi), kurse ditën e Kiametit do të ringjallet me plagët që i kullojnë. Plagë që do të dëshmojnë para Allahut dhe ai do të ndërmjetësojë për shtatëdhjetë njerëz të familjes së tij dhe do të martohet me shtatëdhjetë hyri.

Çfarë nderi të madh ka përgatitur Allahu për miqtë e Tij, të devotshmit!

Prandaj, o musliman ndalu dhe mendo rreth largësisë tënde nga Allahu dhe derdhe një pikë loti për mangësitë e tua. Do ta fillosh pasimin e rrugës së drejtë më një pikë loti të pendimit. Një pikë loti e pikëllimi për shkak të mëkateve që ke bërë. Prej këtij momenti do të fillosh të ecësh në rrugë të drejtë dhe do të pendohesh botërisht, duke shprehur vendosmërinë me shpresën se do të vijë vdekja duke bërë punë të mira. Deri kur do të bllokohesh nga Allahu, deri kur do të mbetesh larg Tij? Përmirësimi yt do të fillojë me nxitimin tënd drejt veprave të mira, garave në to, afrimit me njerëz të devotshëm, në mënyrë që të ringjalleh në shoqërinë e tyre Ditën e Kiametit. Përmirësimi yt fillon me kërkimin e faljes nga Allahu për gabimet e bëra dhe me lutjen për t'u përmirësuar në pjesën e mbetur të kësaj jete, ngase s'ka strehim dhe shpëtim përpos tek Allahu. O Allah, na dhuro mëshirë që do t'i udhëzojë zemrat tona, do të na falë mëkatet, do të na mbulojë të metat. O Allah, përmirësoje gjendjen tonë, na drejto tek punët që Ti i do. O Allah, të lusim me emrat e Tu të bukur, me cilësitë e Tua të larta, që fundin ta kemi të mirë! ■

nga arabishtja: Agim BEKIRI



SHKATËRRUESI I KËNAQËSIVE

Ebu Hurejre, Allahu qoftë i kënaqur me të, përcjell se i Dërguari i Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë:
 “Shpeshtojeni përmendjen e shkatërruesit të kënaqësive- pra, vdekjes”.

SHKRUAN: LULZIM SUSURI

Hadithin e përcjell Ebu Hurejre, Ebu Seidi, Abdullah ibën Omeri dhe Enesi, *radijallahu anhum*. Atë e shënojnë: Tirmidhiu, në Sunenin e tij, nr. 2307, kurse me disa shtojca të dobëta e shënon edhe tek numri: 2460, Nesaiu, nr. 1824, Ibën Maxhe, 4258, Ibën Ebi Shejbe në “Musanef” 8/128 dhe 129. Bejhekiu në “Sunen Kubra” 1/601 si dhe në “Shuabul iman”, nr. 839, 840, 10163, Taberani në “Muxhem kebir” 11/302. Albani në librin e tij: “Sahih terhib ue terhib” nr. 3333 përmend se e shënon edhe Ibën Hibani në Sahihun e tij, si dhe Taberani në: “Muxhemul eusat”.

Sa i përket gradës së saktësisë së tij Tirmidhiu e konsideron Hasen sahih (të mirë të saktë) mendim të cilin e mbështet Albani në Sunenet e lartpërmendura, pra, atë të Tirmidhiut, Nesaiut dhe Ibën Maxhes. Kurse në librin: “Mishkat el-mesabih” 1/ 362, nr. 1607 përmend se hadithi është i saktë. Mendoj se qëllimi i përmendjes së fjalës “Sahih” pa fjalën tjetër “Hasen” tek Albani domethënë, se hadithi apo teksti i tij është i saktë (sahih) e jo edhe zinxhiri. Shpesh ndodh që Albani në librat e tij të përmendi fjalët “hasen sahih” së bashku, ku sipas mendimit të disa studiuesve dhe asaj që kam vërejtur tek librat e tij shpesh me to ka si qëllim, se zinxhiri i transmetimit është “hasen - i

mirë”, kurse teksti i tij i bazuar edhe në zinxhirë të tjerë transmetuesish arrin në shkallën “sahih - i saktë”. Allahu e di më së miri!

Komentimi i hadithit:

Vdekja është fenomeni më i urreyer për njeriun, që do ta godasë patjetër secilin prej nesh dhe për të nuk ka ilaç. Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, kishte një urtësi për shkak të së cilës edhe i udhëzoi besimtarët ta përmendin vdekjen sa më shpesh. Përmendja e vdekjes është shkak për ta ndaluar njeriun nga haramet, për ta shtyrë tek punët e mira dhe për ta mbajtur gjithmonë të vetëdijshëm në llogaritjen paraprake të punëve të cilat ai dëshiron t'i bëjë. Për këtë shkak përmendet se rasti në të cilin Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, e përmendi këtë këshillë ishte fakti, se ai një ditë doli nga shtëpia e tij tek vend-falja dhe i pa shokët e tij duke qeshur aq shumë, sa disa prej tyre u dukeshin edhe dhëmballët. Ai me të parë gjendjen e tyre, e cila pa dyshim ndikonte pak a shumë në largimin nga përmendja e Zotit, humbja e kohës, pakujdesia etj., atëherë ju tha: *“Sikur ta shpeshtonit përmendjen e shkëputësit të kënaqësive do t'u largonte nga gjendja në të cilën po ju shoh, prandaj shpeshtojeni përmendjen e vdekjes”*. Fjala me të cilën fillon kjo këshillë profetike është:

“Shpeshtojeni”

Kjo këshillë në fakt është urdhër profetik, për shkak se hadithi fillon në mënyrë urdhërore: *“Shpeshtojeni!”* nga i cili kuptojmë qartë, se nuk kemi të bëjmë me një këshillë, e cila mbetet në dëshirën dhe vullnetin e lirë të njeriut, nëse dëshiron ai e vepron e nëse do e lë pa kurrfarë përgjegjësie. Jo, këtu kemi të bëjmë me një këshillë, e cila përmban në

“Vdekja duhet përmendur gjithmonë dhe sa më shpesh bile përmendja më e mirë, më e dobishme dhe për të cilën besimtari shpërblehet më shumë duhet të bëhet në kohët dhe çastet më të lumtura...”

vetvete një urdhër, i cili nuk guxon të anashkalohej, të harrohet apo të përbuzet, aq më tepër nga besimtari, i cili shpreson shpërblimin e botës tjetër dhe ruhet nga dënimi i saj.

Në këtë rast te kjo fjalë do të përmendja edhe disa pika:

Është urdhër që siç thamë, duhet patjetër ta përfillim.

Përmendja e vdekjes nuk mjafton vetëm me rastin e ceremonive mortore, ku për shkak të situatës së tillë shpesh jo nga dëshira për të marrë mësim, por nga situata e krijuar përmendet vdekja. Përmendje kjo e cila bëhet për ta arsyetuar pjesëmarrjen në këso tubimesh dhe për shkak se rasti nuk lejon biseda të tjera. Vdekja duhet përmendur gjithmonë dhe sa më shpesh bile përmendja më e mirë, më e dobishme dhe për të cilën besimtari shpërblehet më shumë duhet të bëhet në kohët dhe çastet më të lumtura, sepse zakonisht në raste të tilla njerëzit e harrojnë Zotin, vdekjen dhe botën tjetër.

Lind pyetja: përmendja e vdekjes kur konsiderohet e mjaftueshme?

Ajo nuk mjafton të jetë vetëm disa herë në jetë e as edhe në vit. Gjithashtu nuk mjafton që njeriu ta kënaqë vetveten me pretendimin, se përmendja e tij e vdekjes

është e bollshme, ngase njeriu për fat të keq shpeshherë e kënaq vetveten, duke i ndihmuar edhe shejtani për ta bindur atë se mirë i ke punët. Përmendje quhet atëherë kur kjo gjë, kam si qëllim përmendjen e vdekjes, ndikon në jetën e njeriut si këshilltar i tij për ta mbajtur atë gjithmonë nën kontroll të vlerave të veta, të cilat i bën. Sa herë që dëshiron të bëjë diçka të keqe e kujton vdekjen dhe nga frika e saj ndalet nga ajo e keqe, sa herë që përton të bëjë një vepër të mirë e kujton vdekjen dhe errësirën e varrit e kështu fillon punën e mirë pa kurrfarë përtese, sa herë dëshiron të bëjë ndonjë adhurim edhe këtu e kujton vdekjen dhe e përmirëson qëllimin e adhurimit të tij, e kështu me radhë. Pra, në këtë mënyrë shpeshimi i përmendjes konsiderohet i dobishëm dhe i përmbushë standardet e kërkuara e jo të jetë vetëm cekje kalimthi dhe shumë e rrallë.

Fjala: **“përmendjen”**- Fillimisht na duhet të kuptojmë: se çfarë do të thotë fjala: **përmendje**. Çfarë është si qëllim të kujtosh diçka së pari me mendje e zemër e pastaj edhe cekje e saj me gjuhë dhe me zë. Pra, përmendja nuk është vetëm meditim i zemrës e as fantazi e kokës, por përmendje me gjuhë e asaj që po mendon. Tek fjala e Profetit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, **“shpeshtojeni përmendjen”** do të ndalesha tek disa pika:

Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, na mëson me këtë fjalë, që vdekjen ta përmendim sa më shumë e të mos mjaftohemi vetëm me meditimin rreth saj.

Përmendja e vdekjes të jetë reale, e jo e zbukuruar kjo, për arsye se njeriu kur përmend diçka e sidomos para të tjerëve mundohet ta përmendë sa më realisht, kurse kur imagjinoi në vetvete ka kohë dhe mundësi që t'i zbukurojë dhe t'i imagjinojë gjërat, ashtu si dëshiron ai vetë.

Me përmendje të vdekjes është si qëllim: përmendja e saj realisht, duke e kujtuar çdo moment të frikshëm të saj, siç edhe thuhet në fund të hadithit, se ajo t'i ndërpret të gjitha kënaqësitë, ëndrrat dhe planet.

Ka njerëz, të cilët kanë aq shumë frikë nga vdekja, sa edhe kurrë nuk dëshirojnë të mendojnë rreth saj. Nëse ndodh që t'u shkojë mendja rreth saj ata menjëherë largohen nga ai mendim, duke e zëvendësuar me mendime të bukura. Ky realitet është mjaft i keq, sepse këta njerëz jo vetëm që kundërshtojnë një urdhër profetik, por ata edhe frikësohen nga një fenomen pa të cilin nuk bën, një fenomen që do t'i godasë të gjithë ata që duan dhe që nuk duan; ata që e përmendin, si dhe ata që kanë frikë nga të menduarit rreth saj.

Përmendja e vdekjes shpesh duhet të bëhet së bashku me njerëzit e tjerë, ashtu si edhe u përmend në fillim të shkakut pse e kishte thënë Muhamedi, *sal-lallahu alejhi ue selem*. Të përmendet së bashku me ta, duke u këshilluar dhe duke marrë mësim nga ky kujtim. Këtu nuk duhet të lë pa përmendur se në këtë urdhër profetik futet edhe të përmendurit e vdekjes para të tjerëve, atëherë kur ata janë të pakujdesshëm. Pra, besimtari e ka detyrim që përveçse ta kujtojë për vete vdekjen, ai duhet t'ua kujtojë edhe të tjerëve dhe t'i përmendë të harruarit.

Lind pyetja: ka raste kur disa njerëz nuk e duan vdekjen dhe e urrejnë atë, kjo a do të thotë se ata patjetër kanë probleme me besimin, siç u përmend më lart? Në këtë rast themi: urrejtja e vdekjes ndahet në dy lloje; urrejtje, e cila ngrihet nga mosbesimi dhe lloji i dytë i urrejtjes që vjen nga frika natyrale, të cilën mund ta kenë shumë njerëz.

Ata që e urrejnë duke mos qenë të

“Ka njerëz, të cilët kanë aq shumë frikë nga vdekja, sa edhe kurrë nuk dëshirojnë të mendojnë rreth saj...”

kënaqur me këtë fenomen dhe duke u munduar me çdo kusht që të mos vdesin, ku edhe ka prej atyre, që Zoti na ruajt, nuk janë të kënaqur me Zotin për krijimin e këtij fenomeni, kjo lloj urrejtje padyshim konsiderohet kufër. Lloji tjetër: ai i urrejtjes nga frika natyrale themi se nëse njeriu është i kënaqur dhe i nënshtuar ndaj Zotit për fenomenin e krijimit të vdekjes, por në anën tjetër ai nuk ka dëshirë të vdesë dhe e urren vdekjen e vet, atëherë ky njeriu padyshim është besimtar, por urrejtja e vdekjes në këtë rast konsiderohet jo mbështetje e duhur tek Allahu, e cila nuk duhet të ekzistojë tek besimtari dhe kjo gjë e fut në mëkat, për aq sa ekziston kjo urrejtje. Sa i përket frikës nga vdekja ajo parimisht nuk futet në radhët e mëkatit, nëse nuk shoqërohet me urrejtje ndaj saj.

Besimtari duhet të frikësohet nga mëkatet e tij dhe t'i urrejë ato ku nëse i përmbahet këtij parimi, atëherë nuk ka pse të frikësohet, as nga vdekja dhe vështirësitë e saj, as ta urrejë atë. Sa i përket dëshirës për të vdekur, si dhe lutjes për ta goditur vdekja, për shkak të problemeve të shumta: njeriut nuk i lejohet ta lakmojë e as të bëjë lutje që ta godasë ajo. Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, rreth kësaj çështje thotë: *“Askush nga ju të mos e dëshirojë vdekjen për shkak të problemeve që e kanë kapluar. Nëse duhet të lutet patjetër, atëherë le të thotë: O Zot ma mundëso të jetoj, nëse jeta*

është më e mirë për mua, ose ma merr shpirtin, nëse vdekja është më e mirë për mua.” (Buhariu, nr. 5239, 5874, Muslimi, nr. 4840).

Fjala: **“shkatërruesit të kënaqësive- pra, vdekjes”**- Fjala: “Shkatërrues, Shkëputës” në gjuhën arabe është përmendur me dy transmetime: *“hadhim”* kurse e dyta *“hadim”*, edhe pse e para është cekur më shumë nëpër transmetime, megjithatë që të dyja kanë thujse kuptim të përbashkët mbi të cilët edhe ngrihet komenti i kësaj fjalie. Kuptimi i të parës do të thotë: “Shkëputës, ndërprerës...”, kurse ai i të dytës do të thotë: “Shkatërrues”. Është e vërtetë se vdekja i shkëput dhe i shkatërron të gjitha kënaqësitë e kësaj bote. Të gjithë që e përmendin vdekjen mërzhiten, a thua pse? Për shkak se që të gjithë e dinë se do t'i godasë, se e kanë përpara dhe patjetër do të vijë dita e saj. Pra, ajo bën dobi tek çdokush, por problemi është se ajo kujtohet shumë pak, ose aspak.

Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, në këtë këshillë të tij përdori një urtësi shumë të madhe, siç e ka zakon ai dhe mu ashtu si i takon atij, flijofsha për të babanë dhe nënën time, që veçoi me përmendje vdekjen e jo ndonjë fatkeqësi tjetër, e cila mund ta godasë njeriun. Pse kështu? Allahu e di më së miri, por për vetë faktin se njerëzit zakonisht për çdo fatkeqësi kanë një shpresë, dhe gjithmonë mendojnë se do të kenë një zgjidhje. Nëse do të ishte përmendur sëmundja njerëzit do të thoshin: ndoshta mua nuk më godet, por të tjerët po, ose kur e godet do të shpresojë tek të hollat e tij, që të shërohet me to, do të shpresojë se do ta gjejë një mjek të mirë, që do ta ndihmonte etj., shumë e shumë shpresa. Kurse kur vjen në pyetje përmendja e vdekjes, që të gjithë i humbin shpresat dhe u vdesin ëndrrat. Përmendja

“Besimtarit edhe pse vdekja ia ndërpret lezetet e kësaj bote ai gjatë tërë jetës ka ndërtuar me punët e tij të mira një shtëpi të fortë, e cila e pret në botën tjetër...”

e vdekjes në krahasim me kënaqësitë e kësaj bote është njësoj si njeriu, i cili ndërton një shtëpi shumë të bukur dhe ëndërron të kënaqet me të, por harron se e ka ndërtuar në një vend ku bien shpesh tërmete të forta dhe deri atë ditë e ka shkatërruar çdo ndërtesë tërësisht. Një njeri i tillë sado që të gëzohet gjatë ndërtimit të shtëpisë në momentin që i kujtohet fenomeni i tërmetit shkatërrues, që shkatërron çdo ndërtesë sado e fortë të jetë i prishet i tërë humori dhe shpresat. Ai që është i mençur në këto çaste, pra, në çastet e ndërtimit duhet të ndërmarrë diçka, e cila do të ndalonte që ndërtesa të shkatërrohej dhe që do ta siguronte njeriun nga humbja dhe falimentimi në ndërtim. Kjo është edhe gjendja me njeriun, që po kalon një jetë të shfrenuar. Ai duhet të kujtojë shpesh, se kjo jetë është veç ndërtim i një shtëpie, e cila do të forcohet me punë të mira, ose do të shkatërrohet me ardhjen e shkatërruesit të vërtetë, pra vdekjes. Prandaj kushdo prej nesh duhet të punojë, që shtëpinë e tij të botës tjetër ta ndërtojë aq të fortë, sa të mos ia prishë asgjë. Besimtarit edhe pse vdekja ia ndërpret lezetet e kësaj bote ai

gjatë tërë jetës ka ndërtuar me punët e tij të mira një shtëpi të fortë, e cila e pret në botën tjetër, ku me ardhjen e shkatërruesit të lezeteve, atij vetëm se ky shkatërrues (vdekja) në fakt ia ka hapur dyert e lezeteve të mëdha, atyre lezeteve të vërteta, të cilat janë të posaçme vetëm për besimtarin e për askënd tjetër.

Do ta përmbyllim këtë temë me një urtësi të përmendur tek imam Tirmidhiu në të cilën thuhet: “Shpeshtojeni përmendjen e shkatërruesit të lezeteve- pra, vdekjes. Varri çdo ditë flet duke thënë: “Unë jam shtëpia e huaj për njerëzit, jam shtëpia e vetmisë, shtëpia prej dheu, jam shtëpia e krimbave”. Kur varroset besimtari, varri i thotë: “Mirë se erdhe, rri i qetë, ti ke qenë njeriu më i dashur për mua kur ecje mbi shpinën time. Sot që ke ardhur në përgjegjësinë dhe miqësinë time do të shohësh se sa mirë do të sillem me ty.”, atëherë i zgjerohet varri aq larg sa i sheh syri dhe i hapet një derë kah Xheneti. Ndërsa kur vdes qafiri varri i thotë: “Mjerë për ty, mos rri aspak i qetë, ti ishe njeriu më i urryer që ecje mbi shpinën time, sot që kam marrë përgjegjësinë mbi ty do të shohësh sa keq do të sillem”. Pastaj i ngushtohet aq shumë sa i futen kockat njëra në tjetrën. Varri është kopsht prej kopshteve të Xhenetit, ose gropë prej gropave të Xhehenemit.” (Tirmidhiu, nr. 2460)¹. ■

¹ Për shkak se dijetarët e konsiderojnë të dobët këtë hadith, nuk kam dashur që ta përmend në temë si hadith, por jam mjaftuar me përmendjen e tij si urtësi. Shpesh ka raste kur disa dijetarë bashkëkohorë shumë hadithe të dobëta i përmendin si urtësi, nëse në tekstin e tyre ka domethënie të mira, prej këtyre dijetarëve nuk dua të lë pa përmendur të parin e tyre shejh Abdulkadër Arnautin, Allahu e mëshiroftë.

REPUBLIKA E JEMENIT

SHKRUAN: DRITON LEKAJ

Ana Gjeografike

Republika e Jemenit është një shtet arab, i cili gjendet në jug-perëndim të Azisë. Jemeni kufizohet me Arabinë Saudite në veri, si dhe me Omanin në lindje. Jemeni ka dalje në Detin Arab në pjesën jugore, ndërsa në pjesën perëndimore të tij ka dalje në Detin e Kuq. Republika e Jemenit ka nën qeverisjen e saj edhe disa ishuj në Detin Arab dhe në Detin e Kuq, e më i njohuri prej tyre është ishulli Saktara. Gjithashtu Jemeni mbikëqyr ngushticën Bab El Mandeb.



TË DHËNA TË PËRGJITHSHME:

Emri i plotë: Republika e Jemenit.

Kryeqyteti: Sana.

Sipërfaqja: 527,968 km².

Banorët deri më 2009 : 23,580,000

Përqindja vjetore e rritjes së banorëve (2000 - 2005): 4,1 %

Përqindja e muslimanëve: 100 %.

Gjuha : Arabe.

Monedha : Rijali i Jemenit (YER)

Pavarësia e Jemenit Verior: 1 Nëntor 1918 (nga perandoria Osmane)

Pavarësia e Jemenit jugor: 30 Nëntor 1967 (nga britanikët)

Bashkimi i tyre: 22 Maj 1990

Anëtar i Kombeve të Bashkuara: 30 Shtator 1947

Anëtar i Konferencës Islamike: 1969

Ana Historike

Jemeni ka një histori që shkon deri në lashtësi, ku janë zhvilluar në të një sërë kulturash prej më të njohurave në botë. Jemeni ka qenë një ndër vendet më të bukura në kohët e lashta. Kjo për shkak edhe të pendës së Meribit, apo siç njihet ndryshe edhe penda e Arimit e që është penda më e vjetër në botë, po ashtu ajo konsiderohet edhe një ndër ndërtimet e rralla të botës së lashtë. Historianët na tregojnë se shpërthimi

i pendës bëri që të zvogëlohen burimet e ujit dhe të ndodhë një thatësi e madhe e që diktoi më pas emigrimin e një pjese të madhe të banorëve drejt Siujdhesës Arabike, Irakut dhe vendeve të Shamit. Ngjarja e pendës së Meribit dhe të mirave që kanë përfituar njerëzit përreth saj, si dhe shkaku i përmytjeve është përmendur edhe në Kuran, në kaptinën Sebe, ajeti: 15-16.

Islami ka hyrë në Jemen në vitin e tetë hixhri, atëherë kur udhëheqësi i saj Bad'hani pranoi Islamin. Jemeni është udhëhequr nga shumë mbretëri e ndër më të njohurat janë: Beni Zijad: 818 -1000, Es Sulejhijun: 1047 - 1137, Er Resulijun. Në vitin 1538 Jemeni u nënshtrua nga Perandoria Osmane gjer në vitin 1635, kohë kur Zejditët morën kontrollin e një pjesë të Jemenit, si qytetet: Sana, Aden dhe Teiz. Pastaj Osmanlinjtë u kthyen përsëri edhe disa herë të tjera, gjersa më 1918 përfundimisht u tërhoqën nga vendi dhe pushtetin e mori Jahja b. Humejd ed Din. Por Jahjai nuk pati mundësi ta shtrinte sundimin e tij përveçse në veri të vendit, ndërsa në jug dhe lindje ende sundonin britanikët, të cilët u larguan nga Jemeni në vitin 1967. Në maj të vitit 1990 ndodhi edhe bashkimi mes Jemenit verior dhe atij jugor në një shtet të vetëm, që u quajt përfundimisht Republika e Jemenit.

Ana politike (Rregullimi shtetëror):

Jemeni është një republikë presidenciale me një legjislaturë dy-dhomëshe. Sipas kushtetutës presidenti i zgjedhur, 301 të zgjedhurit në Dhomën e Përfaqësuesve dhe 111 anëtarë të Këshillit Shura, janë ata që e ndajnë pushtetin. Presidenti është kreu i shtetit dhe kryeministri është kreu i qeverisë.

Kushtetuta parashikon që presidenti të zgjedhet me votim popullor nga së paku dy kandidatë të miratuar prej të paktën

“Huthijunët kanë marrë goditje të forta nga Arabia Saudite në konfliktin e fundit, megjithatë ata përbëjnë një rrezik potencial për rajonin dhe Siujdhesën Arabike në tërësi...”

pesëmbëdhjetë anëtarëve të Parlamentit. Kryeministri, nga ana tjetër, emërohet nga presidenti dhe duhet të miratohet nga dy të tretat e Parlamentit. Presidenti zgjidhet për një periudhe shtatë vjeçare dhe për parlamentarët është gjashtë vjet.

Presidenti Ali Abdullah Salih u zgjodh fillimisht si president në Jemenin e ribashkuar në vitin 1999¹. Ai u rizgjodh në zyrën e presidentit përsëri në shtator 2006. Fitorja e Salihut në zgjedhjet e fundit u cilësua nga vëzhguesit ndërkombëtarë si “pjesërisht të lira”, megjithëse zgjedhjet u shoqëruan me shfaqje dhune, shkeljet e lirive të shtypit dhe dyshimeve për mashtrim nga opozita.

Lufta e Gjirit Persik dhe invadimi i Kuvajtit nga Iraku, ku Jemeni mbajti anën e Irakut dhe ishte kundër përdorimit të forcës vuri në rrezik marrëdhëniet e tij me shtetet e Gjirit Persik dhe kjo ndikoi shumë në ekonominë e vendit. Por gradualisht marrëdhëniet mes tyre filluan të normalizohen dhe në vitin 2000 Jemeni nënshkroi marrëveshjen rreth kufirit me Arabinë Saudite, duke i dhënë kështu fund mosmarrëveshjeve 50 vjeçare rreth kufirit.

Historia dhe sfidat bashkëkohore të Jemenit:

Që nga viti 2004, një luftë civile është duke u zhvilluar në veri të Jemenit midis

¹ Edhe pse ai kishte qenë President i Jemenit të bashkuar, që nga viti 1990 dhe President i Jemenit të Veriut, që nga 1978.

forcave jemenase dhe rebelëve shiit Huthi. Në 2009, ky konflikt u përhap në rajonin kufitar fqinj të Arabisë Saudite. Ky konflikt është gjithnjë e më shumë duke u bërë një rrezik për stabilitetin e rajonit, si dhe vende të ndryshme që mund të përfshihen, p.sh. Irani, Arabia Saudite, Egjipti dhe Jordania.

Atëherë, kush janë Huthijunët?

Huthijunët janë një lëvizje rebele, batinije, e cila është themeluar në Sade, në veri të Jemenit. Prej veçorive të tyre kryesore:

Janë ndarë nga medhhebi Zejdij².

Ecën hapave të Hezbollahit (politikisht dhe fetarisht).

I kanë përqafuar besimet dhe bindjet e grupit Ithna Asherije (përndryshe Shiave të Iranit të sotshëm).

E quajnë veten: Organizata e Djemve Muslimanë.

Bedrudin El Huthiu është udhëheqësi shpirtëror i lëvizjes dhe ai i përket grupit Xharudije, të cilët kanë dalë nga Zejditi dhe janë shumë afër Ithna Asherive, ndërsa udhëheqësi i lëvizjes ishte Husejn Bedrudin El Huthiu, i cili u vra në vitin 2004. Atë e zëvendësoi vëllai i tij Abdulmaliku e që u vra para pak ditëve në konfliktin e fundit.

Gjatë gjithë kohës Shiat e Iranit janë munduar ta shtrijnë ndikimin e tyre tek Zejditi e Jemenit. Pas Revolucionit Islamik në Iran, Ithna Asheritë filluan ta shtrijnë medhebin e tyre mes Zejdive dhe ia dolën me sukses. Kjo duket në ligjëratat dhe festat e tyre të ndryshme. Ata gjetën në organizimin

e “Djelmoshave Besimtarë” të Bedrud Din El Huthit tokën pjellore për përhapjen e ideve të tyre. Argumentet se Irani qëndron pas kësaj lëvizjeje rebele janë të shumta dhe sikurse ka vepruar me Hezbollahun, Irani është munduar që përmes kësaj lëvizjeje të zbatojë programin e drejtimin fetar të tij edhe në këtë pjesë të botës Islame.

Huthijunët kanë marrë goditje të forta nga Arabia Saudite në konfliktin e fundit, megjithatë ata përbëjnë një rrezik potencial për rajonin dhe Siujdhesën Arabike në tërësi.

Ekonomia e Jemenit.

Jemeni ka një ekonomi të dobët në krahasim me shtetet e tjera arabe, për shkak se në Jemen ka shumë pak naftë. Rezervat e naftës janë varfëruar brenda pak viteve. Rënia e çmimeve të naftës e ka dëmtuar edhe Jemenin dhe e ka ngadalësuar zhvillimin e vendit. Rezervat e Jemenit kanë rënë me shpejtësi vit pas viti duke sjellë frikën e një kolapsi ekonomik. Që nga bashkimi, qeveria ka punuar për integrimin e dy sistemeve relativisht të ndryshme ekonomike. Megjithatë goditja më e rëndë përfshin kthimin në vitin 1990 të rreth 850.000 Jemenasve nga shtetet e Gjirit Persik, që përbën një ulje të madhe të ndihmës së ardhur nga fuqia punëtore jashtë vendit. Rritja ekonomike u pengua edhe nga mosmarrëveshjet e brendshme politike, që kulmuan me luftën civile në vitin 1994. Jemeni ka një pasuri të madhe në bagëti dhe prodhon lloje të ndryshme drithërash. ■

■ 2 Medhhebi Zejdi: Zejditi hadevijë konsiderohen prej grupeve shiite që janë më të afërt me Ehli Sunetin. Medhhebi tyre dallohet me largimin nga ekstremi, që është i pranishëm te Ithna Asheritë dhe shiat e tjerë. Prejardhja e tyre kthehet te Zejd ibën Ali Zejnul Abidini. Ai e shihte të saktë imamatin e Ebu Bekrit, Omerit dhe Osmanit dhe asnjë nga zejditi nuk thotë se Sahabët janë jobesimtarë. Por grupet e Zejdive përveç hadevive kanë devijuar nga parimet e Zejditi dhe kanë përqafuar mendimin se: refuzojnë udhëheqjen e Ebu Bekrit dhe Omerit, dhe i kanë përqafuar besimet e tjera të ithna asherive të tjerë që lidhen me imamatin. Kështu vijmë në përfundim se Zejditi janë prej grupeve më mesatare shiite në qëndrimet e tyre, si dhe grupi Xharudi prej tyre janë njësoj në qëndrimet e tyre me grupet shiite ekstreme edhe nëse fshihen pas petkut të Zejdive.


SI BESOHEHET GAJBI?

ZGJODHI DHE PËRKTHEU: AGIM BEKIRI

Pyetja 1: Ç'nënkupton të besosh në Gajb (botën e fshehtë)?

Përgjigje: Të besosh në gajb do të thotë të besosh në çdo gjë të padukshme për të cilën na ka lajmëruar Allahu i Madhëruar apo pejgamberët e Tij. Prej gjërave të padukshme është ajo që na përmend Muhamedi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, kur u pyet se ç'është imani duke thënë: “Të besosh Allahun, melekët, librat, pejgamberët, Ditën e Fundit dhe të besosh në paracaktimin, të mirën dhe të keqen.” Të gjitha këto janë gjëra të fshehta, që nuk i shohim mirëpo i besojmë, duke u mbështetur në lajmet e Allahut të Madhëruar dhe pejgamberëve të Tij. Sa kohë që lajmëtari është i besueshëm, atëherë lajmi i tij pranohet dhe besohet si i vërtetë. Mu për këtë besimi në botën e padukshme është karakteristika më dalluese e besimtarit. Në një hadith i Dërguari i Allahut na tregon: “Me të vërtetë Allahu ka melekë vëzhgues në tokë. Kur ata shohin ndonjë grup njerëzish, që po përmendin Allahun thërrasin njëri-tjetrin: Ejani se gjetëm atë që kërkoni, ejani se gjetëm atë që kërkoni! I rrethojnë me flatrat e tyre deri në qiell dhe më pas ngjiten lart. Zoti i pyet megjithëse e di më mirë se ata:

-Prej nga vini?



-Vijmë prej disa robërve të Tu, të cilët të përmendin dhe të falënderojnë, të lavdërojnë dhe të lusin për falje, -përgjigjen ata. I pyet sërish:

-A më kanë parë?

-Jo për Allahun, o Zoti ynë, nuk të kanë parë, -thonë ata.

-E ç'do të bënin sikur të më shihnin, -i pyet Zoti?

-Po të të shihnin do të adhuronin, do të madhëronin e do të lartësonin edhe më tepër, -thonë ata.

-Po ç'kërkojnë ata? -i pyet Ai.

-Kërkojnë xhenetin, -thonë ata.

-E kanë parë xhenetin?

-Jo, për Allahun, nuk e kanë parë, -përgjigjen ata.

-Po vallë sikur ta kishin parë, ç'do të bënin?

-Do ta kërkonin edhe më tepër dhe do të kujdeseshin për ta fituar edhe më shumë, -përgjigjen ata. Thonë:

-Ata (njerëzit) kërkojnë mbrojtjen Tënde

Në këtë rubrikë mirëpresim të gjitha pyetjet e juaja, ndërsa ato më interesante do të botohen.
Pyetjet mund t'i dërgoni në albislam@gmail.com

nga zjarri. Zoti i pyet:

-A e kanë parë zjarrin?

-Jo, për Allahun, nuk e kanë parë, - përgjigjen ata.

-Po vallë sikur ta kishin parë, ç'do të bënin?

-Do të frikësoheshin edhe më shumë dhe do të kërkonin mbrojtjen Tënde edhe më tepër, -përgjigjen melekët.” Ky është besimi në gajb, besim që ngrihet mbi lajmet që vijnë nga Allahu dhe pejgamberët e Tij. Ata besojnë në Zotin e tyre, në emrat dhe cilësitë e Tij, edhe pse nuk e shohin Atë në këtë botë. Ata gjithashtu besojnë në librat që i ka shpallur Allahu, edhe pse nuk e kanë parë tek po shpalleshin. Po ashtu besimi në pejgamberët, nuk i kemi parë ata përveç asaj që kemi dëgjuar, mirëpo besojmë se Allahu i ka dërguar, e kështu me radhë.

ABDULLAH IBËN ABDURAHMAN IBËN
XHIBRIN

Pyetja 2. Si duhet të kuptojmë kundërshtinë që bie në shikim të parë mes bindjes, se vetëm Allahu e di të fshehtën dhe thënieve të të Dërguarit, i cili na ka lajmëruar se xhindet duke hipur njëri mbi tjetrin ngiiten lart në qiellin e kësaj bote dhe dëgjojnë lajme për të ardhmen dhe duke i bashkuar atij lajmi gënjeshtër të shumta ua përcjellin magjistarëve e fallxhorëve?

Përgjigje: Njohja e gajbit është një veçori e Allahut të Madhëruar. Këtë e mbështesin shumë ajete kuranore dhe hadithe profetike. Allahu i Madhëruar thotë: *“Thuaj: “Askush veç Allahut, as në qiej, as në tokë nuk e di të fshehtën, as nuk e dinë se kur ringjallen!”* (Nemël: 65), *“Çelësat e fshehtësive janë vetëm tek Ai, atë (fshehtësinë) nuk e di kush pos Tij. Ai e di çka ka në tokë dhe në det, Ai e di për çdo gjeth që bie dhe s’ka kokërr në thellësi të tokës, s’ka të njomë dhe s’ka të thatë që nuk është (e shënuar) në librin e qartë (Levhi - Mahfudh).”* (Enam: 59)

Këto çelësa i Dërguari i Allahut i shpjegoi me ajetin tjetër kuranor, ku Allahu thotë:

“S’ka dyshim se vetëm Allahu e di kur do të ndodhë kiameti, Ai e di kur e lëshon shiun. Ai e di se ç’ka në mitra (të nënave), nuk e di kush pos Tij se çfarë do të ndodhë (çka do të punojë) nesër, dhe askush nuk e di, pos Tij, se në ç’vend (ose kohë) do të vdesë. Allahu është më i dijshti, më i njohuri.” (Lukman: 34)

Buhariu na përcjell se Aishja, *radijallahu anha*, thotë: “Kush të thotë se e di të ardhmen, të ka gënjyer, pastaj lexoi ajetin *“Nuk e di kush pos Tij se çka do të ndodhë nesër.”*

Duke pasur parasysh këto argumente duhet të dimë se ç’kuptim ka njohja e gajbit si veçori e Allahut. Fjala gajb përfshin çdo gjë që s’është e pranishme. Ajo që s’është e pranishme, ose nuk do jetë e pranishme për të gjitha krijesat në qiell e në tokë dhe quhet fshehtësi absolute (gajb mutlak), ose nuk do të jetë e pranishme për disa prej krijesave, kurse për disa të tjera nuk do jetë e fshehtë dhe quhet fshehtësi relative (gajb nisbij). Të parën nuk e di askush tjetër veç Allahut dhe si e tillë është veçori e Allahut, kurse të dytën e dinë disa krijesa dhe si e tillë nuk është veçori e Allahut. Shejh Uthejmini gjatë komentimit të librit “Vasitije” thotë: “Me gajb nënkuptohet gjithçka që s’është e pranishme dhe kjo gjë është relative, mirëpo gajbin absolut nuk e di kush tjetër pos Allahut.”

Gjërat që lajmërojnë fallxhorët për të ardhmen nuk kanë lidhje me gajbin dhe nuk është njohje e së nesërmes (që është përmendur si veçori e Allahut), porse ata janë gënjeshtarë. Pejgamberi na ka lajmëruar, se ata e vjedhin atë informacion gjatë shpalljes, që u jepet melekëve. Aishja tregon: Disa njerëz e pyetën të Dërguarin për fallxhorët e ai tha: *“Ata s’janë gjë.”* Ata sërish i thanë: O i Dërguari i Allahut, ata lajmërojnë gjëra të vërteta. I Dërguari ua ktheu: *“Atë fjalë e vjedh xhindi pastaj ia pëshpërit në vesh mikut të tij, ashtu sikurse pula kur çukit me sqepin e saj dhe përziejnë me atë fjalë më shumë se njëqind gënjeshtër.”* (Buhariu)

I Dërguari na ka treguar mënyrën se si e bëjnë këtë xhindët. Ai ka thënë: “...mirëpo kur Zoti, lavdi qoftë për emrin e Tij, vendos diçka bartësit e Arshit bëjnë tesbih (e madhërojnë Allahun), pastaj tesbih bëjnë banorët e qiellit që vijnë derisa ky tesbih të arrijë në qiellin e kësaj bote. Melekët që vijnë pas bartësve të Arshit pyesin: Ç’tha Zoti juaj? Ata u përgjigjen se ç’ka thënë. Kështu pyesin melekët e çdo qielli që vijon ata më të lartit derisa lajmi të arrijë në qiellin e dynjasë. Xhindi grabit lajmin dhe ia hedh mikut të tij. Ata edhe sulmohen. Atë që e sjellin është e vërtetë, mirëpo ata gënjejnë dhe shtojnë.” (Muslimi)

Nga kjo që u theksua më lart bëhet e qartë se xhindet nuk e njohin të fshehtën, porse vjedhin ndonjë lajm që e përsërisin melekët, të cilët as vetë nuk kanë pasur ndonjë njohuri për atë gjë, por vetëm pasi Allahu i informoi ata. Pra, pasi t’i informojë Allahu ato gjëra dalin nga suazat e gajbit absolut, kurse para kësaj edhe xhindet janë si të gjitha krijesat e tjera, që nuk dinë gjë për të ardhmen. Dija për lajmin sërish kthehet tek Allahu. Shejh Uthejmini thotë: “I Dërguari më i famshëm prej melekëve, Xhibrili, pyeti të Dërguarin më të famshëm prej njerëzve: “Kur do të ndodhë Kiameti? Ai u përgjigj: “As i pyeturi e as pyetësi nuk kanë njohuri për këtë.” Kjo do të thotë që: ashtu siç nuk ke dituri ti për këtë gjë, nuk kam as unë.

MUHAMED IBËN SALIH MUNEXHID

Pyetja 3: Nëpër shumë faqe interneti paraqiten prognozat e motit gjatë 5 deri në 10 ditë. A ka të bëjë kjo gjë me astrologinë apo njohjen e gajbit?

Përgjigje: Prognozatat e motit nuk kanë të bëjnë, as me astrologinë, as me pretendimin e njohjes së gajbit, porse janë përfundime që nxirren në bazë të gjërave të dukshme, eksperiencës dhe leximit të ligjeve të natyrës. E ngjashme me këto është edhe njohja e momenteve të eklipsit, pritja e shtrëngatave dhe rënia e shiut. Në një fetva të Komisionit të

Përhershëm për Fetva thuhet: “A mund të njihet para zënia e hënës apo e diellit, duke llogaritur lëvizjen e këtyre trupave? Përgjigje: Po, ashtu mund të njihet para, se ndoshta zënia do jetë e pjesshme apo e tërësishme dhe këtu s’ka asgjë për t’u habitur, ngase nuk janë çështje të gajbit për çdonjërin, porse vetëm për atë që nuk di të llogarisë lëvizjen e trupave qiellorë në dallim nga ai që e di një gjë të tillë. Po ashtu kjo gjë nuk bie në kundërshtim me besimin, se eklipsi është një prej shenjave të Allahut, e cila i frikëson robërit e Tij në mënyrë që të kthehen tek Zoti i tyre dhe të drejtohen në rrugë të drejtë.”

Më tej thuhet: “Prognozatat për motin, pritja e shtrëngatave, supozimi i formimit të reze dhe rënies së shiut sillen në bazë të njohjes së ligjeve të Allahut në natyrë. Mund të ndodhë që dikush në bazë të metodave të ndryshme shkencore apo eksperiencave të zakonshme të lajmërojë supozimin e jo dijen e tij dhe ndonjëherë e qëllon dhe tjetrën gabon.”

Shejh Uthejmini thotë: “S’kanë lidhje me fallin lajmet që vijnë si rezultat i llogaritjeve matematikore, siç janë lajmet për eklipsin, momentin e perëndimit të diellit, ngase janë gjëra që njihen nëpërmjet llogaritjeve dhe çdo gjë që njihet në këtë mënyrë lajmërimi për to në të ardhmen nuk konsiderohet si njohje e gajbit apo fall.”

Parashtrohet pyetja: A është pjesë e fallit prognoza për motin brenda 24 orëve apo më shumë? Përgjigja është: Jo, sepse edhe kjo bazohet në mundësitë shqisore, që në këtë rast është përcjellja e atmosferës, e cila në mënyrë precize klimatizohet dhe bëhet e mundshme për të rënë shi apo jo. Kjo është njësoj me atë kur shohim grumbullimin e reze, murmurimat (bubullimat) dhe vetëtimat dhe themi: është gati për të rënë shi. E rëndësishme është të themi, se çdo lajm që bazohet në gjëra shqisore, nuk ka lidhje me botën e fshehtë – gajbin.

MUHAMED IBËN SALIH MUNEXHID

REBI IBËN HUTHEJMI – NJË BURRË QË PESHON SA MALET (II)

Aliu, Allahu qoftë i kënaqur me të kishte vendosur ta provonte Rebian. Kur dëgjoji se Rebia kalonte pranë farkëtarit dhe i binte të fikët, iu tha shokëve: Kur t'i ndodhë kjo më lajmëroni. Pas ca ditësh kur i ndodhi kjo shokët e lajmëruan Aliun dhe ai shkoi ta vërtetonte rastin. Futi dorën brenda këmishës së tij dhe ndjeu rrahjet e larta të zemrës së tij ndaj tha: “Dëshmoj se ky është njeriu më me frikë ndaj Allahut të Madhëruar në kohën tuaj”

SHKRUAN: SEDAT ISLAMI

Megjithatë Rebia ishte njeri. Edhe ai mund të bënte mëkat, ose t'i shkonte mendja për një gjë të tillë. Por duke u marrë me veten, jo me të tjerët, ai kishte gjetur ilaçin e duhur. Ai kishte hapur një varr brenda shtëpisë së tij dhe sa herë që shpirti i anonte nga dynjaja apo vrazhdësohej, hynte në varr. Kur shihte errësirën dhe egërsinë e tij, thërriste me zë:

“O Zoti im! Më kthe prapë në dynjal!” E dëgjonte familja, kështu që shkonin dhe e nxirrnin prej aty. Një natë, hyri në varr dhe u mbulua me mbulesën e tij. Kur e trishtoi brendësia e tij thirri: *“O Zoti im! Më kthe prapë në dynjal!”*, por nuk e dëgjoji askush. Pas një kohe bukur të gjatë e dëgjoji gruaja, e cila nxitoi dhe e nxori. Kur doli prej varrit, iu drejtua vetes: Puno, o Rebi, para se të thërrasësh *“O Zoti im! Më kthe prapë në dynjal!”* e të mos përgjigjet askush!¹

Rebia në fakt e përshkruan veten pa

asnjë mburrje a kryelartësi. Kur e kishte pyetur Ibën Kevai: “Me udhëzo tek një njeri që është me i mirë se ti?”, ai i qe përgjigjur: “Ai që gjuha e tij është vetëm dhikër (përmendje e Allahut), heshtja e tij meditim dhe udhëtimi i tij studim, ai është më i mirë se unë².”

Me këto fjalë sikur ka dashur t’i thotë, se unë jam kështu, kam këto cilësi dhe ti nëse kërkon këshillë prej meje, atëherë mos më merr me rezervë, ndryshe nëse kërkon më të mirë se unë, hulumto njeriun me këto tipare se ne jemi njësoj.

Rebia ishte i sinqertë. Veprat që nuk bëheshin për hir të Allahut të Madhëruar i quante bosh. I pëlqente që të bëjë vepra të mira fshehurazi, kështu, nëse ishte duke lexuar Kuran dhe dikush hynte tek ai në dhomë, atëherë e fshihte – e mbulonte atë me ndonjë pëlhurë, që të mos e shihnin duke lexuar³. Kur njerëzit flinin, ai shkonte në varreza dhe përkujtonte vdekjen. “Ishit dhe ishim” – iu thoshte, ndërsa të nesërmen iu fliste njerëzve, sikur të ishte ngritur prej varrit⁴. Nata ishte koha kur ai falej dhe lutej shumë. Vajza e vet e pyeti për këtë gjë e i tha: “O baba, përse nuk pushon kur njerëzit pushojnë (fleen)?- “I frikësohem ndëshkimit befasues të Allahut të Madhëruar- iu përgjigj ai⁵.” Për ta vërtetuar në ishte false apo e vërtetë devotshmëria e tij Aliu, Allahu qoftë i kënaqur me të kishte vendosur ta provonte Rebian. Kur dëgjoi se Rebia kalonte pranë farkëtarit dhe i binte të fikët, iu tha shokëve: Kur t’i ndodhë kjo më lajmëroni. Pas ca ditësh kur i ndodhi kjo shokët e lajmëruan Aliun dhe ai shkoi ta vërtetonte rastin. Futi dorën brenda

“...Dëshmi tjetër që argumenton namazin e tij të shumtë është edhe rasti i një fqinje të tij të vogël, e cila hipte mbi pullaz vetëm natën. Pasi vdiq Rebia i tha babait të vet: Baba, ku është shtylla e fqinjëve që nuk po e shoh më...”

këmishës së tij dhe ndjeu rrahjet e larta të zemrës së tij ndaj tha: “Dëshmoj se ky është njeriu më me frikë ndaj Allahut të Madhëruar në kohën tuaj⁶.”

1. Adhurimi

Vizioni i tij prej muslimani të vyer dhe të ditur e shndriti tërë jetën e tij ndaj mangësitë nuk mund të vëreheshin shumë në sjelljet dhe veprat e tij. I frymëzuar dhe i udhëhequr nga mësimi profetik për falje të namazeve vullnetare në shtëpi, ai gjatë tërë jetës vetëm një herë është parë të ketë falur Sunetet në xhaminë e lagjes së vet⁷. Kurse farzin, edhe kur qe sëmure dhe e tërhiqnin zhargas, nuk e linte. Përse nuk qëndron në shtëpi kur për këtë ke leje fetare?- i thanë disa. Unë po dëgjoj (muezinin) duke thënë: Eja në shpëtim (**Hajj alel felah**) ndaj i përgjigjem. Kush prej jush e dëgjon këtë, le t’i përgjigjet qoftë edhe nëse tërhiqet zvarrë për në xhami⁸.

Kur bënte sexhde, zogjve u dukej si një rrobë e hedhur, ndaj edhe vinin e pushonin

¹ Umnijatu’l mevta, Dr. Muhamed ibënIbrahim En Neim, <http://saaaid.net/Minute/141.htm>

² Sijeru a’lami’n nubela, Imam Dhehebiu.

³ Shuabu’l imam, Bejhekiu, pj.5, f. 246

⁴ <http://www.sahab.net/forums/showthread.php?>

t=290248

⁵ Shuabu’l imam, Bejhekiu, pj.3, f. 38

⁶ Tefsi i Kurtubiut, pj.4, f.283.

⁷ <http://www.sahab.net/forums/showthread.php?t=290248>

⁸ <http://saaaid.net/gesah/198-4.htm>

aty⁹. Megjithëkëtë namazi i natës ishte koha më e dashur për të. Ishte koha kur sinqeriteti shihej edhe nga hëna. Edhe nga planetët mund të vërehej ndriçimi i shtëpisë së tij me iman. I ndodhte shpesh që gjatë tërë natës të mos mund ta mbaronte as edhe një ajet kuranor nga të qarit e shumtë. P.sh. kur kishte lexuar ajetin kuranor: *“A menduan ata, të cilët vepruan në të këqija, se në jetën e tyre dhe në vdekjen e tyre do t’i bëjmë të barabartë me ata që besuan dhe bënë vepra të mira? Sa i shëmtuar është gjykimi i tyre”*¹⁰...tërë natën kishte mbetur vetëm me të dhe prapë nuk e kishte përfunduar dot¹¹.

Një dëshmi tjetër që argumenton namazin e tij të shumtë është edhe rasti i një fqinje të tij të vogël, e cila hipte mbi pullaz vetëm natën. Pasi vdiq Rebja i tha babait të vet: Baba, ku është shtylla e fqinjëve që nuk po e shoh më. Ajo kishte parë Rebian tek falej dhe mendonte se nuk është njeri por shtyllë¹². Për t’u bindur se falej gjatë tërë natës shokët i shikonin flokët, ku në mëngjes, kur ngriheshin për të falur namaz, nuk vërenin asnjë shenjë shprishjeje, që do të tregonte se kishte fjetur gjumë¹³.

2. Të folurit

Element tjetër që përcakton devotshmërinë e njeriut është edhe kujdesi ndaj të folurit. Rebja padyshim se ishte një ndër më të dalluarit në këtë çështje. Për plot 20 vite nuk ka folur fjalë të dynjasë. Me të gdhirë në mëngjes, merrte pranë vetes një laps dhe fletore për të shkruar çdo gjë që

“...Madje si parim ia kishte kushtëzuar vetes që më pak se një simite të mos ia jepte asnjë lypësi. Turpërohem që në peshoren e veprave të mia të figurojnë vepra më të vogla sesa një simite...”

thotë dhe për ta llogaritur më pas në mbrëmje atë¹⁴. Ai dëshironte që dita e tij, e më konkretisht, regjistrimi i veprave të tij të fillojë me punë të mbara, kështu që kur zgjohej fjalët e para të tij ishin: Mirë se keni ardhur Melaiket e Allahut! **Bismilahi Rahmani Rahim! Subhanallah, uel hamdulilah ue la ilahe il-la Allah, Allahu Ekber!**¹⁵

Ka qenë porosi e tij e veçantë, që fjalimi i njeriut në tërësi të reduktohet në nëntë gjërat vijuese: tesbih (Subhanallah), tehlil (la ilahe il-la Allah), tekbir (Allahu Ekber), tahmid (elhamdulilah), të kërkosh të mirën, të kërkosh mbrojtje nga e keqja, të urdhërosh për të mirë dhe të ndalosh nga e keqja si dhe të lexosh Kuran¹⁶. Moto e tij ka qenë: Gjuhën bllokoje përveç për gjërat që janë pro teje dhe nuk janë kundër teje¹⁷.

3. Edukimi i familjes

Parimisht, nëse njeriu nuk e nis nga baza e tij, nga më të afërmit, nga familja,

⁹ <http://www.sahab.net/forums/showthread.php?t=290248>

¹⁰ Xhathije, 21.

¹¹ <http://www.quranway.net/index.aspx?function=Item&id=319&lang>

¹² Err Rrisaletu el Kushejrrije, pj. 1, fq. 176.

¹³ <http://www.sahab.net/forums/showthread.php?t=290248>

¹⁴ Ihjau ulumuddin, pj. 2, fq. 311.

¹⁵ <http://www.sahab.net/forums/showthread.php?t=290248>

¹⁶ Musannef Ibni Ebi Shejbe, pj. 8, fq. 209

¹⁷ Shuabu'l imam, Bejhekiu, pj. 11, fq. 33.

misionin e vet mbase mund të jetë i dështuar. Rebia e kishte kuptuar shumë mirë këtë gjë, kështu që kishte tolerancë zero ndaj çdo ndikimi të jashtëm, i cili synonte plasaritjen e këtij institucioni të shenjtë njerëzor. Një ditë, në prani të mysafirëve vajza e tij e vogël kërkoi leje për të lozur me shoqet e veta. -Baba, a më jep leje të lozur me femijët? Jo- u përgjigj ai. Përse nuk e lejon të luaj me femijët?!- e pyetën disa me habi. Unë nuk dua që në regjistrin e veprave të mia të figurojë, se i kam thënë shko luaj, por (dua të figurojë) shko e thuaj mirë dhe vepra mirë¹⁸.

4. Bujaria e tij

Rebia nuk ishte aq i pasur sa të jepte shumë sadaka, por megjithatë kjo i dukej në veprat e tij. Ajo që është më e rëndësishme është se ai vetë angazhohej që me punën e tij të fitonte pasurinë e nevojshme. I frymëzuar nga mësimet kuranore dhe nga praktika profetike, ai mendohej që të jepte gjithnjë më të mirën, më të shtrenjtën që ai kishte. Një ditë i erdhi një lypës dhe ai e urdhëroi familjen e tij t'i japin bukë dhe sheqer. E ç'do të bëjë ky me sheqerin?- i tha familja. Nëse ky nuk bën asgjë, unë bëj (fitoj tek Allahu)- ua ktheu ai¹⁹. Madje si parim ia kishte kushtëzuar vetes që më pak se një simite të mos ia jepte asnjë lypësi. Turpërohem që në peshoren e veprave të mia të figurojnë vepra më të vogla sesa një simite²⁰.

5. Maturia në veprime

Rebia ishte jashtëzakonisht i qëndrueshëm në raport me muslimanët.

“Në një rast tjetër i qe vjedhur kali, i cili kishte një vlerë shumë të madhe. I thanë: Lutu kundër tyre, kurse ai tha: O Zoti im! Nëse është i pasur, fale, e nëse është i varfër, pasuroje!...”

Devotshmëria e tij e kishte bllokuar nepsin, kështu që nxitimi dhe temperament i nxehtë nuk kishin vend tek ai. Këtë e ka dëshmuar në shumë raste. Kur u njoftua për vrasjen e Husejnit, nuk u ngut të thoshte diçka, siç bënë disa, por me gjithë pikëllimin që pati, tha vetëm këtë ajet kuranor²¹: *“Thuaj: “O Allah, Krijues i qiejve e i tokës, Njohës i të fshehtës edhe i të dukshmes, Ti je që gjykon mes robërve të Tu për atë që ata kundërshtoheshin”*²². Këtë ajet kush e kupton ka shumë domethënie, ngase për t'i ikur edhe paragjykimit më të thjeshtë, ai preferon që për këtë çështje të gjykojë vetëm Allahu i Madhëruar.

Në një rast tjetër i qe vjedhur kali, i cili kishte një vlerë shumë të madhe. I thanë: Lutu kundër tyre, kurse ai tha: O Zoti im! Nëse është i pasur, fale, e nëse është i varfër, pasuroje!²³

Ishte shumë i kujdesshëm në veprime edhe në çështjet e dëfrimit. Çdo gjë që binte ndesh me normat islame, ai e refuzonte apriori. Për lojën e tavllës ka thënë: Po ta

¹⁸ Musannef Ibni Ebi Shejbe, pj. 8, fq. 300.

¹⁹ Ibid, pj. 8, fq. 310.

²⁰ <http://www.sahab.net/forums/showthread.php?t=290248>

²¹ Tefsiri i Kurtubiut, pj. 15, fq. 265.

²² Zumer, 46.

²³ <http://www.sahab.net/forums/showthread.php?t=290248>

rrotulloja me dorën time dhjamin e derrit do të më ishte më e dashur, se sa ta bëj një gjë të tillë me figurat e lojës së tavllës²⁴. Qëndrimet në rrugë i largohej shumë. Këtë e arsyetonte duke thënë se: Kam frikë që t'i bëhet padrejtësi ndonjë njeriu, kurse unë nuk shoh, t'i shpifet ndonjë njeriu diçka, kurse unë të obligohem – ngarkohem me dëshmi kundër tij, të mos e ul shikimin, të mos e udhëzoj ndonjë udhëtar, të shoh ndonjë hamall (a dikë që bart diçka t'i rrezohet prej shpine ajo) e të mos e ndihmoj²⁵.

6. Mirësjellja me njerëzit

Ishte shumë i matur. Edhe kur shqetësohej shumë, prapë e përmbante veten. Kur po bëheshin gati për farz, një njeri nga safi vijues kërkoi që të plotësoheshin safat që atij t'i bëhej vend. Rebia donte të gjente vend të zbrazët në safin paraprak, por nuk kishte, kështu që ai e shtyu keq. Rebia u kthye nga ai dhe i tha: Allahu të mëshiroftë! Allahu të mëshiroftë! Kur e pa se ishte Rebia njeriu u shkreh në vaj²⁶. Edhe kur i shkaktonte plagë, ai nuk lutej kundër tyre. Kështu kur një ditë po rrinte në prag të shtëpisë, i ra një gur mbi kokë dhe ia çau pak atë dhe i rrodhi gjak. Rebia fshinte kokën dhe thoshte: -O Zoti im! Fale ngase nuk më ka synuar mua!²⁷-

Ishte e pamundur që ai t'i përgoonte njerëzit. -Unë kam punë ende me veten time ndaj besoj se nuk kam pse të merrem me të tjerët. Njerëzit, iu frikësuan Allahut të Madhëruar për mëkatet e të tjerëve, kurse për mëkatet e tyre aspak- thoshte ai²⁸.

²⁴ <http://al7ewar.net/forum/showthread.php?p=78397>

²⁵ Musannef Ibni Ebi Shejbe, pj.6,f.245

²⁶ <http://al7ewar.net/forum/showthread.php?p=78397>

²⁷ Shuabu'l imam, Bejhekiu, pj.17, f. 131

²⁸ Ibid, pj.16, f. 100

²⁹ Ibid, pj.11, f. 37

³⁰ Tefsiru't Taberijj, pj.6, f.30.

³¹ <http://al7ewar.net/forum/showthread.php?p=78397>

“...një ditë po rrinte në prag të shtëpisë, i ra një gur mbi kokë dhe ia çau pak atë dhe i rrodhi gjak. Rebia fshinte kokën dhe thoshte: -O Zoti im! Fale ngase nuk më ka synuar mua!... ”

Ndonjëherë i udhëzonte përgojuesit: -Më mirë ta përmendni Allahun e Madhëruar, se sa të përmendni njerëzit!²⁹-

Nga frika se mos i ngushtonte borxhlinjtë, kur vinte afati i caktuar ai shkante vetë tek shtëpia e tyre dhe iu thoshte: -O filan, nëse ke mundësi, ma kthe borxhin, përndryshe mbaje derisa Allahu i Madhëruar t'i lehtësojë punët e tua!³⁰-

Meqenëse veprat vlerësohen me përmblyllje të tyre, ne mendojmë se nuk kemi gabuar dhe nuk i kemi kaluar suazat fetare në fjalët që thamë, ngase ai, Allahu i Madhëruar e pastë mëshiruar, para se të vdiste kishte lënë këtë vasijet (testament): “Kjo është gjëja që Rebia e pranon për veten e tij, për çka kam dëshmitar Allahun, që mjafton si dëshmitar dhe si shpërblyes i robërve të Tij të sinqertë, se unë kam pajtuar që Allahu i Madhëruar të jetë Zoti im, Muhamedi profeti im, Islami feja ime dhe unë, bashkërisht me ata që më respektojnë, kemi pranuar ta adhurojmë (Allahun) me adhuruesit, ta falënderojmë me falënderuesit dhe t'i këshillojmë muslimanët³¹.”

Thesare nga fjalët e tij

Rebia me fjalët dhe këshillat e tij bëri që të mos vdesë, edhe pse nuk është në mesin e të gjallëve fizikisht. Ai la shumë fjalë e porosi, këshilla e mësimi, që edhe po të shkruheshin me ngjyrë ari pak do të ishte. Ato janë mu sikur shenjat në rrugë, që po i përfillte vështirë se mund të humbësh. Ja disa prej tyre:

Flisni mirë, veproni mirë dhe vazhdoni të veproni mirë. Le të mos u bëhen të vrazhda zemrat tuaja, le të mos iu mashtrojë përshkallëzimi (mos ndëshkimi aty për aty) dhe mos thoni sikurse ata që thanë: - Dëgjua!-, e nuk dëgjuan.

Nuk ka mysafir të huaj që e pret besimtari më mirë, se sa vdekjen.

Prangose gjuhën përveçse për gjërat që janë në dobi tënden dhe nuk janë kundër teje.

Çudi me melekun e vdekjes dhe me tre personat që ai viziton: Mbretin, i cili mbrohet në kalatë e tij, kurse ai ia merr shpirtin dhe pasurinë ia lë pas; me mjekun, i cili shëron njerëzit, kurse ky ia merr shpirtin, dhe me skamnorin që njerëzit e shqelmojnë në rrugë dhe nuk i afrohen, kurse ai i afrohet atij (dhe ia merr shpirtin).

Allahu i Madhëruar ka caktuar se kush mbështetet tek Ai, i mjafton, kush beson në Të, e udhëzon, kush jep për Të, e shpërblen, kush i zë besë, e shpëton, kush e lut, duanë ia plotëson.

Mos thoni: Kërkoj falje tek Allahu i Madhëruar dhe pendohem, që të bëni edhe mëkate edhe gënjeshtër, por thoni: O Zoti im, më fal dhe ma prano pendimin!

Bëhu këshilltar i vetvetes!

O njeri! Nëse bën mirë, atëherë të mirën pasoje me të mirë, ngase do të vijë dita kur do të dëshirosh, që të mirat të kishin qenë të shumta.

Për diturinë që Allahu i Madhëruar të ka mësuar, falënderoje, kurse për atë që Ai është veçuar me të, mos u lodh fare!

Kujdes për gjërat që i bën fshehurazi, ngase ato nëse nuk i dinë njerëzit Allahu i Madhëruar i di!

Çdo gjë që nuk bëhet për hir të Allahut të Madhëruar është e pavlerë.

Njerëzit janë dy llojesh: Besimtarin, të cilin nuk duhet ta shqetësosh, dhe injoranti me të cilin nuk duhet të polemizosh.

Përmbyllje

Nuk do ta cilësoja punimin tim si madhështor, por jetën e tij si ideale, ndaj nëse them se nuk ia vlen barra qiranë që leximi i këtij punimi të jetë vetëm për qejf dhe çlodhje, besoj se nuk e teproj. Ajo që unë këtu do të doja të them, si një ndërlihdje me hadithin e parathënies është nevoja urgjente e kthimit tek këto baza të edukimit për tërë umetin, në mënyre që kjo poshtërsi dhe ky nënçmim që na i kanë vënë si sinonime të na largohen njëherë e përgjithmonë. Jo rastësisht Imam Maliku ka thënë: **“Nuk ka gjasa të përmirësohet ithtari fundit i këtij umeti përveçse me atë që u përmirësua i pari i saj”**³².

Le të jetë moto e këtij artikulli vetëdijesimi ynë dhe rikthimi në vlerat e mirëfillta fetare, ashtu siç ishin të parët tonë!

O Zoti ynë! Dërgo përshëndetjet më të sinqerta në adresë të mësuesit të njerëzimit, Muhamedit dhe na udhëzo neve, që ta pasojmë rrugën e tij! Na bëj të ecim gjurmëve të selefrit, **të parëve tanë të mirë**, në mënyrë që ta kuptojmë fenë, ashtu siç e kuptuan ata apo thënë më mirë ashtu siç Ti e zbritë! Dërgo në këtë umet njerëz që shquhen me tipare të selefrit të mirë dhe të cilët do të drejtojnë robërit e Tu drejt krenarisë! ■

³² Esh Shifa, Kadi Ijjad, pj.1, f.341.